



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

STUDIMET PASDIPLOMIKE-CIKLI I DYTË

PUNIM MAGJISTRATURE

**“ EKONOMIA INFORMAL, PËRMASAT DHE EFEKTET E SAJ NË  
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË ”**

MENTOR:

Prof.Dr.Shpresa Alija

KANDIDATI:

Kaltrina Nushi

Tetovë, 2022

## **Përmbajtja**

Hyrje.....	8
I.    Qëllimi i punimit .....	9
II.   Rëndësia e temës.....	9
III.  Objektivat dhe pytjet rrethë punimit.....	10
IV.   Metodologjia e punimit.....	10
V.   Konkludimet dhe pritshmërit e studimit.....	11
KAPITULLI I: RISHIKIMI I LITERATURËS.....	13
I.1.  Përkufizimi i ekonomisë informale .....	13
I.2.  Shkaqet dhe karakteristikat e ekonomisë informale.....	16
I.3.  Faktorët kryesor që ndikojnë në rritjen e ekonomisë informale .....	23
I.4.  Shkollat (mendime) mbi metodat e matjes së ekonomisë informale .....	26
I.5.  Sektoret e prekur më së shumti nga ekonomia informale .....	31
KAPITULLI II: PËRMASAT E EKONOMISË INFORMALE .....	36
II.1.  Përmasat e ekonomisë informale në vendet e zhvilluara .....	36
II.2.  Përmasat e ekonomisë informale në vendet në tranzicion .....	44
KAPITULLI III: PËRMASAT E EKONOMISË INFORMALE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË .....	49
III.1.  Ekonomia informale në R. e Shqipërisë .....	49
III.2.  Faktorët që ndikojnë në ekonominë informale në Shqipëri .....	52
III.3.  Lufta kundër korrupsionit .....	58
III.4.  Masat e zbatuara kundër uljes së ekonomisë informale në R. e Shqipërisë .....	60
KAPITULLI IV: RAST STUDIMI REPUBLIKA E SHQIPËRISË.....	64
IV.1.  Analizë empirike .....	64
KAPITULLI V: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....	72
Bibliografia .....	74

## **Abstrakt**

Hulumtimet për ekonomin informale janë shumë të rëndësishme për një shtet që ekonomia e saj është në zhvillim e jo vetëm. Matjet e ekonomis informale në Shqipëri kanë qënë dhe janë edhe sot e kësaj dite shumë të vështira dhe po thuajse jo shumë të sakta. Kjo për shkak të jovetëdijesimit të vet qytetarve por edhe mënyrës jo shumë të saktë të përdorimit të duhur të kësaj fushe. Në Shqipëri, matja dhe realizimi i instiucioneve për ndërmarrjen e masave kunder informalitetit ka zanafillën me ardhjen e një ekonomie të re në vend, kalimi një ekonomi e centalizuar në një ekonomi të lirë tregu, vështirësit dhe përpjekjet e qeverive përkatëse për analizen e kësaj ekonomie nuk ishin aspak të lehta dhe po thuajse të pamundura për tu realizur masat e duhur për hulumtime dhe analiza të veçanta. Me interes të veçantë nisën përpjekjet dhe realizimet e projekteve për studimin dhe matjen e ekonomis informale nga viti 2015 dhe këtej.

Shqipëria një vend me një ekonomi në zhvillim dhe me një force puntore prej 1.80 milion, studime të ndryshme llogarisin ekonomin informale me një mesatare përafërsisht 35% të PBB-së të vendit. E pa pranushme kjo mesatare apo jo?, e analizuar nga faktorë të ndryshëm që ndikojnë si në rritjen e saj ashtu edhe në zhvillimin e ekonomis në vend, shumë analiza dhe hulumtime pothuajse rrisin mesataren nga parashikueshmëria e saj.

Hulumtime të bëra ndër vite dhe krahasime nga analiza të ndryshme për të zbuluar shkakun dhe faktorët kryesor të rritjes së kësaj ekonomie, janë përmendur në këtë punim, duke u bazuar në statistika të marra nga vet qeveria e shtetit, Organizata Ndërkombëtare e Punës, Bankës së Shqipëris si dhe Bankës Botërore po edhe të tjerë.

Punimi interes të veçant ka pasë edhe në hulumtimin e kësaj ekonomie në qytetin e Shkodrës si dhe në të gjithë vendin. Veçanërisht në njërin ndër qytetet ku pritshmëritë e kësaj ekonomie vërtet janë të mëdha në krahasim me qytetet e tjera të vendit.

Duke pasur parasysh mos zbulimin e saktë të madhësis së ekonomisë informale, duke mos pasur statistika të sakta për zbulimin, analizës sonë i shtohen edhe debatet e kureshtjes së shkaqeve të natyrës së ekonomisë informale.

*Fjalët kyçe: Ekonomia informale, përmasat, shkaqet, faktorët, etj.*

## Абстракт

Истражувањето за неформалната економија е многу важно за земја чија економија е во развој и не само. Мерењата на неформалната економија во Албанија беа и се уште се многу тешки и не многу точни. Ова се должи на недоволната свест кај граѓаните, но и на не многу точниот начин на правилно искористување на оваа област. Во Албанија мерењето и реализацијата на институциите за преземање мерки против неформалноста започна со доаѓањето на нова економија во земјата, преминот од централизирана економија во слободна пазарна економија, тешкотиите и напорите на релевантните влади за анализата. На оваа економија не беше воопшто лесно и речиси невозможно да се спроведат соодветните мерки за посебни истражувања и анализи. Од особен интерес беа заложбите и реализацијата на проекти за проучување и мерење на неформалната економија од 2015 година наваму.

Албанија, земја со економија во развој и работна сила од 1,80 милиони, различни студии ја пресметуваат неформалната економија во просек со приближно 35% од БДП на земјата. Дали овој просек е прифатлив или не, анализиран од различни фактори кои влијаат и на неговиот раст и на развојот на економијата во земјава, многу анализи и истражувања речиси го зголемуваат просекот од неговата предвидливост.

Истражувањата направени низ годините и споредбите од различни анализи за откривање на причината и главните фактори за растот на оваа економија, се споменати во овој труд, врз основа на статистичките податоци добиени од самата државна влада, Меѓународната организација на трудот, Банката на Албанија, како и Светска банка и други.

Работата има посебен интерес за истражување на оваа економија во градот Скадар како и во целата земја. Особено во еден од градовите каде што очекувањата на оваа економија се навистина големи во споредба со другите градови во земјава.

Имајќи го предвид недостатокот на точно откривање на големината на неформалната економија, немањето точна статистика за обелоденувањето, во нашата анализа се додаваат љубопитните дебати за причините за природата на неформалната економија.

*Клучни зборови: Неформална економија, димензии, причини, фактори.*

## **Abstract**

Research on the informal economy is very important for a country whose economy is developing and not alone. Measurements of the informal economy in Albania have been and are still very difficult and not very accurate. This is due to the lack of awareness of the citizens themselves, but also because of the lack of proper use of this field. In Albania, the measurement and realization of the institutions for taking measures against informality started with the arrival of a new economy in the country, the transition from a centralized economy to a free market economy, the difficulties and efforts of the working governments for the analysis of this economy did not were not at all easy and almost impossible to carry out the appropriate measures for research and special analysis. Of particular interest are the efforts and implementation of projects to study and measure the informal economy from 2015 onwards.

Albania is a country with a developing economy and a labor force of 1.80 million, various studies calculate the informal economy with an average of approximately 35% of the country's GDP. Whether this average is acceptable or not, analyzed by different factors that affect both its growth and the development of the economy in a country, many analyzes and researches almost increase the average from its predictability.

Research done over several years and comparisons from different analyzes to discover the cause and the main factor of growth in this economy, are mentioned in this paper, based on statistics obtained from the state government, the International Labor Organization, the Bank of Albania as well as the World Bank and others.

The work has a special interest in the research of this economy in the city of Shkodra as well as in the whole country. Especially in one of the cities where the expectations of this economy are really big compared to other cities in the country.

Having previously not discovered the exact knowledge of the informal economy, not having the correct statistics for the discovery, our analysis also adds debates of curiosity and the causes of the nature of the informal economy.

*Key words: Informal economy, dimensions, causes, factors.*

## **Falenderim**

Nuk mund ta quaj vetëm falënderim por edhe mirënjohje të thellë, për të gjithë ato persona që kanë kontribuar me përkrahje morale, më kanë mbështet dhe motivuar në mënyrë të pandalshme e në mënyra të tjera, për realizimin e këtij punimi.

Në radhë të parë dua që bashkëshorti tim, Faikut, ti them faleminderit për mbështetjen dhe durimin e madh që ma ka dhënë për realizimin e këtij punimi dhe këtyre studimeve.

Faleminderit fëmijëve të mi, Belkisës, Malikut dhe Anikës, që më kanë lënë kohën e duhur për tu marrë me punimin dhe që janë motiv dhe forca e punës time dhe mbi gjithë këto vite studime falënderoj prindërit e mi, që më mbështetën financiarisht dhe moralisht për realizimin e ëndrrave të mia.

Një falënderim i veçant i shkonë mentores sime Shpresa Alija, për mbështetjen morale dhe për punën e përsosur duke më ndjekur dhe këshilluar dhe përmisuar këtë punim.

Por nuk mundem të le pa me përmend edhe personat, miqtë e mi të Shqipëris, Shkodrës më së shumti, që më ndihmuan me material dhe të dhëna sa hërë që un përmendja punimin tim.

**FALEMINDERIT!**

## **Deklarata e autorësisë**

Deklarojë së punimi i masterit me titull: **„Ekonomia informal, përmasat dhe efektet e saj në Republikën e Shqipërisë“**, e punuar nga unë e nënshkruara Kaltrina Nushi, është origjinal dhe asnjëherë më parë nuk është prezantuar në ndonjë univerzitet tjetër. Punimet e autorëve dhe hulumtuesve të tjerë që janë marrë për këtë punim mastër, janë cituar në formën dhe rregullat e duhura.

## Hyrje

Nga përditshmëria jonë dhe stili i jetës, duke parë për këtë punim hulumtime e statistika të ekonomisë së vendit mundet lirisht të themi se më shumë se gjysma e shqipëtarve në Shqipëri kanë punuar së paku një herë në “të zezë”, pa u paraqitur në institucionet qeveritare punuese, ku automatikisht këto persona llogariten si të papunë në vend. Duke u nisur nga studimet e më hershme të studiuesve të ndryshëm, si F. Schneider, A. Buehn, D. Enste, M. Hassan etj, të autorve në fjalë, gjatë viteve,<sup>1</sup> një definicion i saktë sa i përket ekonomisë informale nuk do ta gjenim të qartësuar për shkak të njohurive rreth zbatimit të politikave që ndjek kjo ekonomi, por edhe të shtirjes së përmasave dhe matjes së saj.

Për rrjedhojë, do ta përmbledhim me disa fjalë të kuptueshme si ekonomia në „hije“ apo ekonomia e „fshhtë“ ,ekonomia „jozyrtare“ dhe terme të tjera të vendosura për ta kuptuar pak a shumë termin se, me çfarë kemi të bëjmë. Shumë shtete në tranzicion edhe Shqipëria në fjalë, sidomos kohën e fundit ballafaqohet me ekonominë informale dhe në fakt janë marrë me studime të kësaj fushe për shumë arsye të ndryshe dhe sidomos sipas disa shkaqeve dhe zbatimit të disa politikave të cilat lidhen me ekonominë informale. Duhet theksuar se ekonomia Shqiptare pavarësisht se ka ecur dhe ka përmirësime sa i përket periudhës së tranzicionit, ajo vazhdon të përballet me ekonominë informale, që patjetër që është një pengesë e padëshiruar për rritjen e progresit të dëshiruar.

Me zhvillimin e ekonomisë së një shteti rriten edhe problematikat me të cilat ballafaqohet një shtet, përfshirë edhe rastin e Shqipërisë që ka pasur luhajtje ndër vite. Lirisht mund të thuhet se, ditëve të sotme ekonomia informale ka qënë me interes për politikë-bërësit e politikave fiskale, e sidomos pas vitit 2019, me rastin e tërmtit të nëntorit dhe me ardhjen edhe të pandemisë Covid-19 në Shqipëri, ekonomia informale ka shënuar një rritje - rritje kjo, që sipas Bankës Botërore<sup>2</sup>, për vitin 2021 vlerësohet me 30%-35% e PBB-së. Për më tepër, krahasuar me vitet e mëparshme, respektivisht sipas një studimi i kryer nga YE (Global leader in assurance, tax, transaction and advisory services), ekonomia informale deri në vitin 2017, ka qënë 22% e PBB-së, ku 19.1 e PBB-së, lidhet me pagesat e gatshme dhe 2.8% e PBB-së, lidhet me prodhimin jo-monetar - prodhim ky, i cili ka të bëjë me prodhimin familjar të mallrave për përdorim përfundimtar për veten e tyre. E sot, sipas ekonomisë botërore vendi jonë vlerësohet me një ekonomi informale me 31.9%, përafërsisht 17 miliardë dollarë, në nivelet e PBB-së<sup>3</sup>.

---

<sup>1</sup> Këto Autor, prej studimeve nga të cilat jemi bazuar edhe gjatë këtij punimi, ku disa prej tyre janë: “*Shadow Economies: Size, Causes, and Consequences*”, F. Schneider & D. Enste, the Journal of Economic Literature, Vo. 38, pp. 77-114 <https://www.aeaweb.org/articles?id=10.1257/jel.38.1.77>

“*Size and Development of the Shadow Economies of 157 Countries Worldwide: Updated and New Measures from 1999 to 2013*”, M. Hassan and F. Schneider, *IZA Discussion Paper No. 10281*, 2016 [https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract\\_id=2861026](https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=2861026) etj.

<sup>2</sup> Të dhënat ku bazohen hulumtues dhe jo sipas një të dhënë zyrtare qeveritare, për arsye të mundësjes së statistikave të sakta të marra nga vendi jonë, duke u bazuar edhe në raporte të ndryshme të gazetave të vendit, të cilat i marrin të dhënat gjithashtu nga Banka Botërore ose Banka Ekonomike.

<sup>3</sup> Për më shumë shërbehuni me : <https://www.worldeconomics.com/>



Sidoqoftë, mënyra e matjes dhe përcaktimi i ekonomisë informale mbetet shqetësim për vështirsinë që paraqet ky fenomen, dëshmuar edhe nga hulumtimi i autorit Dominik H. Enste, i cili e ndan në disa faza dhe faktorë të ndryshëm ku edhe do të bazohemi për punën tonë të mëtejme, respektivisht vlerësimin e ekonomisë informale të Shqipërisë. Vendi ynë, është një vend që ka potencial për zhvillimin e ekonomisë, një vend i mrekullueshëm i cili dhuron hapësirë për zhvillimin e vendit, por që nga shteti apo edhe nga njerzit nuk është e shfrytëzuar si duhet.

Për shembull, nëse e ndihmojmë fqinjin të ndërtojë shtëpinë e tij, të riparojë makinën e tij ose të ofrojmë ndihmë fqinje, atëherë kjo është pjesë e ekonomisë informale. Këtu përfshihen edhe punët e shtëpisë ose kujdesi për anëtarët e familjes. Ju gjithashtu llogaritni, për shembull, shitjen e gjërave të vjetra në tregjet e pleshtave dhe shumë shërbime vullnetare në të cilat ju ndihmoni njerëzit e tjerë. E gjithë kjo nuk regjistrohet nga statistikat, zhvillohet “në hije” dhe nuk vihet re nga organet zyrtare. Shumëçka nuk është e ndaluar drejtpërdrejt, në ndryshim nga puna e padëklaruar apo aktivitetet kriminale, ku fitohen shumë para.<sup>4</sup>

## **I. Qëllimi i punimit**

Ky punim nisi nga interesi personal dhe nga një sondazh me opinionin publik, duke parë se shumica e njerëzve në një rajon të Shqipërisë, konkretisht Shkodra, kanë nga një punë të dytë të padëklaruar dhe biznese të cilat i kryejnë pa pagesë të tatimeve kundrejt shtetit. Për më tepër, tema në fjalë synon të ngjall debat publik, respektivisht ngritje së vetëdijes së qytetarëve për pasojat e informalitetit, e që lidhen edhe me ofrimin e shërbimeve publike jocilësore. Ndonëse ekonomia informale si temë është tepër e gjërë, në këtë studim do të ndalemi në shqyrtimin e faktorëve dhe shkaqeve të nënvizuara që në fillim të studimit, pra cilët janë faktorët dhe fushat më të prekura nga ekonomia informale, si dhe arsyet se pse bizneset apo vetë personat publik nuk paguajnë detyrimet ndaj shtetit?

## **II. Rëndësia e temës**

Rëndësia e këtij studimi konsiston në detektimin e shkaqeve, apo faktorëve që nxisin ekonominë informale në Shqipëri, e sidomos në rastin konkret, pra Shkodrën. Numri i madh i të papunëve, ngadalsimi i rritjes së ekonomisë, varfëria e lartë dhe produktiviteti i ulët janë shoqëruesit kryesorë të ekonomisë informale. Duke u nisur nga kjo, ky studim merr përsipër jo vetëm vlerësimin e ekonomisë informale aktuale, por edhe evolucionin e saj përgjatë viteve, përfshirë edhe identifikimin e sektorëve mbizotërues në këtë dukuri kancerogjene për Republikën e Shqipërisë.

Për rrjedhojë, ekonomia informale përveç se ka qënë temë diskutimi i diskurseve ekonomike në shumë vende të botës, gjithashtu ka ngjallur interes hulumtimi tek vendet në tranzicion

---

<sup>4</sup>Për më shumë lexoni edhe në faqen përkatëse: <https://www.hanisauland.de/node/2374>

dhe ato në zhvillim. Zbatimi i tatimeve nga ana e vëmpritarive ekonomike dhe nga personat fizik të cilët ju shmangen detyrimeve të shtetit, punët e padeklaruar, përdorimi i tepërt i parasë në dorë (cash'it), si dhe përfshirja e aktiviteteve kriminele (prostuticioni, trafikimi i drogës, kontrabanda, etj.), kanë qenë shtytësit kryesorë për përzgjedhjen e kësaj teme.

Aktivitete të tjera të ekonomisë informale shkatohen gjithashtu edhe nga fakti se njerëzit përpiqen ta mënjanojnë humbjen duke ju shmangur detyrimeve tatimore dhe nga përdorimi i parasë në dorë. Për më tepër, problemi kryesor në lidhje me matjen e ekonomisë informale qëndron tek pesha relative e aktiviteteve të fshehura - peshë kjo, e cila ndryshon shpesh dhe sidomos ndër vite. Por nëse do të kishim supozuar se ekonomia informale do të ishte gjithmonë e barabart me 10% të GDP-së, të raportuar, atëherë GDP-ja, e matur do të tregonte me saktësi gjatë kohës ritmin e ndryshimit të GDP-së, të vendit. Por, nëse pretendojmë se ekonomia informale rritet në krahasim me ekonominë e matur, atëherë do të shohim se ritmi i matur i rritjes së prodhimit do të jetë më poshtë ritmit të vërtetë të rritjes<sup>5</sup>. Në vitet e fundit shohim një rritje të shpejtë të ekonomisë informale dhe një rritje të ngadalsuar ekonomike të vendit në një pjesë të madhe, një iluzion statistikor që nxit hulumtime shtesë në këtë fushë.

Andaj, rëndësia e këtij studimi konsiston edhe në plotësimin e literaturës aktuale dhe sjelljen e një studimi konciz që do të shërben si udhërefyese për studimet vijuese dhe pasurim të bibliotekës së Shqipërisë.

### **III. Objektivat dhe pytjet rrethë punimit**

Objektivat e këtij studimi janë sikurse në vijim:

- ofrimi i njohurive të përgjithshme rreth përkufizimit të ekonomisë informale;
- ofrimi i njohurive të përgjithshme rreth faktorve dhe rrethanave të cilat ndikojnë në ekonominë informale, më konkretisht rajonin e Shkodrës në Shqipëri;
- identifikimi i pasojave dhe shkaqeve të cilat shfaqen në ekonominë informale;
- identifikimi i masave në funksion të zvoglimit të ekonomisë informale.

### **IV. Metodologjia e punimit**

Informaliteti mbetet temë e diskutimeve të shumta pavarësisht nga shtrirja globale sidomos gjatë viteve të fundit, që në fakt shkakton në formë qëndrime jo mjaft të përshtatura që lidhen direkt me definicionin, qasjet, klasifikimin apo edhe matjeve ndaj tij. Matja e ekonomisë informale ka qënë çdo herë një debat në veti pasi edhe autor të ndryshëm si Schneider, M. Muco, Enste, R. Klinglmair etj., që janë marrë me studimin e matjes së

---

<sup>5</sup> Dornbuch, Rudiger. Fischer, Stanley: "Makroekonomia" – botim ndërkombetare. Përkthyer nga Prof. dr. Marta Muco, Prof. dr. Sulo Haderi. Tiranë, 2000.

madhësis së ekonomisë informale kanë hasur mangësi në zbatimin e modeleve të ndryshme, gjatë matjes së ekonomisë informale.

Për të parë tendencën e ekonomisë informale kemi marrë si shkas dhe ku do e bazojmë studimin tonë rastin e Shqipërisë.

Për të analizuar disa nga pyetjet që i kemi ngritur në fillim të studimit, sikurse:

- ✓ çka është për ne ekonomia informale?
- ✓ cilët janë sektorët më të ekspozuar nga kjo dukuri?
- ✓ në cilin vend mund ta radhisim Shqipërinë në krahasim me vendet tjera të Ballkanit Perëndimor, apo të Europës Juglindore?

Këto pyetje dhe disa të tjera që do të ekzaminohen në studim, do tentojmë t'ju japim përgjigje duke u bazuar në punime dhe statistika të marra nga Banka Botërore, nga Albania Investment Council, nga i Sekretariati i Këshillit të Investimeve, Ministria e Financave, si dhe nga studime të ndryshme të hollësishme.

Për realizimin e këtij studimi është përdorur metodologjia e kombinimeve të metodave të ndryshme, krahasim të punimeve dhe hulumtimeve të ndryshme nga të cilat do të nxjerrim edhe konkluzionet dhe rekomandimet tona rreth pyetjeve të shtruar dhe objektivave që ka ky studim. Tema është bazuar në literaturën shqipëtare dhe të huaj, respektivisht një miks shqyrtime të tyre, në punime dhe hulumtime të ndryshme, artikuj shkencor, publikime shkencore, si dhe në intervista të ndryshme të cilat kanë për bazë trajtimin e ekonomisë informale të shfaqur në Shqipëri, por edhe në shtete të ndryshme.

Për më tepër, ky studim do aplikojë edhe pyetësorin me një moster representative (model paraqitje) duke e sjellë në formatin online, por edhe shkresor (pyetësor direkt tek personat fizik), vetëm e vetëm të nxjerrim në pah se ku qendron Shqipëria në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, apo edhe të Europës.

## **V. Konkludimet dhe pritshmërit e studimit**

Ky punim synon të prezanton motivet dhe interesat, objektivet si dhe informacionin e nevojshëm që na motivoj si kërkues të studiojmë dhe hulumtojmë rreth këtij fenomeni, të vlersojmë fushën e gjërë të vështirësive të Shqipëtarëve që nuk arrijnë për me i kryer detyrimet e shtetit, që nuk paraqesin të ardhurat e tyre të vërteta, respektivisht mos paraqitjen e punës së dytë të personave fizik që shmangin taksat, dhe të bizneseve që punësojnë njerëz në menyrë jo ligjore. Duke bërë kërkime të ekonomisë informale dhe mbledhur të dhëna primare përmes anketimit, do të nxjerrim në pah se ekonomia informale në Shqipëri nuk paraqet vetem disavantazh, por edhe avantazh në zhvillimin ekonomik të vendit, pasi ato të ardhura shpenzohen sërish në ekonominë formale.

Ndonëse, sot, përdoren teknika të ndryshme për ta luftuar informalitetin, kjo e fundit kërkon informim të saktë, vetëdije edhe edukim të qytetarëve, si dhe bashkëpunim të mirëfilltë ndërmjet institucioneve qeveritare të shtetit. Andaj, për t'u afruar vendeve në zhillim

## Ekonomia informal, përmasat dhe efektet e saj në Republikën e Shqipërisë

Shqipërisë i duhet përmirësim të standartit jetësor - standard ky, që do të çoj më tej në reduktimin e ekonomisë informale. Sipas Bankës Botërore, për t'u barazuar apo për tu afruar vendeve në zhvillim, Shqipëria aktualisht po zbaton reforma të rëndësishme strukturore në drejtim të mbështetjes dhe rritjes së produktivitetit, krijimit të vendeve të reja të punës, përmisimit të qeverisjes dhe ofrimit të shërbimeve publike cilësore.

## KAPITULLI I: RISHIKIMI I LITERATURËS

### I.1. Përkufizimi i ekonomisë informale

Duke u nisur nga fakti që shumica e njerëzve nëpër botë e sidomos në Shqipëri, mendojnë që ekziston një mënyrë më e lehtë për të fituar më shumë para dhe një mënyrë për t'u pasuruar më shumë, ato përdorin rrugën më të lehtë dhe më të drejtpërdrejt- mos paraqitja e taksave kundrejt shtetit, fitimi i parave të pastra, fitime bruto etj. Njerëzit e tillë, por edhe të tjerë kanë perceptime të ndryshme për ekonominë informale ku disa fokusohen në aspektin e mbijetesës, e disa të tjerë që besojnë se këta persona që i quajmë si punëtor informalë nuk kanë zgjidhe tjetër veçse të drejtojnë biznese joproductive ose të punojnë në punë që kanë mungesë të përfitimeve sociale me kushte jo të mira të punës, me norma më të ulëta të shpërblimeve dhe produktivitetit.

Është e rëndësishme të dallojmë dëshirën apo nevojën për këtë lloj ekonomie. Ku nga ana tjetër themi që realiteti i informalitetit është shpesh më pak i dukshëm se sa i dukshëm. Por ky fenomen është shumë më i gjërë se sa ato vetë e kuptojnë dhe ky fenomen ndodh tek shumë njerëz të cilët kanë një punë të dytë apo tek ato firma që nuk kanë shumë fitime të cilat përqipen në një mënyrë a tjetrën që të kenë sa më shumë fitim që të mundën. Shmangin taksat detyrimet e shtetit për përfitime vetijake duke mos menduar se çfarë pasojash do të sjellë ky veprim për ekonominë e vendit.

Për sa i përket përkufizimit të ekonomisë informale ka mendime të ndryshme rreth përkufizimit. Studiues të ndryshëm e sidomos Schneider<sup>6</sup>, e quajnë jo vetëm informalitet por edhe ekonomi në „ hije“ apo ekonomi e „zezë“ si ekonomi e fshehur dhe terma të ngjashëm që kanë të bëjnë me perkufizimin e saj. Vështirësitë e zhvillimit ekonomik perceptojnë edhe krizën ekonomike apo papunësin e lartë si dhe rënien e ritmit të investimeve.

Një përkufizim tjetër nga Prof.dr. Binaj e kemi të përmbledhur fjalët se, ekonomia informale nënkupton të gjithë aktivitetet ekonomike që kontribuojnë në Prodhimin e Përgjithshëm Bruto -PBB-zyrtar, aktivitete të cilat nuk janë të regjistruara por edhe që nuk janë të taksuara rregullisht, por këto aktivitete nuk futen në pjesën tjetër të aktivitetëve siç janë ato *Kriminele* apo ndryshe që futen në ekonominë e „zezë“<sup>7</sup>.

---

<sup>6</sup> Përshtatur nga studimet e: Schneider, Friedrich G. and Buehn, Andreas, Estimating the Size of the Shadow Economy: Methods, Problems and Open Questions (October 31, 2013). CESifo Working Paper Series No. 4448, Available at SSRN: <https://ssrn.com/abstract=2353281> or <http://dx.doi.org/10.2139/ssrn.2353281>

<sup>7</sup> Përshtatur nga libri: Shqipëria në Tranzicion të zgjatur”, (politikat fiskale, korrupsioni, shpenzimet e mbrojtjes, arsimiti univerzitar, investimet, problemet të bujqësis, profesioni i kontabilitetit dhe Etika), Prof.dr. Agim Binaj, Tiran, 2018. Shtëpia botuese Ilar.

Në grafikun vijues janë përmbledhur shumë terme të cilët kanë lidhje me ekonomin informale.

Grafiku nr.1-Termet më të përdorura të ekonomisë informale.



Burimi: Të dhëna të mbledhura nga studimet e ndryshëm.


Nga shumë emra prej të cilëve është thirrur ekonomia "informale" nuk do të thotë se e karakterizon këtë llojë ekonomie por ajo që nuk bënë pjesë në këtë grup termesh ndryshe thuhet se kjo llojë ekonomie nuk është:

- 🚧 formale (joformale), nuk është e kontrolluar nga qeveria (jo në plan, jozyrtare, e paregjistruar)
- 🚧 nuk është legale-e ligjshme (jolegale, jo ligjore, e zezë, në hije) dhe nuk është i tatueshëm (i padeklaruar, paralel).

Sot, termet e ndryshëm të kësaj ekonomie përcaktojnë më së shumti se çfare fshihet pas tyre termave por që edhe kërkimet dhe hulumtimet e ndryshme sidomos kohën e fundit eksplorimet kanë rezultuar në një qasje më mirë, ku emrat dhe përkufizimet janë përdur për të përcaktuar më së miri apo më specifike elementët e ekonomisë informale si për shembull: varfëria që lidhet me mbijetesën, statusi i përkohshëm- sipërmarrje me një person, sipërmarrje familjare, që mbështetin familjarët, si dhe shumë emra të tjerë që karakterizon pak a shumë ekonominë informale sikurse në figurën vijuese<sup>8</sup> :

<sup>8</sup> Përshtatur nga studimet e: "THE GLOBAL DEVELOPMENT RESEARCH CENTER. The informal sector."  
<http://gdrc.org/informal/index.html>

Grafiku nr.2. Përdorimi i termave të ndryshëm nga studiues të ndryshëm të ekonomisë informale.



Burimi: Përshtatur nga studimet e The Global Development Research Center<sup>9</sup>

Nga të gjitha këto përkufizime e emra të ndryshëm të ekonomisë informale autorët austriak E. Hofbauer dhe W. Schüssel e përfundojnë se ekonomia në hije, punë e padeklaruar, "botch", emërtime për ofrimin e shërbimeve tregtare, por të padeklaruar për qëllime tatimore, në ndryshim nga ekonomia e rregullt. Ekonomia në hije shkakton miliarda dollarë në taksa dhe kontribute të sigurimeve shoqërore të humbura dhe heq urdhrat nga ekonomia e rregullt. Pjesa e ekonomisë joformale rritet me shtrirjen e ndikimit të shtetit në ekonominë e rregullt. Numri i të papunëve gjithashtu ndikon në shtrirjen e ekonomisë informale.<sup>10</sup>

<sup>9</sup> Figura më sipër sqaron me pak fjalë të gjitha termet të cilat do të përdoren dhe analizohen në punimin tonë

<sup>10</sup> Përshtatur nga literatura e: W. Hofbauer und W. Schüssel, Schattenwirtschaft in Österreich, 1984.

<https://www.aeiou.at/aeiou.encyclop.s/s169724.htm>

## I.2. Shkaqet dhe karakteristikat e ekonomisë informale

### I.2.1. Shkaqet e ekonomisë informale

Ndryshojnë llojet e shkaqeve nga vendet e ndryshme në botë, na intereson më së shumti ndikimi i informalitetit në zhvillimin ekonomik të vendit sidomos në vendet fqinje apo nëse shofim në vendet e Ballkanit perëndimor do të shofim se shkaqet më së shumti që paraqiten në këto vende janë si vijojnë:

- ✚ morali i ulët i tatimeve,
- ✚ niveli i lartë i papunësisë,
- ✚ mjedisi i dobët i bizneseve dhe nivele shumë të larta të varfërisë,
- ✚ perceptimet e korrupsionit,
- ✚ mungesa e besimit tek qeveria dhe të institucioneve publike,
- ✚ taksat e larta dhe kostot parafiskale ,
- ✚ politikat tatimore, sot llogaritet edhe shkak tjetër si cilësia e ulët e arsimit dhe sistemet e kujdesit shëndetsor,
- ✚ ndryshime të shpeshta të legjislacionit dhe ndërprerja e rënd e sistemeve të pagave.

Në Ballkanin perëndimor Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi po edhe Kosova kanë një faktorë të rëndësishëm në rritjen e ekonomisë informale, siç është **korrupsioni**, për shkak të perceptimit që organet tatimore kanë një tolerancë të lartë ndaj taksave dhe shëndetit social ku në përgjithësi sistemi publik i tyre është i korruptuar. Sipas një studimi të bërë nga „*The Balkan Trust for democracy*”<sup>11</sup> dalin që 45.7% të bizneseve në Maqedoninë e Veriut dhe 72.9% në Shqipëri janë të korruptuar, çka do të thotë se korrupsioni paraqet vërtet shkak shumë të rëndësishëm në ekonominë e fshehtë.

Përveç korrupsionit që paraqet një shkak të fortë në nxitjen e informalitetit gjithashtu niveli i taksimit është një shkak në vete. Norma e taksave janë më të larta në Serbi dhe Shqipëri prej vetëm 15%. Megjithatë barra e përgjithshme tatimore mbi punësimin konsiderohet e lartë , në kushtë të nivelit të lartë të punësimit. Kurse në Mal të Zi nuk ka asnjë progresiv tatimor, por 39% e pages bruto shkon për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, përfitimet, taksat kombëtare dhe lokale.<sup>12</sup>

Po ashtu përmbledhim këndvështrimet që gjithashtu përqipen të shpjegojnë shkaqet e ekonomisë informale sipas qeverisë Shqiptare tek një dokument pune mbi informalitetin edhe atë<sup>13</sup>:

---

<sup>11</sup> Për më shumë , shprehuni me:” The Balkan Trust for democracy”. <https://www.gmfus.org/balkan-trust-democracy-grantmaking>

<sup>12</sup> Po aty.

<sup>13</sup> Për më shumë, lexoni: DOKUMENT PUNE-INFORMALITETI, SFIDË E PËRBASHKËT QEVERI-SIPËRMARRJE.

<https://www.investment.com.al/ëp-content/uploads/2015/08/Dokument-Pune-mbi-Infomalitetin.pdf>



- ❖ E para shpjegon mbi sektorin informal se ka të bëjë me atë që është i rezervuar nga sipërmarrësit potencialisht produktivë, ku për shkak të kostove të larta, po ashtu edhe rregulloreve të hyrjes, përfshihen në ekonomin informale.
- ❖ E dyta i sheh njerëzit informalë si "parazitë" sepse ata janë mjaft produktiv për të mbijetuar në sektorin zyrtar, të cilët për të marrë fitime më të mëdha ato vendosin të përdorin informalitetin, për shkak të avantazheve të mosrespektimit të taksave dhe rregulloreve.
- ❖ E treta po ashtu deklaron se informaliteti është një strategji mbijetese për njerëzit me aftësi të ulëta, të cilët janë tepër joproduktiv për t'u bërë zyrtarë.<sup>14</sup>

Në ekonomin informale tash më shkak kryesor llogaritet –**norma efektive tatimore**, ku llogariten: *tatimet mbi të ardhurat, TVSH, taksat doganore*. Se si ndikojnë këto faktorë në ekonominë informale mund të themi se taksat mbi të ardhurat dhe TVSH priten që të kenë një ndikim pozitiv sa i përket ekonomis informale kurse taksat doganore priten që të kenë një efekt negativ në ekonomin informale. Nuk mundemi pa me e përmend ndërhyrjen e shtetit që paraqitet si shkak tjetër i ekonomis informale. Shteti mund të përdor shumë metoda sa i përket informalitetit, ndërhyrja e tij nëpër biznese shkakton tension që nxisin informalitetin. Ndërhyrja e shtetit në ekonomi ndikon jo vetëm në rritjen e zvoglimit të lirisë në ambientin ekonomik sipas rregullatorëve që vendon ai vet dhe gjithashtu shtynë agjentët ekonomik që të punojnë në ekonomin informale.<sup>15</sup>

Një tjetër shkak i rëndësishëm që paraqitet në ekonomin informale është gjithashtu edhe **norma e papunësisë**. Një shtet llogaritet që ka një ekonomi të zhvilluar kur norma e shkallës së papunësisë është e vogël dhe e kundërta. Ka shumë punë në një vend si rasti i Shqipërisë por statistikat e shtetit tregojnë të kundërtën, njerëzit punojnë jo vetëm nga një punë por ato mbajnë edhe një punë të dytë, po këtë të dytën nuk e deklarojnë. Rritja e papunësisë në fakt nxit individët e papunë që të pranojnë punë të paguhen ndoshta më lirë, ku pagat dhe çmimet e këtyre të mirave materiale dhe shërbimet janë më të ulëta se ato në ekonomin formale.

Përveç normës së papunësisë që paraqiten si shkak i ekonomis informale gjithashtu edhe **norma e inflacionit** është studiuar si një nga shkaqet e ekonomis informale. Sipas një studimi mbi ekonomin informale në Malta, Cessar, autori i studimeve të Trebickës, thekson se normat e larta të inflacionit rrisin ekonomin informale për arsye se: rritja e inflacionit rrit kërkesën për të mira materiale dhe shërbime me çmime të ulëta në ekonominë informale dhe e dyta arsye është se efekti i taksave, në një vend ku taksat e shtetit janë jo fort të përballeshme bëjnë që individët të pranojnë llojet e ekonomisë informale, respektivisht të punojnë në këtë lloj ekonomie vetëm me arsyen e vetme që tu shmangen taksave shtesë.<sup>16</sup>

---

<sup>14</sup> Për më shumë, lexoni: DOKUMENT PUNE-INFORMALITETI, SFIDË E PËRBASHKËT QEVERI–SIPËRMARRJE.

<https://www.investment.com.al/wp-content/uploads/2015/08/Dokument-Pune-mbi-Informalitetin.pdf>

<sup>15</sup> Për më shumë shprehuni me: „Tranzicioni dhe Liria Ekonomike në Shqipëri”, Prof.dr. Anastas Angjeli. Tiranë, 2007 shtëpia botuese Geer.

<sup>16</sup> Për më shumë shërbehuni me studimin e :“ Ekonomia informale, shkaqet dhe pasojat e saja ne Shqipëri“. TRebicka, Brunela.

### ***1.2.2. Karakteristikat e ekonomisë informale***

Kemi përfshirë një grumbull *karakeristika të ekonomisë informale* pasi në studimet e mëparshme kemi hasur lloje të ndryshme mendimesh që lidhen me këto karakteristika dhe pavarësisht studimeve dhe mendimeve të ndryshme ne kemi konstatuar disa nga këto lloje, ku do të ndalemi në karakteristika të cilat do ti përmendim në vijim:

- Madhësia e ekonomisë informale
- Hyrjet në ekonominë informale
- Nuk ka paga fikse ose orë fikse pune dhe kryesisht mbështetet në fitimet ditore.
- Llojet e përfshirjes në informalitet
- Mos siguria, nuk ka kontratë, nuk ka rregulla apo marrëveshje të shkruara.
- Në të shumtën e rasteve nuk ka higjienë dhe atmosfera e punës është e mbingarkuar.
- Personat të cilët punojnë në këtë llojë ekonomie nuk pranojnë që ti zgjedhin apo trajtojnë problemet e tyre përmes ndonjë qëndre trajtimi apo shoqate.<sup>17</sup>

Ndër këto karakteristika që përmendëm më sipër mund të konstatojmë se, një ndër karakteristikat kryesore të ekonomisë informale, mund të theksohet se sa më e madhe të jetë numri i përqindjes së ekonomisë informale, aq më e madhe është madhësia e përbërës të saj të bizneseve të vogla në sektorin informal dhe kontributi i saj në PBB. Po si qëndron kontributi i ekonomisë informale në PBB? Në fakt aktivitetet e ekonomisë informale të një vendi nuk përfshihen në produktin kombëtar brutë (GNP) të një vendi apo në produktin e brendshëm brutë PBB, në shumë raste duke ndryshuar nga ekonomia formale.<sup>18</sup>

#### **Madhësia e ekonomisë informale**

Rreth madhësisë së zhvillimit të ekonomisë informale sot nëpër botë janë rritur hulumtimet apo kërkimet, metodat për përcaktimin e saj si dhe mënyrat e të vlersuarit. Ka qat shumë metoda sa është e vështirë për tu besuar dhe mjaft e vështirë për të gjykuar besueshmërinë e këtyre metodave të ndryshme për përcaktimin e madhësisë së ekonomisë informale. Madhësia e ekonomisë informale si një karakteristikë e saja varet nga shteti dhe ekonomia formale, apo zhvillimi ekonomik i një vendi. Nuk e përcaktojmë dot pavarësisht kushteve të matjes së saj. Por që mund të themi se vendet të cilat janë në tranzicion janë vende që kanë një ekonomi informale më të lartë se sa vendet të cilat janë në zhvillim.

---

<sup>17</sup> Pavarësisht se këto lloje trajtime apo këto grupe shoqërore nuk i gjejmë ne vendet e pazhvilluara mirë ekonomikisht siq janë vendet e ballkanit apo edhe nëpër botë. Këto lloje trajtime u mundësojnë personave të ndërgjegjsohen me faktin që ky llojë veprimi jo vetëm që është i dëmshëm për veten e tyre sidomos në të ardhmen por gjithashtu edhe për ekonominë e vendit nuk është e përthatshme. Ata persona kanë nivele të dobta ndërgjegjësimiti në lidhje me skemat e mbrojtjes sociale, nuk janë në gjendje të bëjnë kursimë dhe nuk e shohin domosdoshmërinë e sigurimit të tyre.

<sup>18</sup> Përshtatur nga pyetori online në lidhje me ekonominë informale: "How to measure informality" anketë online.

<https://lwworc.org/sq/how-to-measure-informality>

### Hyrjet në ekonomin informale

Sa i përket hyrjeve në ekonominë informale mund të themi se hyrjet janë të lehta për tu përfshirë në të, pasi kushdo që dëshiron të fitojë ,para të pastra’ përfshihet lirisht në të.

Ekonomia në hije është fushëveprimi i të gjitha aktiviteteve dhe shërbimeve ekonomike që nuk përfshihen në llogaritjen e produktit kombëtar. Në këtë mënyrë të të bërit biznes, fitohen të ardhura në mënyrë të ligjshme ose të paligjshme, të cilat nuk regjistrohen në statistikat zyrtare ekonomike dhe nuk taten nga shteti. Aktivitetet në ekonominë në hije mbahen qëllimisht sekret për të shmangur rregullimin shtetëror ose pagesat e taksave.

Sipas Schneider i cili është bazuar në studimet e Lippert dhe Walker, ekonomia në hije përbëhet nga dy shtylla<sup>19</sup>:

- një pjesë jolegale, e cila njihet edhe si ekonomia e nëndheshme, dhe
- një pjesë legale -ekonomia e vetë-mjaftueshmërisë.

<i>Llojët e aktiviteteve</i>	<i>Transaksionet monetare</i>		<i>Transaksionet jo monetare</i>	
<i>Aktivitetet jolegale</i>	Mallrat e vjedhura-tregti, Prodhimi dhe tregtimi i drogës, Lojrat e fatit, Prostitucioni,etj.		Shkëmbim droge, Kontrabandë e mallra të vjedhura., Prodhimi dhe kultivimi i drogave të ndryshme për përdorim vetjak., Vjedhje për interes vetjake.,etj.	
<i>Aktivitetet legale</i>	<i>Evazioni fiskal</i>	<i>Shmangia e tatimeve</i>	<i>Evazioni fiskal</i>	<i>Shmangia e tatimeve</i>
	Të ardhurat që nuk raportohen nga fitimi i vetpunësimit. Pagat, mëditjet dhe pasuritë nga puna që fshihet në lidhje me shërbimet dhe mallrat juridik.	Zbritje për punonjësit – përfitime anësore.	Shkëmbimi i shërbimeve juridike dhe mallrave	Punët që kryhen vetë dhe ndihma nga të tjerët.
<i>Burimi: Schneider dhe Buehn:Estimating the Size of the Shadow Economy<sup>20</sup></i>				

19 Për më shumë shërbehuni: Schneider, Friedrich G. and Buehn, Andreas, Estimating the Size of the Shadow Economy: Methods, Problems and Open Questions (October 31, 2013). CESifo Working Paper Series No. 4448, Available at SSRN: <https://ssrn.com/abstract=2353281> or <http://dx.doi.org/10.2139/ssrn.2353281>

<sup>20</sup> Përshtatu nga: Schneider, Friedrich G. and Buehn, Andreas, Estimating the Size of the Shadow Economy: Methods, Problems and Open Questions (October 31, 2013). CESifo working Paper Series No. 4448, Available at SSRN: <https://ssrn.com/abstract=2353281> or <http://dx.doi.org/10.2139/ssrn.2353281>

Aktivitetet ekonomike që përfshin ekonomia informale nuk regjistrohen apo edhe të kontrollohen nga shteti dhe si rrjedhojë nuk kanë as mbrojtje apo mbështetjen e shtetit. Ato (aktivitete) shpesh përfshijnë prodhimin bujqësor në shkallë të vogël me fokus rajonal dhe lokal, punë të thjeshtë, punë të pakualifikuar dhe punë "punëtor ditor" në sektorin e shërbimeve, ose në industri. Dhe shpesh në kushte të pasigurta pa asnjë mbrojtje nga ligji i punës ose shoqëror. Sektori informal është mjaft kompleks për ta analizuar për shkak të mungesës së saktë të statistikave të mbledhura nga shteti, është dinamik dhe elastik. Është dinamik për shkak të përhapjes së shpejt dhe të shpeshtë, mbizotëruese sidomos në vendet në tranzicion. Ekonomia informale ekziston në ndërveprim të ngushtë me sektorin formal.<sup>21</sup>

### Llojët e përfshirjes në informalitet

Llojët e përfshirjes në ekonomin informale në përgjithësi ndahen në dy lloje aktivitete të cilat i këmi quajtur si: *aktivitete nëntoksore dhe ato jozyrtare biznesi*. Pjesa ligjore përfshin aktivitete të tilla si kujdesi në shtëpi dhe puna vullnetare, për shembull brigada vullnetare e zjarrfikësve, grupet e ndihmës së lagjes ose vetëndihmës. Në vijim flitet kryesisht për pjesën ilegale të ekonomisë së nëndheshme. Aktivitetet e paligjshme të ekonomisë informale janë të gjëra, duke filluar nga puna e padeklaruar deri te krimi i drogës dhe trafikimi i qënieve njerëzore.<sup>22</sup> Në tabelën e mëposhtme janë të qartësuara llojet e përfshirjes së aktiviteteve të cilat përfshinë:

<i>Aktivitete nëntoksore</i>	<i>Aktivitete jozyrtare biznesi</i>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Aktivitete të paregjistruara nga zyrat statistikore</li> <li>• Korrupsioni</li> <li>• Aktivitetet kriminele, sikurse: prostitucioni, tregtimi dhe trafikimi i drogës, tregtia e mallrave të vjedhura, bixhozi, kontrabanda, mashtrimet.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Evazoni fiskal</li> <li>• Ikja nga aktivitetet ligjore mos regjistrimi i bizneseve</li> <li>• Mos respektimi i rregullave të punës</li> <li>• Shmangia e taksave</li> <li>• Aktivitetet nga vetpunësimi</li> <li>• Pagat që nuk janë të raportuara, jo të paraqitura në lidhje me shërbimet juridike dhe mallrat<sup>23</sup></li> </ul>

Është shumë e larmishme puna që bënë kjo ekonomi e sidomos sa i përket teknologjisë që përdor, kapitalit të investuar si dhe të ardhurat e krijuara. Roli që luan një ekonomi informale në një vend është e qartë pasi ndodh shpesh që kemi të bëjmë me një ekonomi

21 Përmë shumë shërbehuni me: "A question of definition: What is the informal sector?" whats in a name? what the difference?. <http://gdr.org/informal/001-define.html>

22 Përshtatur nga: Statistikat e studimeve të ekonomisë informale.

<https://de.statista.com/statistik/daten/studie/163720/umfrage/schattenwirtschaft-in-der-oecd-2010/#professional>

23 Përmë shumë shërbehuni me: "A question of definition: what is the informal sector?" whats in a name? what the difference?. <http://gdr.org/informal/001-define.html>

informale të ulët kur ekonomia e një vendi është në zhvillim dhe është në rritje kur ekonomia e një vendi ndodhet në recension.

### **Nuk ka paga fikse, ose orë fikse pune dhe kryesisht mbështetet në fitimet ditore**

Nuk ka paga fikse ose orë fikse pune dhe kryesisht mbështetet në fitimet ditore. Shumica e punëtorëve të sektorit informal preferojnë që puna e tyre të kryet me orë më të shkurtra se sa puna formale dhe preferohet që paga të bëhet në dorë. Dhe për ato punëtor që janë sipërmarrës të vet fitimet ditore mbështeten zakonisht nga puna ditore që bëjnë.<sup>24</sup>

### **Mos siguria, nuk ka kontratë dhe rregulla, apo marrëveshje të shkruara**

Punëtorët e sektorit informal nuk është se kanë një punë të sigurt apo një pagë fikse edhe ato të cilët janë të vetëpunësuar ose me rrogë nuk është se kanë qasje në punë të sigurt, shpërblime, përfitime apo mbrojtje sociale. Ku më së shumti bazohen në punësime të rastësishme, marrëdhënie personale apo shoqërore, familjare se sa në marrëveshje kontraktuale me garanci zyrtare. Nuk është se ka një punë të sigurt, pagat janë të ulta dhe marrëdhëniet midis punëdhënësve dhe punëtorve nuk është se ka.

### **Në të shumtën e rasteve nuk ka higjienë dhe atmosfera e punës është e mbingarkuar.**

Pavarsishtë punës ku përfshihet më së shumti ekonomia informale, në Shqipëri mund të themi se higjiena në ato vende pune nuk është e një niveli të njëjtë me punët e rregullta apo të kontrolluara edhe nga shteti. Mbingarkesa e këtyre punëve është shumë më e madhe pasi kontrolli i tyre nuk është në një hap përpara se të tjerët. Në këtë kategori më së shumti hynë edhe sektori bujqësor apo shitja e peshkut në trotuar, shitja e perimeve dhe pemeve nëpër trotuare e sidomos shitja e qumshtit nëpër shishe plastike të mos pastruara mirë apo mos riciklim.

### **Personat të cilët punojnë në këtë llojë ekonomie nuk pranojnë që ti zgjedhin apo trajtojnë problemet e tyre përmes ndonjë qëndre trajtimi apo shoqate**

Shumë njerëz mundohen që ti fshehin transaksionet të cilat nuk janë në përputhje me ligjet e taksave, apo edhe veprimtaritë të cilat i kryejn në mënyrë të fshehur dhe jo të drejtpërdrejt me ligjet e shtetit. Por çfarë nënkupton kjo për shumicën e njerzve të cilët kryejnë këtë veprim. Ata thjeshtë as që nuk duan të përfshihen në zgjedhjen e këtyre problemeve apo paraqitjen e zgjedhjes së problemeve. E sidomos nëse përmendim rastin tonë të Shqipërisë patjetër që do të shohim se programet e trajtimeve të ndryshme për njerëz të cilët kanë nevojë ndoshta për trajtime të tilla, mungon. Dhe vetëdija e personave fizikë që mirren me këtë ekonomi, nuk i çon në logjikën e shëndosh, duke anashkaluar shumë gjëra të rëndësishme si për veten e tyre në radhë të parë, ashtu edhe për shtetin ku jetojnë.<sup>25</sup>

<sup>24</sup> Përshtatur nga: Muharremi, Oltiana. "Tax Evazion and Set Backs of the Shadow Economy in Albania", Rome-Italy, 2014.

<sup>25</sup> Për më shumë shprehu me: A question of definition: What is the informal sector? What's in a name? What the difference?. <http://gdrc.org/informal/001-define.html>

Shumë shoqëri, ekonomin informale e llogarisin si të paligjshme, një fenomen i cili është përhapur ditëve të sotme në Shqipëri por edhe në botë, veprimtari ku përfshin më së shumti ekonomin e „zezë“ apo atë kontrabandiste, si më i shpeshtë ajo trafiku i drogës, të tjera shoqëri i konsiderojnë të paligjshme veprimarinë edhe transportin por edhe ndërtimet private gjithashtu kufizojnë edhe lirinë individuale.<sup>26</sup> Ku një kufizim i tillë mund të çojë në krijiminë e një tregu informal. Nga kjo mund të arrijmë në konkluzionin se tregu informal pasqyron kufizimet, tatimet apo të metat e tregut privat. Dhe si për rrjedhojë, sa më i madh tregu informal, aq më e lartë është vlera e këtij faktori dhe aq më i ulët është niveli i lirisë ekonomike dhe e kundërta, sa më i vogël tregu informal dhe sa më pak mbizotëruese të jenë veprimtaritë informale, aq më e ulët është vlera e këtij faktori dhe aq më e madhe është liria ekonomike.<sup>27</sup>

Sipas një studimi të OECD-së në vitin 2019 ku tregon se bota ballafaqohet me ekonomin informale, e kreu pothuajse është e përfshir në informalitet. Shumica e popullsisë së punësuar në botë është në punësim informal nga ku kanë konstatuar se 2 miliardë punëtor, të cilët përfaqësojnë rreth 61% të të gjithë puntorëve, duke prekur kjo përqindje vetëm sektorin e bujqësisë dhe 50% të cilët nuk përfshihen në këtë sektor.<sup>28</sup>

Infomaliteti ndodhë në të gjitha llojet e punësimit dhe sipas OECD-së globalisht përfshin mbi 4 nga 5 punëtorë nga llogari të vet, 1 nga 2 punëdhënës, 2 nga 5 punonjës dhe të gjithë punëtorët kontribues të familjes. Kjo përmbledhje analizon sektorët e bujqësisë dhe industrisë të cilat janë më të ekspozuarit ndaj informalitetit. Gati 94% e puntorëve në botë të bujqësisë dhe 57% e punëtorëve të industrisë janë infomal. OECD-ja paraqet 70% informalitet të të gjithë punësimit në vendet në zhvillim dhe ato në tranzicion, krahasuar me rreth 18% me vendet e zhvilluara.

---

<sup>26</sup> Në këtë punim nuk do të analizojmë edhe këtë pjesë të ekonomisë informale, sepse vlera ekonomike e këtyre aktiviteteve kriminale nuk mund të vlerësohet dhe ne nuk kemi pas mundsinë për tu hyr me thell atyre analizave.

<sup>27</sup> Përshtatur nga libri “Tranzicioni dhe liria ekonomike në Shqipëri” Angjeli, Anastas ; red. Sabah Ilmia, Fatos Dega. Tiranë:2007.

<sup>28</sup> Për më shumë lexo: <https://www.oecd-ilibrary.org/docserver/939b7bcd-en.pdf?expires=1657227615&id=id&accname=guest&checksum=2B8C9874132DE329D3696899428FDFB4>

### I.3. Faktorët kryesor që ndikojnë në rritjen e ekonomisë informale


#### I.3.1. Faktorët që ndikojnë në ekonominë informale

Ekonomia informale në vendet në zhvillim nuk e shohin gjithmonë si diçka negative por ekonomia informale në këto vende ofron mundësi punësimi, sidomos për ato që nuk kanë siguri punësimi, siguri pune dhe sigurim social. Një ekonomi lehtësisht e aksesueshme e cila gjithashtu ofron një mundësi për të fituar aftësi dhe njohuri për të kaluar në një ekonomi formale. Drejtuesit kryesorë të informalitetit numërohen: konteksti ekonomik dhe kornizat ligjore, rregulloret dhe politike, informaliteti mund të paraqitet ndryshe në varësi të kontekstit ekonomik të një vendi. Ekonomia informale përfshin aktivitete apo profesione të ndryshme si: shoferët e minibuseve në ekonominë në zhvillim deri tek punëtorët e ndërtimit në ekonominë e përparuar. Punëtorët informal fitojnë paga më të ulëta në krahasim me kolegët e tyre në sektorin formal, pasi atyre u mungon mbrojtja sociale dhe akses në kredi.<sup>29</sup>

Faktorët që ndikojnë në një ekonomi informale të një vendi varen nga zhvillimi ekonomik i vendit. Nëse krahasojmë vendet e Ballkanit perëndimor aty këtu gjejmë faktor të njëjtë që nxisin informalitetin në krahasim me vendet e Evropës apo nëpër botë. Numërohen një sërë faktorësh që mendohen që ndikojnë në zhvillimin ekonomik informal, pavarësisht numrit të rritjes së saj. Si një faktor i rëndësishëm në vendet me informalitet më të madh mund të llogaritet:

- ✚ Korrupsioni
- ✚ Evazioni fiskal
- ✚ Tregu i punës
- ✚ Arsimimi
- ✚ Ekonomia e Cash-it

**Grafiku nr. 3: Faktorët që ndikojnë në ekonominë informale<sup>30</sup>**



Burimi: I përshtatur nga botimi i Davigo Piercamillo, Sistemi i korrupsionit.

<sup>29</sup> Për më shumë shprehuni me: Organizata Ndërkombetare e punës. [https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---dgreports/---integration/documents/publication/wcms\\_079142.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---dgreports/---integration/documents/publication/wcms_079142.pdf)


<sup>30</sup> Burimi i përshtatur nga: Sistemi i korrupsionit Piercamillo Davigo botime perkttime nga italishta Zamir Poda, Tiranë 2015

Nga grafiku më sipër shohim që si një faktor i rëndësishëm i rritjes së ekonomisë informale të llogaritura në vitin 2015 nga studimet e Podës, paraqet korrupsionin me 37% të ndikimit nga llogaritja e krahasimit me faktorët e tjerë. Arsimiti gjithashtu është një faktor i rëndësishëm me 25% të mesatares së rritjes së ekonomisë informale, pasaj kemi sistemin tatimor 19% po ashtu edhe evazionin fiskal 13% por edhe shumë faktorë të tjerë nuk janë përmendur në grafikun më sipër.

Po ashtu edhe sot, rol të rëndësishëm në rritjen e mesatares së ekonomisë informale nëpër botë por edhe në vendin tonë, luajnë faktorët e përmendur më sipër. Korrupsioni mbetet në listën e rëndësishme të faktorëve, e ndjekur nga evazioni fiskal, sistemi tatimor, etj.

Nëse bëjmë krahasime me faktorët që ndikojnë në vendin tonë, duke u bazuar në statistikat e vendit, duke parë përqindjet tek Sekretariati të Këshillit të Investimeve në Shqipëri do të shohim një rëndësi të faktorëve që ndikojnë në ekonominë informale duke parë grafikun më poshtë:

Grafiku nr.4. Disa nga faktorët që ndikojnë në ekonominë informale në Shqipëri



*Shenim: Grafiku është marrë nga burimet e Sekretariatit të Këshillit të Investimeve në Shqipëri të krijuara nga statistikat e pyetjeve të bizneseve. I bazuar nga gazeta "Monitori".<sup>31</sup>*

Nga faktorët që nxisin informalitetin numërohen të shumta por sipas burimeve të marra nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve në Shqipëri të cilët janë bazuar nga përgjigjet e bizneseve të hapura nga pyetjet e formuluar shohim se faktorët më kryesorë që nxisin informalitetin janë korrupsioni dhe ndikimi politik. Grafiku më sipër i bazuar nga gazeta online "Monitor", të dhëna të dala nga viti 2015, sqaron përqindjet që përfshin<sup>32</sup>shkaqet më së shumti që nxisin informalitetin,43% përfshin korrupsioni dhe ndikimi politik, 39% përfshin

31 Grafiku i marrë nga: Sekretariati i Këshillit të investimeve në Shqipëri, <https://www.monitor.al/korrupsioni-dhe-ndikimi-politik-shkaqet-kryesore-qe-nxisin-informalitetin-ne-shqiperi/>

32 Përshtatur nga gazeta online: Monitori. Me titull: "Korrupsioni dhe ndikimi politik, shkaqet kryesore që nxisin informalitetin në Shqipëri." <https://www.monitor.al/korrupsioni-dhe-ndikimi-politik-shkaqet-kryesore-qe-nxisin-informalitetin-ne-shqiperi/>



taksat e larta kurse përqindjet të tjera përfshin shkaqet si cilësia dhe qëndrueshmëria e Legjislacionit, konkurenca e pandershme, fragmentizmi i sistemit tatimor, niveli i ulët ekonomik e te tjera.<sup>33</sup>

Në fakt inflacioni pavarësisht se tenton që të jetë jo i barabartë në të gjithë sektorët, ky efekt i përhapjes së tyre ndryshon shpërndarjen e të ardhurave dhe paraqet edhe mosrespektimin e taksave ndaj shtetit ku themi se sa më i lartë të jetë inflacioni aq më i madh pritet që të jetë madhësia e ekonomisë informale.

Një tipar tipik i ekonomisë informale janë strukturat e mirë organizuara që vështirësojnë hetimet e policisë në këtë fushë. Këto janë shpesh organizata kriminale, shembuj të spikatur janë strukturat e mafias Italiane apo strukturat klanore apo i ashtuquajturit krim *biker*. Bazuar në numrin e hetimeve për krimin e organizuar, shumica e krimeve që përfshijnë trafikun dhe kontrabandën e drogës zbulohen nga policia. Numri i hetimeve në fushën e krimit të organizuar ka mbetur relativisht konstant vitet e fundit, por të ardhurat e vlerësuara nga aktivitetet e ndryshme të organizuara janë zhvilluar në një nivel të lartë - vetëm në vitin 2020, të ardhurat financiare të vlerësuara ishin mbi një miliard euro.<sup>34</sup>

Aktivitetet profesionale ose shërbimet pa fatura dhe taksa quhen punë e padeklaruar. Puna e padeklaruar shpesh nuk konsiderohet vepër penale, por më tepër një vepër e parëndësishme. Megjithatë, dëmi ekonomik i shkaktuar nga puna e padeklaruar nuk duhet të nënvlerësohet. Dëmi financiar i shkaktuar nga hetimet e agjencisë së kontrollit financiar vetëm për punën e padeklaruar ka shkuar në më shumë se 800 milionë euro në vitin 2020, dhe numri i rasteve të pa raportuara do të thotë se dëmi është në miliarda. Në shumë raste, çështja e punës së padeklaruar përfshin shfrytëzimin e njerëzve deri në trafikimin e qënieve njerëzore. Shfrytëzimi i njerëzve nuk prek vetëm aktivitetet seksuale në lagjen e dritave të kuqe, industria e ndërtimit apo fusha të tjera profesionale janë gjithashtu zona të shfrytëzimit të punës.<sup>35</sup>

---

<sup>33</sup> Përshtatur nga gazeta online: Monitori. Me titull: "Korrupsioni dhe ndikimi politik, shkaqet kryesore që nxisin informalitetin në Shqipëri." <https://www.monitor.al/korrupsioni-dhe-ndikimi-politik-shkaqet-kryesore-qe-nxisin-informalitetin-ne-shqiperi/>

<sup>34</sup> Përshtatur nga : Prognose zur Entwicklung der Schattenwirtschaft in Deutschland im Jahr 2022. F. Schneider und dem Institut für Angewandte Wirtschaftsforschung (IAEW).

<https://de.statista.com/themen/5373/schattenwirtschaft/#dossierKeyfigures>


<sup>35</sup> Po aty.

#### I.4. Shkollat (mendime) mbi metodat e matjes së ekonomisë informale

Në fillim të punimit kemi përmend se nëse do të duhet një analizë e mirëfillt e studimeve të informalitetit do të duhen statistika të sakta, metoda për matjen e saj si dhe burime të sakta të marra jo vetëm nga qeveria e një shteti. Për të bërë matjen e saktë të ekonomisë informale është një mënyrë e vështirë dhe një sfidë në vete. Sipas Schneider ekzistojnë tre metoda karakteristike të ndryshme të cilat janë të diskutueshme për matjen e ekonomisë informale.


Pavarësisht hulumtimeve të ndryshme rreth informalitetit nga studiues të ndryshëm e sidomos kohën e fundit e për shkak se ekonomia informale mbetet temë e diskutimeve të shumta globale që në faktë shkakton edhe forma të ndryshme të mendimeve lidhur me të. Për këtë arsye e shumë të tjera ekzistojnë katër llojë shkolla (mendime) që formojnë pasqyrimin e përbërjes së saj siç janë: shkolla dualiste, strukturaliste, shkolla legaliste dhe voluntariste. Me pak fjalë këto shkolla se siç shohin këndvështrimin e tyre lidhur me ekonominë informale do t'i rëndisim si me poshtë:

Figura nr.1. Shkolla e dualistëve



<sup>36</sup> Burimi i përshtatur nga : „ Informal Economy Opportunities and Urban Employment in Ghana“, Keith Hart, The Journal of Modern African Studies, Vol. 11, No. 1, 1973, pp. 61-89, published by Cambridge University


Figura nr.2. Shkolla Strukturaliste- përfaqshuar nga Alejandro Portes, 1989<sup>37</sup>



<sup>37</sup> Burimi i përshtatur nga: *World Underneath: The Origins, Dynamics, and Effects of the Informal Economy*, Castells, M. and A. Portes. In A. Portes, M. Castells & Lauren A. Benton, eds. *The Informal Economy: Studies in Advanced and Less Advanced Developed Countries*. Baltimore, MD, USA: John Hopkins University Press, 1989 <https://www.wiego.org/publications/world-underneath-origins-dynamics-and-effects-informal-economy>

<sup>38</sup> Burimi i përshtatur nga: "The Informal Economy: Definitions, Theories and Policies", Martha Alter Chen, WIEGO Working Paper No. 1, 2002. [https://www.wiego.org/sites/default/files/publications/files/Chen\\_WIEGO\\_WP1.pdf](https://www.wiego.org/sites/default/files/publications/files/Chen_WIEGO_WP1.pdf)


Figura nr.3.- Shkolla legaliste – përfaqshuar nga Hernando de Soto, 1989.<sup>39</sup>



<sup>39</sup> Burimi i përshtatur nga: „*The Mystery of Capital: Why Capitalism Triumphs in the West and Fails Everywhere Else*“, de Soto, H., New York: Basic Books, 2000 <https://yendieu.files.wordpress.com/2009/04/the-mystery-of-capital.pdf>

<sup>40</sup> Burimi i përshtatur nga: “The Informal Economy: Definitions, Theories and Policies”, Martha Alter Chen, WIEGO Working Paper No. 1, 2002. [https://www.wiego.org/sites/default/files/publications/files/Chen\\_WIEGO\\_WP1.pdf](https://www.wiego.org/sites/default/files/publications/files/Chen_WIEGO_WP1.pdf)

Figura nr.4.-Shkolla voluntariste- përfaqësuar nga Maloney, 2004.<sup>41</sup>



42

*Burimi i përshtatur për të gjitha shkillat në fjalë nga: Martha Alter Chen, 2012*

Nga analiza e shkollave(mendimeve) të lartpërmendura shohim qantë se secila prej tyre ka këndvështrimet e veta për nxitjen apo ritjen e ekonomis informale, fokusin, pikpamjet apo veçurit e tyre. Sipas Chen këto llojë medime të fokusuara në vendet në zhvillim apo në tranzicion, sektori informal shihet si prodhim ilegal ose i fshehur –nëntoksor. Ky prodhim i paligjshëm i referohet aktiviteteve prodhuese të cilat janë të ndaluara me ligj ose që bëhen të paligjshme kur kryhen nga prodhues të paautorizuar. Këto aktivitete nëntoksore ndryshe

<sup>41</sup> Burimi i përshtatur nga: "The Informal Economy: Definitions, Theories and Policies", Martha Alter Chen, ËIEGO Ëorking Paper No. 1, 2002. [https://www.Wiego.org/sites/default/files/publications/files/Chen\\_WIEGO\\_WP1.pdf](https://www.Wiego.org/sites/default/files/publications/files/Chen_WIEGO_WP1.pdf)

<sup>42</sup> Burimi i përshtatur nga: "The Informal Economy: Definitions, Theories and Policies", Martha Alter Chen, WIEGO Working Paper No. 1, 2002. [https://www.wiego.org/sites/default/files/publications/files/Chen\\_WIEGO\\_WP1.pdf](https://www.wiego.org/sites/default/files/publications/files/Chen_WIEGO_WP1.pdf)

nihen si aktivitete të cilat quhen si të ligjshme kur i qëndrojnë rregullave shtetërore, por të cilat janë fshehur qëllimisht nga autoritetet.

Për të shmangur regjistrimin dhe tatimin dhe gjithashtu për të pasur fitime të “pastra” shumë të të punësuar apo siç i quan edhe Chen të vetpunësuar, zgjedhin ose të dalin vullnetarisht ose të punojnë informalisht. Shumë nga këta persona zgjedhin me qëllim që të punojnë dhe bëjnë përpjekje për tu shmangur barrierave të regjistrimit apo kostove të lidhura me transaksionin dhe nese kjo ndodh ato marrin përfitimet si të atyre formale, pra do bëheshte zhvendosja nga ajo joligjore në ligjore. E sidomos kohën e fundit, për të shmangur taksat, punëdhënsit e kjo punonjësit, bëjnë rritjen e punësimit informal me paga për shkak edhe të infomalizimit të marrëdhënieve të punës.<sup>43</sup>

Gjithashtu vlen të përmendet se këta punëdhënës nëpër firmat e tyre mbajnë një numër më të vogël të punonjësve por nga ana tjetër ato punësojnë një numër tjetër të punonjësve duke mos i paraqitur (regjistruar) këto të dytët me qëllim që të shmangin taksat e pagave më të shumta si dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, ose pensionet. Në një shtet në tranzicion ose një shtet që ka një sistem jo shumë efikas të sigurimeve shoqërore, ku sistemet e sigurimeve shoqërore nuk menxhohen mirë apo termat si dhe kushtet e tyre nuk janë transparent, shumë punonjës vendosin vet në këtë mënyre informal që nuk duan të paraqiten por fitimet Bruto tu mbesin atyre për momentin, pasi ato nuk presin ndonjë rezultat apo përfitim kthimi për kontributin.

Chen gjithashtu thekson se këto sipërmarrës informal ose rrinë në informalitet në fshehtësi, ose dalin vullnetarë për të punuar informalisht. Në vendet në tranzicion më së shumti nxitet informaliteti për shkak të kushteve jo të mira të një vendi si gjatë krizave ekonomike apo rënive ekonomike të një vendi, duke u arsyetuar se nuk kanë zgjedhje tjetër përveç se domosdoshmëria i ka nxit në informalitet. Por sidomos kohën e fundit edhe vendet në zhvillim me situata të ndryshme siç janë Covid-19 dhe raste të tjera që kanë nxitur edhe më shumë rënien e ekonomive të zhvilluara, njerëzit për shkakë të humbjeve të punës, për të mbijetuar kanë kryer aktivitete joligjore ku kërkesa e përfshirjes në informalitet ka qënë në rritje.

---

<sup>43</sup> Burimi i përshtatur nga: “The Informal Economy: Definitions, Theories and Policies”, Martha Alter Chen, WIEGO Working Paper No. 1, 2002. [https://www.wiego.org/sites/default/files/publications/files/Chen\\_WIEGO\\_WP1.pdf](https://www.wiego.org/sites/default/files/publications/files/Chen_WIEGO_WP1.pdf)

## I.5. Sektorët e prekur më së shumti nga ekonomia informale

### I.5.1. Sektorët që më shumë prekin informalitetin

Në përgjithësi një vend ku ligjet e punës janë të rregulluara jo mirë-dobët, ku pagat thelbësore janë të ulta kemi paraqitjen e aktiviteteve informale të industrive të ndryshme. Këto industri zakonishtë përfshin punëtorë informal ku prodhime nuk janë aq shumë precize si: riparimi i mobilie, prodhimin e ushqimit dhe përpunimin, prodhim mobilie, tekstile dhe veshje, mikëpritja dhe turizmi dhe shërbimet e brendshme. Aktivitetet ekonomike informale që paraqesin punë në profesione me nivele më të lartë më së shumti ka mundësi të punojnë bizneset private dhe jo për qeverinë.

Edhe pse ka shumë diskutime të konsiderueshme se cili sektor ka më shumë mundësi apo gjasa të marrë pjesë në ekonominë informale, informacioni për bërjen e analizës se kush dominon është relativisht e rrallë. Një burim i saktë të dhënash apo një qasje analitike do të na lejonte të nxjerrim përfundime më të sakta për sektorin e ekonomisë informale në vendet të tjera, apo në rastin tonë në Shqipëri.

**Grafiku nr.5.- 10 Sektorët me dominues në ekonominë informale të vendeve të Bashkimit europian për vitin 2019<sup>44</sup>**



Burimi: ILO-organizata ndërkombëtare e punës

Megjithatë burimet e marra nga ILO,<sup>45</sup> siç do të shifet edhe në Grafikon nr.7 na jep një pasqyrim të 10 sektorve më dominues të ekonomisë informale në vendet e Bashkimit

<sup>44</sup> Përshtatu nga burimi i Organizatës Ndërkombëtare të Punës që është përshtatur nga faqja e tyre online: [https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/genericdocument/wcms\\_751319.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/genericdocument/wcms_751319.pdf)

European në vitin 2019 nga ku shofim se bujqësia është sektori më i prekur në ekonominë joformale. Por ky pasqyrim nuk na jepë informacion të plotsuar pasi gjatë viteve ndryshon ekonomia informale ndryshojnë edhe fokusimi i sektorve në këtë ekonomi.

Po nëse krahasojmë më vendet e ballkanit, vendet që nuk bëjnë pjesë në bashkimin European do të shohim se ka dallim dhe roli i sektorve do të ndryshojë. Interesi jonë në këtë punim na ka krijuar interes edhe për hulumtimin e sektorëve të rastit tonë të Shqipërisë.

Me gjithë mungesat e burimeve të sakta të informacioneve rreth sektorëve më dominues në ekonominë informale në Shqipëri, duhet ti hedhim sytë më së shumti tek ndërmarrjet e vogla që më së shumti dyshohet nga dukja e parë të cilat prodhojnë mallra e shërbime, si produkte ushqimore, tekstili ose veshmbathjet që prodhohen nga ekonomia formale, por përsëri kemi hulumtuar që sipas burimeve të marra nga studimet e mëparshme rreth informalitetit në Shqipëri do të shohim se këto burime në vitin 2017 na mundësojnë të paraqesim njohuri mbi<sup>46</sup>:

- 🚧 Sektorët që mundë të kontribuojnë më së shumti në madhësin totale të ekonomisë informale dhe
- 🚧 Sektorët në të cilët ekonomia informale mund të jetë relativisht më e përhapur.<sup>47</sup>

Do të ishte më e kuptueshme së pari të indentifikohen sektorët me shkallë më të lartë të cilët kontribuojnë ndjeshëm në madhësinë totale të ekonomisë informale. Së pari është shpjeguar madhësia e sektorëve që ndikojnë në ekonominë informale për vitin 2017 në Shqipëri.

Sektorët që më shumë kontribuan në ekonominë informale në vitin 2017 në Shqipëri janë:

- 🚧 Bujqësi, pylltari dhe peshkim (21.8%),
- 🚧 Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimin e mjeteve motorike dhe motoçikleta (12.3%),
- 🚧 Ndërtimi (10.5%),
- 🚧 Prodhimi (7.0%) dhe
- 🚧 Aktivitete në patundshmëri (6.4%).

---


<sup>45</sup> Po aty, përshtatur nga burimi i: Organizatës Ndërkombëtare e Punës: [https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/genericdocument/wcms\\_751319.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/genericdocument/wcms_751319.pdf)

<sup>46</sup> Përshtatur nga hulumtimi: "Reducing the Shadow Economy in Albania through Electronic Payments" This study was commissioned by Mastercard and was conducted independently by EY. [https://assets.ey.com/content/dam/ey-sites/ey-com/en\\_pl/topics/eat/pdf/03/ey-albania-shadow-economy-study-report.pdf#page=10&zoom=auto,-14,815](https://assets.ey.com/content/dam/ey-sites/ey-com/en_pl/topics/eat/pdf/03/ey-albania-shadow-economy-study-report.pdf#page=10&zoom=auto,-14,815)

<sup>47</sup> Kjo nënkupton që sektorët me pjesë relativisht të lartë të ekonomisë informale në vlerën e tyre të shtuar.



Grafiku nr.6.-Pjesët e sektorëve në vlerën totale të shtuar në Shqipëri, 2017 (%)



Shiritat e verdhë tregojnë sektorë të mëdhenj në të cilët synohet trajtimi i politikave, transaksionet e pareportuara mund të gjenerojnë rrënie më të madhe në madhësinë totale të ekonomia në hije në Shqipëri  
Burimi: Instituti Shqiptar i Statistikave (INSTAT)<sup>49</sup>

Nëse hulumtojmë më tej shohim se, së dyti ekonomia informale ka gjasa më së shumti të shfaqet tek bizneset e vendeve më të vogla sesa në subjektet më të mëdha. Në vitin 2017, në Shqipëri bizneset me më pak se 5 punëtor ishin më të përhapurit në këto sektor:

- 🚧 Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi (99.6% ndërmarrjeve të regjistruara në sektor),
- 🚧 Veprimtari të tjera shërbimi (93.9%),
- 🚧 Transporti dhe magazinim (92.5%),

<sup>48</sup> Për më shumë shprehuni me: "Reducing the Shadow Economy in Albania through Electronic Payments"  
This study was commissioned by Mastercard and was conducted independently by EY.  
[https://assets.ey.com/content/dam/ey-sites/ey-com/en\\_pl/topics/eat/pdf/03/ey-albania-shadoë-economy-study-report.pdf#page=10&zoom=auto,-14,815](https://assets.ey.com/content/dam/ey-sites/ey-com/en_pl/topics/eat/pdf/03/ey-albania-shadoë-economy-study-report.pdf#page=10&zoom=auto,-14,815)

<sup>49</sup> Përshtatur nga :Republika e Shqipërisë Istituti i statistikave: <http://www.instat.gov.al/>

## Ekonomia informale, përmasat dhe efektet e saj në Republikën e Shqipërisë

- ✚ tregtia me shumicë dhe tregtia me pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave (92.0%),
- ✚ Veprimtari profesionale, shkencore dhe teknike (90.9%)



50

Ndërmarrjet që punësojnë **1-4 persona**

Ndërmarrje që punësojnë **5-9 persona**

Ndërmarrjet që punësojnë **10-49 persona**

Ndërmarrje që punësojnë **50 e më shumë persona**

Furnizimi me ujë, kanalizimi, menaxhimi i mbetjeve  
Minierat dhe gurorët  
Administrata publike dhe mbrojtja; aktivitete shoqërore të detyrueshme

Burimi: instituti Shqiptari statistikave (ISTAT)<sup>51</sup>






<sup>50</sup> Për më shumë shprehuni me: "Reducing the Shadow Economy in Albania through Electronic Payments"

This study was commissioned by Mastercard and was conducted independently by EY.


[https://assets.ey.com/content/dam/ey-sites/ey-com/en\\_pl/topics/eat/pdf/03/ey-albania-shadoë-economy-study-report.pdf#page=10&zoom=auto,-14,815](https://assets.ey.com/content/dam/ey-sites/ey-com/en_pl/topics/eat/pdf/03/ey-albania-shadoë-economy-study-report.pdf#page=10&zoom=auto,-14,815)

<sup>51</sup> Përshtatur nga: Republika e Shqipërisë Instituti i Statistikave. <http://www.instat.gov.al/>

Nësë këto hulumtime ndryshojnë pavarësisht edhe burimeve të marra nga vende të ndryshme nëse shohim sektorët që dominojnë në ekonomin informale në Shqipëri sipas Organizatës ndërkombëtare të punës gjatë vitit 2019 në krahasim me vitin 2017, shohim një rënditje tjetër dhe jo si kjo e lartpërmendura. Sipas ILO<sup>52</sup> 10 sektorët më të përfaqësuar në ekonomin informale janë sipas kësaj rënditje ku:







-  Bujqësia 63,9 %
-  Tregëtia me shumicë dhe pakicë 12.6 %
-  Ndërtimi 7.6 %
-  Akomodimi dhe ushqimi 4.2%
-  Prodhimtaria 4.2 %

Grafiku nr.8. Sektorët më të ekspozuar të ekonomisë informale në Shqipëri në vitin 2019



Burimi: ILO-organizata ndërkombëtare e punës<sup>53</sup>

Nga grafiku nr.8 shohim 10 sektorët më dominues të punësimit në ekspozimin e ekonomisë informale në Shqipëri për vitin 2019 nga e cila kuptojmë se:

-  Punëtorët shtëpiak 95.3
-  Ndërtimi 61
-  Tregtia me shumicë dhe pakicë 60.4
-  Shërbime të tjera 57.8
-  Transporti 56.4
-  Akomodimi dhe ushqimi 41.3

Nga hulumtimi i bërë nga grafikët në fjalë vlen të përmendet se në Shqipëri sektori më i ekspozuar në ekonomin informale është sektori i bujqësis, i ndjekur nga ndërtimtaria, sektori i tregut me shumicë dhe pakicë dhe shohim qartë se personat që punëtorët shtëpiak janë ato që më së shumti dominojnë në këtë sektorë. Gjithashtu vlen të theksohet se informaliteti ndryshon tek ekonomia informale dhe tek sektorët dominues në varsi të kërkesave dhe zhvillimeve të atyre sektorëve të një shteti siç është në rastin tonë Shqipëria.

<sup>52</sup> Burimi i përshtatur nga: ILO-organizata ndërkombëtare e punës: [https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/genericdocument/wcms\\_751313.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/genericdocument/wcms_751313.pdf)

<sup>53</sup> Burimi i përshtatur nga: ILO-organizata ndërkombëtare e punës: [https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/genericdocument/wcms\\_751313.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/genericdocument/wcms_751313.pdf)

## KAPITULLI II: PËRMASAT E EKONOMISË INFORMALE

### II.1. Përmasat e ekonomisë informale në vendet e zhvilluara

Temë disuktimi madhësia e ekonomisë informale, e cila mund të habis disa njerëz kur shohin numra statistikor të një vendi që ndoshta edhe nuk do e kishin menduar, por do të ishte më befusuese numri i atyre personave që marrin pjesë në punën e ekonomisë së fshehur. E sidomos nëpër zonat e vendeve të zhvilluara, ekonomia informale përbëhet nga veprimtari që njerëzit ndërmarrin për të hapur vende pune dhe për të siguruar mjetet e jetesës krijojnë të ardhura. Kjo ndodh për shkak të sektorit të mëdhenj publik e modern nuk ofrojnë vende pune dhe të ardhura të mjaftueshme.

Matja e ekonomisë informale paraqet sfidë në vete. Përdoren metoda të ndryshme për matjen e saj, të cilat priten të japin rezultate të ndryshme. Si për shembull, në praktik duke përdorur metodën direkte, masat e anketës prirën të nënvlerësojnë madhësinë e ekonomisë informale sepse njërëzit kur pyetën për punën në hije vështirë se e pranojnë që i përkasin kësaj ekonomie. Po janë zhvilluar teknika të reja më të besueshme statistikore që ofrojnë prova më të besueshme të ekonomisë informale dhe masat që rrjedhin nga këto teknika mund të jenë klasifikuar duke përdorur variabla, të tilla si shuma e parave të gatshme në një ekonomi, të cilat dihet se lidhen më shtrirjen e aktiviteteve të ekonomisë informale.<sup>54</sup>

Duke përdorur metodën MIMIC- metodën e intensitetit të dritës në vend të PBB-së, duke shmangur problemi që GDP shpesh përdoret si variabël shkaktar dhe tregues; dhe PMM metodologji, e cila ofron rezultate të fuqishme dhe konfirmon ato të MIMIC.<sup>55</sup>

Sipas llogarive të Bankës Botërore, duke përdorur metodën MIMIC, informaliteti përfaqëson 70% të të gjithë punësimit në ekonomitë në zhvillim dhe ato në zhvillim, krahasuar me rreth 18% në vendet e zhvilluara. Në nivel global, 81% e të gjitha ndërmarrjeve janë joformale. Sipas OECD-së globalisht, punësimi informal kryesisht ka të bëjë me një punësim më shumë për gjinin mashkullore, në një shumicë të vogël vendesh (55%), përqindja e grave në këtë ekonomi është më e lartë se sa e burrave. Pavarisht të dhënave që mund t'i shohim niveli i punësimit informal gjithashtu ndryshon ndjeshëm gjatë ciklit jetësor, më të rinjtë dhe punëtorët e moshuar më të ekspozuar. Punësimi informal thith punëtorët më pak të arsimuar: globalisht, rreth 94% e punëtorëve pa arsim janë në punësim informal, krahasuar me 52% të atyre me arsim të mesëm dhe 24% të atyre me arsim të lartë. Raporti, i cili për herë të parë shton një dimension familjar në profilizimin e punëtorëve informalë, tregon se individët që punojnë brenda familjeve mund të jenë të punësuar joformalisht ose formalisht. Shumica e familjeve janë plotësisht informale (të gjithë anëtarët që punojnë në punësim

---

<sup>54</sup> Përshtatur nga: "The Shadow Economy", Scheider, Fridrich & Williams, Collin C  
[https://www.researchgate.net/profile/Colin-Williams/4/publication/237047384\\_The\\_Shadow\\_Economy/links/00b4951b03c377c60d000000/The-Shadow-Economy.pdf?origin=publication\\_detail](https://www.researchgate.net/profile/Colin-Williams/4/publication/237047384_The_Shadow_Economy/links/00b4951b03c377c60d000000/The-Shadow-Economy.pdf?origin=publication_detail)

<sup>55</sup> MF Working Paper, African Department. Shadow Economies Around the World: what Did we Learn Over the Last 20 Years? Prepared by Leandro Medina and Friedrich Schneider1

informal) në shumicën e vendeve për të cilat ka të dhëna të disponueshme. Përqindja e familjeve krejtësisht informale gjithashtu ndryshon shumë në vende dhe rajone, nga 3% në Kili në 92% në Burkina Faso.<sup>56</sup>

Kategoria e këtyre personave përbehet nga personat e varfër të vendeve të zhvilluara, imigrantët, personat me kualifikim të nivelit të ulët të arsimimit,<sup>57</sup> të rinjtë që dalinë për herë të parë nga shkolla dhe që futen në tregun e punës, persona që mundohen të zëne vend pune por që nuk kanë eksperienc të mjaftueshëm për at vend pune, etj. Në bashkimin europian për shembull vihet re se 30 milion njerëz punojnë në ekonomin informale.<sup>58</sup>

Situata ndryshon në pjesë të ndryshme të Evropës. Në vendet nordike, puna në hije është shumë më e zakonshme në mesin e të punësuarve sesa midis të papunëve komplotuar. Po pavarësisht nivelit të zhvillimit ekonomik-shoqëror informaliteti është i pranishëm në të gjithë botën. Ekonomia informale zakonisht ka të bëjë me lidhjen me papunësinë e lartë, varfërinë, produktivitetin e ulët si dhe me rritjen e ngadaltë ekonomike. Madhësia, natyra apo niveli i ekonomisë informale nuk është e njëjtë në të gjithë vendet e botës, por ndryshon nga vendi dhe niveli i zhvillimit ekonomik. Ku të gjitha këto lidhje paraqesin një “zorrë” zingjirore statistikore për të kuptuar zhvillimin ekonomik të një vendi por dhe jo shumë të qartë. Një vend i varfër apo një vend i zhvilluar ekonomikisht ballafaqohet me këto lidhje edhe pse këto të dytët mundohen vazhdimisht duke përdorur metoda të ndryshme qofshin ato politike-ekonomike, për ta prishë këtë “zorrë” zingjirore statistikore. Ku vihen parasysh situata të ndryshme të zhvillimit të ekonomisë informale në vendet e zhvilluara dhe ato në tranzicion. Statistika të cilat janë vështirë për ti llogaritur dhe për ti gjetur por nëse lidhemi me Bankën Botërore për ti parë këto statistikat më të qarta dhe shohim në database e ekonomisë informale, nga të cilët kanë përdorur metoden MIMIC<sup>59</sup>, se në një periudhë 16 vjeqare janë marrë burim nga 159 shtete, për periudhën e viteve 2003-2018.<sup>60</sup> Nga këto të dhëna do të shohim se 10 shtetet me përqindjen më të vogël të ekonomisë informale në raport me PBB-në e tyre për ti krahasuar pastaj me vendet në zhvillim. Kjo përqindje në këto vende është e vogël sepse struktura e prodhimit tejkalohet nga sektori i strukturuar.

---

<sup>56</sup> Për më shumë informacion lexo: PORTRAITS OF INFORMALITY TACKLING VULNERABILITY IN THE INFORMAL ECONOMY © OECD/ILO 2019 ,chapter 1 <https://www.oecd.org/docserver/ee0642f5en.pdf?expires=1665043425&id=id&accname=guest&checksum=AB70304284E88CE5EE8118806C447667>

<sup>57</sup> Përshtatur nga :”Ekonomia informale”, Vrenozi, Manuela. 2011. <https://de.scribd.com/document/47464890/ekonomia-informale>

<sup>58</sup> Përshtatur nga: ILO-Organizata Ndërkombëtare e Punës: <https://www.ilo.org/global/lang-en/index.htm>

<sup>59</sup> Pasi përkufizimet e ekonomisë informale ndryshojnë është e rëndësishme të kuptohet se çfarë analizohet dhe si matet. Metoda direkte dhe indirekte japin vlersime të ndryshme të madhësisë së ekonomisë informale. MIMIC është metoda indirekte e matjes së treguesve të shumfishtë (shkaqe të shumëfishta), ecila madhësia e ekonomisë informale është intensifikuar kryesisht në këtë metod.

<sup>60</sup> Për më shumë shprehuni me: World Bank. <https://www.worldbank.org/en/country/westerneurope/overview>

Tabela nr 1. Përmasat e ekonomisë informale në disa vende të zhvilluara (2003-2018) <sup>61</sup>		
Shtetet	2003	2018
Sëitëzland / Zvicra	9,1	8,3
Austria/ Austria	9,7	9,5
Luxembourg/ luksemburg	10,2	10,0
Japan/ Japonia	11,3	10,2
Neë Zealand/ Zelanda e Re	12,3	12,0
China/ Kina	12,6	11,2
United Kingdom/ Mbretëria e Bashkuar	12,7	12,3
Netherlands / Holanda	13,4	13,0
Singapore/ Signapor	13,5	11,9
Australia/ Australia	13,9	14,1
France/ Franca	15,3	14,8
Vietnam/ Vietnami	15,4	14,0
Ireland/ Irlanda	16,0	14,4
Canada / Kanada	16,0	15,5
Burimi: të dhënat e marra nga Statistikat e Bankes Botërore		

Nga tabela nr.1 shohim se statistikën e Bankës Botërore të përlogaritura me modelin MIMIC, shohim një pasqyrë më të qartë të levizjes së vendeve të zhvilluara për periudhën e viteve 2003-2018. Nuk është se kanë pasur një ndryshim të madh të lëvizjes, në rritje apo zvoglim të përqindjes së ekonomisë informale në raport me PBB-në e tyre. Siç shihet qartë shteti nga 14 shtete të lartpërmendura, që ka një numër më të vogël të përqindjes së informalitetit është Zvicra me vetëm 9.1% në vitin 2003, kurse në vitin 2018 ka pas një zbritje të kësaj përqindjeje me 8%, ku shohim se ekonomia e këtij vendi ka pas zhvillim më të lartë në krahasim me vendet tjera, ku tregohet qartë se lufta kundër informalitetit ka qënë në përmisim e sipër. Gjithashtu shteti që më shumë interes për të parë përqindjen e ekonomisë informale të tyre ka qënë edhe Austria ku nuk ka pas ndonjë zvoglim të madh brenda këtyre viteve kundër informalitetit por nëse shohim disa të dhëna për vitin 2022 do të shohim se, Austria ka pas një përmisim të qartë. Gjithashtu me interes të gjërë për hulumtin e ekonomisë informale në Austri do të shohim se ndryshimet që mund të kenë për përmisimin e uljes së mesatares së ekonomisë informale janë planet e politikave strategjike që ndjek shteti por edhe vetëdija e qytetarëve për mos punuar pa me u paraqitur në organet përkatëse. Në vitin 1997, vëllimi i përgjithshëm i ekonomisë informale në Austri vlerësohej në 220 miliardë shilinga (ekuivalente me 8.93% të produktit kombëtar bruto), që do të thotë një rritje prej më shumë se katër herë brenda 20 viteve.

<sup>61</sup> Për më shumë shprehuni me: Banka Botërore. <https://www.worldbank.org/en/country/westerneurope/overview>

Për shkakë të natyrës së vështir të saj, ekonomia informale paraqet sfida të jashtëzakonshme për studiuesit, të cilët dukë u përpjekur të vlersojnë madhësinë e saj, kanë përdorur metoda të ndryshme po që kanë hasur një shumëllojshmëri qasjesh, ku procesi i matjes mbetet vërtet një shkencë e pasaktë. Prandaj duke parë hulumtimet Schneider, i cili shpjegon edhe të dhëna të tjera në krahasim me Bankën Botërore, ku tregon lëvizjen e disa prej shteteve të zhvilluara për vitin 2022, ku tabela më poshtë tregon përmasat e disa shteteve të zhvilluara për vitin 2022-6 mujori i parë. Këto llogaritje aktuale të ekonomisë informale midis vendeve të industrializuara është jokonstante. Gjermania njëra prej tyre shteteveku ekonomia informale është në rënie.


Tabela 2: Niveli i ekonomisë informale në vende të përzgjedhura të industrializuara 2022 (në lidhje me PBB-në)			
Shtetet	2004	2018	2022/6mujori parë
Australia	13.2	9.2	9.3
Belgjika	20.7	15.4	16.3
Gjermania	15.7	9.6	8.7
Finlanda	17.2	11.0	10.8
Franca	14.3	12.5	14.2
Greqia	28.1	20.8	20.9
Britania e madhe	12.3	9.8	10.9
Irlanda	15.2	9.7	10.1
Italia	25.2	19.5	20.3
Japonia	10.7	8.7	8.6
Kanada	15.1	9.6	10.0
Norvegjia	18.2	11.8	10.4
Austria	11.0	6.7	6.6
Portugalia	21.7	16.11	15.7
Suedia	18.1	11.6	10.8
Zvicra	9.4	5.8	5.6
Spania	21.9	16.6	15.8
USA	8.4	5.1	6.1
Burimi i përshtatur me origjinalin: Prognose zur Entwicklung der Schattenwirtschaft in Deutschland im Jahr 2022 <sup>62</sup>			

<sup>62</sup> Burimi i përshtatur nga: Prognose zur Entwicklung der Schattenwirtschaft in Deutschland im Jahr 2022. F. Schneider und dem Institut für Angewandte Wirtschaftsforschung (IAW).

<https://de.statista.com/statistik/daten/studie/163720/umfrage/schattenwirtschaft-in-der-oecd-2010/#professional>

Këto janë gjetjet e kërkimeve kryesore të një parashikimi të ri të ekonomisë informale në Gjermani të viteve të fundit dhe gjysëmvetor i vitit 2022, kërkime të botuara nga profesor Friedrich Schneider nga universiteti Linzit dhe nga Institui i hulumtimeve shkencore ekonomike. Nga këto kërkime shohim qartë se shteti që ka përqindje më të ulët të ekonomisë informale për vitin 2022 është Zvicra me vetëm 5.6% ulje krahasuar më vitet e mëparshme dhe një zhvillim ekonomik i dukshëm i këtij shteti. Austria rënditet e treta për uljen e përqindjes së informalitetit me vetëm 6.6%. Kurse Gjermania, që ishte bazë e studimit të Schneider kishte një rënie në 2022 me vetem 8.7% të ekonomisë informale në raport me PBB-në, shumë më poshtë mesatares në krahasim me 20 vendet e zhvilluara të hulumtara, prej 11.4%. Ky rezultat është për shkak të situatës së favorshme të tregut të punës. Schneider dhe Instituti për hulumtim shkencor ekonomik shpjegojnë qartë në botimet e tyre se për vitin 2021 ekonomia informale në Gjermani ka qënë 338 miliardë Euro, kurse për vitin 2022 parashikohen 326 miliard Euro pra një rënie prej 12 miliard Euro. Kjo matje është bërë nga një model i matjes ekonomike pasi ekonomia informale nuk mund të matet direkt.<sup>63</sup>

Grafiku nr. 9. Niveli i ekonomisë informale në vende të përzgjedhura të industrializuara 2022 (në lidhje me PBB-në)



*Burimi: Prognose zur Entëicklung der Schattenëirtschaft in Deutschland im Jahr 2022<sup>64</sup>*

<sup>63</sup> Burimi i përshtatur nga: Prognose zur Entwicklung der Schattenwirtschaft in Deutschland im Jahr 2022. F. Schneider und dem Institut für Angewandte Wirtschaftsforschung (IAW).

<https://de.statista.com/statistik/daten/studie/163720/umfrage/schattenwirtschaft-in-der-oecd-2010/#professional>

<sup>64</sup> Burimi i përshtatur nga: Prognose zur Entwicklung der Schattenwirtschaft in Deutschland im Jahr 2022. F. Schneider und dem Institut für Angewandte Wirtschaftsforschung (IAW).

<https://de.statista.com/statistik/daten/studie/163720/umfrage/schattenwirtschaft-in-der-oecd-2010/#professional>



Sipas llogaritjeve aktuale të Schneider, zhvillimi i ekonomisë në hije është i rëndësishëm në vendet e industrializuara.

**Gjermania** është një prej atyre vendeve ku ekonomia informale është në rënie. Ky fenomen është aktiv i cili është në favorshme të situatës së tregut të punës. Në përgjithësi qëndron marrëdhënia e ekonomisë informale dhe të produktit të brendshëm bruto zyrtar në Gjermani në vit. Në vitin 2022, në 8.7%, shumë më poshtë mesatares nga 20 vende më të mëdha të industrializuara prej 11.4%. Këto llogaritje në Gjermani janë bërë nga Schneider duke patë parasysh dhe kalimin e periudhës së pandemis, madhësia e llogaritjes së ekonomisë informale në këtë vend doli si rezultat i rritjes së papunësis dhe rritjes përkohësish të të ardhurave më të ulta të fituara.<sup>65</sup>

Megjithatë nuk duhet të lëmë pa theksuar se pavarisht këto vende të industrializuara me ekonomi informale jo shumë të lartë, prap së prap demi ekonomik i shkaktuar nga puna e padeklaruar nuk duhet të nënvlersohet. Demi financiar i shkaktuar nga hetimet e agjencisë së kontrollit financiar vetëm për punën e padeklaruar ka shkuar në më shumë se 800 milionë Euro në vitin 2020, dhe numri i rasteve jo të raportuara, do të thotë se demi është në miliarda Euro.<sup>66</sup>

#### **Faktorët që kanë ndikuar në zhvillimin e ekonomisë informale në vendet e zhvilluara**

Bazuar në kërkimet shkencore në vendet industriale, shumë faktorë kanë ndikuar në zhvillimin e ekonomisë së hijes, por më të rëndësishmit, më të përmendurit dhe më të mbështetur në mënyrë empirike janë:

- ❖ Ngarkesat tatimore dhe kontributet e sigurimeve shoqërore.
- ❖ Dendësia dhe intensiteti i rregulloreve në ekonominë zyrtare, veçanërisht në tregjet e punës, duke përfshirë reduktimet e manovruara në javën e punës, pensionin e parakohshëm dhe papunësinë në rritje, duke ofruar më shumë kohë për punë të paligjshme.
- ❖ Më pak përfshirje qytetare dhe besnikëri dhe respekt ndaj institucioneve publike.
- ❖ Morali i dobët tatimor (gatishmëria për të paguar taksat), pjesërisht rezultat i korrupsionit dhe rënies së cilësisë së institucioneve publike.<sup>67</sup>

---

<sup>65</sup> Burimi i përshtatur nga: Prognose zur Entwicklung der Schattenwirtschaft in Deutschland im Jahr 2022.F.Schneider und dem Institut für Angewandte Wirtschaftsforschung (IAW).

<sup>66</sup> Përshtatur nga: Prognose zur Entwicklung der Schattenwirtschaft in Deutschland im Jahr 2022.F.Schneider und dem Institut für Angewandte Wirtschaftsforschung (IAW).

<https://de.statista.com/themen/5373/schattenwirtschaft/#dossierKeyfigures>

<sup>67</sup> Përshtatur nga: "The shadow economy in industrial countries Updated-Reducing the size of the shadow economy requires reducing its attractiveness while improving official institutions", Dominik H. Enste

<https://wol.iza.org/articles/shadow-economy-in-industrial-countries/long#izaëol.127-figure-000002>

Shumë studime empirike zbulojnë se barra në rritje e taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore është një nga shtytësit më të rëndësishëm të zhvillimit të ekonomisë në hije.

Gjithashtu, një faktor tjetër që nuk është përmendur më sipër është kontribues i ekonomisë informale edhe imigrimi i paligjshëm, megjithëse emigrantët e paligjshëm sigurojnë përqindje relativisht të lartë të të punësuarve, sidomos në SH.B.A dhe në Greqi.<sup>68</sup>

### ***II.1.1. Shtetet e industrializuara në periudhën e Covid-19***

Në periudhën e vitit 2020-2021, studimet e shumta në atë kohë por edhe nga OECD-ja, paraqitja e pandemisë së ashtu quajtur Covid-19, shkaktoi një recension të rëndë gati në të gjithë vendet e zhvilluara. Covid-19 preku pothuajse të gjitha vendet dhe më shumë se 50 milionë njerëz në mbarë botën.<sup>69</sup> Rënia e mprehtë e PBB-së dhe të ardhurat kombëtare erdhen si rezultat i rritjes së papunisë, nga kjo situatë e krijuar dhe kjo ndikojnë në një rritje të pritshme të ekonomisë informale të këtyre vendeve.

Ndryshimi i krizës ekonomike ndryshon nëpër vende me rajone të ndryshëm edhe atë në varësi të ekspozimit të rajonit ndaj sektorëve të tregëtueshëm dhe zinxhirëve të vlerës globale. Nëse shohim më qartë patjetër që na bien në sy ato vende, rajone me ekonomi që varen nga turizmi u preken më shumë nga Covid-19, se sa rajonet e tjera dhe këtu pastaj lulëzon informaliteti pasi njerëzit të dëshpëruar për të bërë diçka për mbijetesë, duke lënë anash përshembull turizmin u morën me diçka që nuk patën mundësi ta përballojnë ekonomikisht duke mos paraqitur taksat dhe u futën në ekonominë informale dashur e padashur.<sup>70</sup>

Covid-19 u kushtoi mijëra e mijëra punonjësve punën e tyre në vendet e zhvilluara e sidomos ato në zhvillim ku gjithashtu shkaktoi krizën më serioze ekonomike që nga Lufta e dytë botërore. Sipas OECD thuhet se një pjesë e vendeve të zhvilluara deri në vitin 2022 ndoshta nuk do përmisojnë nivelet e tyre të prodhimit por duke parë figurën 4, shumë vende përmisojnë ekonominë informale e disa të tjera nuk kishin ndonjë ndryshim të madh. Një humbje masive e të ardhurave, duke punuar në mënyrë jo të rregulltë dhe duke punuar një pjesë e mirë e punonjësve për të kompensuar një pjesë të humbjeve.

Sipas llogaritjeve të Schneider dështimi lulëzoi gjatë pandemisë. Sipas tij vitin e kaluar në ekonominë informale u arrit një vlerë e shtuar prej rreth 25.7 miliard Euro-një rritje prej 12%, i cili tekson gjithashtu se nuk ka patur ndonjë rritje kaq të mprehtë në 20 vitet e fundit të vendeve në zhvillim, por edhe ato në tranzicion. Ky i fundit, gjithashtu supozoi se produkti

<sup>68</sup> Përshtatur nga: ILO-Organizata Ndërkombëtare e Punës. [https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed\\_protect/---protrav/-travail/documents/briefingnote/wcms\\_743523.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_protect/---protrav/-travail/documents/briefingnote/wcms_743523.pdf)

<sup>69</sup> Për më shumë shprehuni me: "Coronavirus(2019). From pandemic to recovery-Local employment and economic development." April, 2020. [https://read.oecd-ilibrary.org/view/?ref=130\\_130810-m60ml0s4wf&title=From-pandemic-to-recovery-Local-employment-and-economic-development](https://read.oecd-ilibrary.org/view/?ref=130_130810-m60ml0s4wf&title=From-pandemic-to-recovery-Local-employment-and-economic-development)

<sup>70</sup> Burimi i përshtatur nga: Organizata e Kooperimit dhe Zhvillimit Ekonomik (OCDE) apo ndryshe në Anglisht OECD. <https://www.oecd.org/coronavirus/policy-responses/the-territorial-impact-of-covid-19-managing-the-crisis-across-levels-of-government-d3e314e1/>

i brendshëm bruto (PBB) do të bjerë me 7 deri 8%.<sup>71</sup> Ai gjithashtu ka pritur që vëllimi i punës së padeklaruar të binte nga 24 miliardë në 22.9 miliardë Euro gjatë periudhës së pandemisë, ku ka theksuar se nuk ka pasur ndonjë tregues se mund të kishte një recension.

Por çfarë mund të thuhet për situatën që ndodhemi sot? Që nga prilli i vitit 2020 jetojnë në ekonominë informale rreth 1.1 miliardë punëtorë, në vendet me bllokim të masave të plota dhe rreth 304 milion njëerëz të ekonomis informale në vendet me bllokim të masave të pjesshëm. Këta punëtorë së bashku përfaqësojnë 67% të punësimit informal. Duke i patë parasysh efektet e rrezikut sektorial, statusin e punësimit, madhësin e ndërmarrjeve me nivele të masave të bllokimit (të plotë apo të pjesshëm), ku ndikimi i Covid-19 çon në ndikimin edhe më të madhë të ekonomis informale. Ky vlersim nënkupton se bllokimi nga Covid-19 ka ndikuar në një numër pothuajse 1.6 miliardë punonjës të informalitetit apo 76% të ekonomis informale në mbarë botën.<sup>72</sup> Nga distanca dhe largimi nga puna e shumë puntorve në mbarë botën edhe në vendet në zhvillim, punëtorët jo më nga frika e pandemisë por nga frika e urisë, në mënyrë ilegale, të fsheht dolën të punojnë me ato kushtet e pakta pandemike, nuk ishte një opsion i denjë por të vdesësh nga virusi apo nga varfëria, ishte çështja dhe periudha me e sprovuar besojë më delikate për njerzimin.

---

<sup>71</sup> Përshtatur nga revista Austriake: "Winerzeitung"

<https://www.wienerzeitung.at/nachrichten/wirtschaft/oesterreich/2089817-Wirtschaft-im-Dunkeln.html>

<sup>72</sup> Për më shumë shprehuni me: ILO (2018), Women and men in the informal economy: A statistical picture, 3rd edition, International Labour Organization, Geneva, [https://www.ilo.org/global/publications/books/WCMS\\_626831/lang--en/index.htm](https://www.ilo.org/global/publications/books/WCMS_626831/lang--en/index.htm) (accessed on 29 August 2018).

## II.2. Përmasat e ekonomisë informale në vendet në tranzicion

Një krizë ekonomike e një vendi, një gjendje jo fort e pranueshme ekonomike, ku synimet për një zhvillim të qartë ekonomik janë të mëdha, kemi të bëjmë me një përplasje idesh, me një numër të rritjes së papunësisë dhe ku vafëria lulëzon, në këto vende ekonomia informale ka rritje-ujje të luhatshme por jo stabël.

2 miliardë gra dhe burra<sup>73</sup> që janë privuar nga kushtet e denjë të punës, jetojnë jetën e tyre në informalitet, që përfaqësojnë përafërsisht 62.2% të punësimit global. Por këto persona mendohet se nuk kanë zhdhjedhje më të mirë prandaj veprojnë jo me zgjedhje, por si pasojë e mungesës së mundësive për tu futur në ekonominë formale apo në mungesë të mjeteve tjera të jetesës për ta siguruar jetesën.<sup>74</sup>

Nëpër vendet e ndryshme pavarësisht niveleve të zhvillimit, ekziston pabarazi të mëdha sa i përket shpërndarjes së punësimit informal. Për shembull sipas llogarive të Organizatës Ndërkombëtare të Punës në vitin 2018 kanë përllogaritur normat e ekonomisë informale nëpër botë. Normat janë të dukshme më të larta të informalitetit në krahasim të vendeve të industrializuara dhe ato në zhvillim, përqindja e dallimit varion në 18.3% vendet e zhvilluara, 67.4% të normës së informalitetit në vendet në zhvillim dhe 89.8% në vendet me një zhvillim të mëvonshëm.

E në krahasim me vitin 2016 ILO gjithashtu del në llogaritje të këtyre përqindjeve: shumica e punëtorëve në Afrikën Mbështetën në ekonominë informale nga ku shohim se, 85.8% në Afrikë punojnë në ekonominë informale dhe 89.2% në Afrikën Veriore (Sub-Sahariane). Kurse në Afrikën e Jugut varion ekonomia informale me 34%. Këto vende të Afrikës Jugore kanë informalitetin më të ulët për shkak të kombinimeve të niveleve relativisht më të larta të zhvillimit socio-ekonomik, punësimit më të lartë në raport me raportet e popullsisë dhe përqindja mbi mesataren e shpenzimeve për mbrojtjen sociale të produktit të brendshëm bruto (PBB).

Pas Afrikës, si të dytët rënditen Azia dhe Paqësori me nivel mesatar 68.2%, ku vendet e zhvilluara përmbajnë 21.7% dhe vendet në zhvillim përmbajnë 71.4%. Vijnë pastaj Republika e Kores me 30.0%, Japonia me përqindje më të ulët me 20.0% kurse shtetet si India, Kamborxia, Bangladeshi, Nepalit kanë një përqindje të lartë të ekonomisë informale më përafërsisht 90.0%. Shtetet Arabe kanë mesatarisht nivelin e tretë më të lartë me mbi 68%. Pastaj Amerika Latine dhe Karaibet me 53.1% dhe Amerika e Veriut me 18.1% zënë vendin e nivelit të katërt më të lartë të ekonomisë informale. Në Europën dhe Azinë Qendrore niveli mesatarisht është rreth 25.0%, ku në vendet e zhvilluar arrin mesatarja në 15.6%, kurse vendet në zhvillim 36.8%.<sup>75</sup>

---

<sup>73</sup> 2 miliardë e popullsisë që janë punonjës mbi 15 vjeq e lartë.

<sup>74</sup> Përshtatur nga: ILO-organizata ndërkombëtare e Punës. „Women and men in the informal economy”  
<https://www.ilo.org/global/lang-en/index.htm>

<sup>75</sup> Përshtatur nga: organizata ndërkombëtare e punës. „Women and men in the informal economy”  
[https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---dgreports/---dcomm/documents/publication/wcms\\_626831.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---dgreports/---dcomm/documents/publication/wcms_626831.pdf)

Niveli i zhvillimit socio-ekonomik lidhet pozitivisht me formalitetin. Vendet e zhvilluara konsiderohen si vende me të ardhura të larta siç përcaktohet nga Banka Botërore, vendet në zhvillim si vende me të ardhura mesatare dhe vendet më pak të zhvilluara (bota e tretë) si vende me të ardhura të ulëta. Vendet në zhvillim dhe ato më pak të zhvilluara kanë përqindje më të lartë të punësimit informal sesa shtete të zhvilluara. Vendet në zhvillim dhe ato më pak të zhvilluara (botës së tret) përfaqësojnë 82% të të punësuarve në botë. 93% punësimit informal në botë është në këto vende. Më shumë se dy të tretat e popullsisë së punësuar në vendet në zhvillim dhe me një zhvillim më të vonshëm (botës së tret) janë në punësim informal (69.6%), ndërsa më pak se një e pesta e popullsisë së punësuar (18.3 përqind) janë në shtete të zhvilluara. Rajonet me vende në nivel më të lartë të zhvillimit socio-ekonomik, siç janë: Amerika, Azia dhe Paqësori, Evropa dhe Azia Qendrore kanë përqindje më të ulëta të punësimit informal.<sup>76</sup>

Nga këto llogaritje globale siç pamë në nënkapitullin më sipër vendet e zhvilluara ballafaqoheshin me një numër jo shumë të lartë të ekonomisë informale, po edhe vendet në zhvillim e sidomos ato më pak të zhvilluara ballafaqohen më një mesatare më të lartë të informalitetit në krahasim me këto të parët. Për shkak të llogaritjeve të vështira të kësaj ekonomie do të shohim se edhe në vendet në tranzicion numri i ekonomisë informale është i lartë. E sidomos në këto vende që mundohen të dalin nga tranzicioni është edhe më e vështirë për llogaritja e ekonomisë informale. E për shkak të vështirësive të informacioneve të sakta jemi përqëndruar vetëm në shtetet të cilat na vin më shumë në interes për ti parë këto përqindje. Por çfarë i ka shtyrë ekonomistët, hulumtuesit të kërkojnë nëpër këto vende statistika të ekonomisë informale? Ajo që neve më shumë diskutojmë kur degjojmë fjalën ekonomi informale na vin në mend: varfëria, papunësia, mbulimi i të ardhurave, mos pagimi i taksave të shtetit. Por si qëndron e verteta në vendet si Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Sllovenia, Greqia, Rumania si dhe Koracia? Vendet në tranzicion janë veçanërisht të prekshme ndaj aktiviteteve të pavëzhguara që rrjedhin nga kontrollat e liruara shtetërore<sup>77</sup>, për tu shmangur regjistrimeve rregullative të çdo firme apo individi, ose ndryshe nën raportojnë aktivitetet që prodhojnë të ardhura.

Vitet e para të tranzicionit nëpër këto vende lidhen me zgjerimin e sektorit informal me peshën e shpenzimeve publike në PBB të këtyre vendeve. Më tej, këto vende gjithashtu përballen me një nivel të lartë të evazionit fiskal për shkak të dobësisë së autoritetit të tyre fiskal, i cilin nga ana tjetër ndryshon barrën më të madhe të mbledhjes së të ardhurave ndaj politikës monetare.

---

<sup>76</sup> Për më shumë shprehuni me: Organizata për Bashkim dhe Zhvillim Ekonomik. <https://www.oecd-ilibrary.org/docserver/939b7bcden.pdf?expires=1660423968&id=id&accname=guest&checksum=10238C32B43B15C4D2257BC9DF465D27>

<sup>77</sup> Çfarë nënkuptojmë se këto aktivitete të pavëzhguara vijnë si rredhje e kontroleve të dobta shtetërore apo mos mbajtja e nivelit të duhur të kontroleve financiare, që rrjedhin si pasojë e rritjeve të ekonomisë informale në vendet më një ekonomi të ulët apo jo shumë të lartë.

Nga hulumtimi i Bankës Botërore për 159 vendet e llogaritura të ekonomisë informale për 20 vitet e fundit nga tabela më poshtë shohim qartë edhe vendet e lartpërmendura se si qëndron përqindja e mesatares së tyre, në periudhen e viteve 2012-2018.

Tabela nr.3.Përmasat e ekonomisë informale në vendet në zhvillim		
shtetet	2012	2018
Albania	33,5	32,4
Bosnia and Herzegovina	33,5	30,7
Bulgaria	33,3	31,8
Kroacia	31,4	30,0
Greece	30,4	29,3
North Macedonia	36,3	33,4
Romania	31,7	30,3
Slovenia	26,8	24,4
Burimi: Nga statistikat e Bankës Botërore <sup>78</sup>		

Nga statistikat e tabelës më sipër shohim se nga këto 8 shtetet të përzgjedhura nga vitet 2012-2018, të cilat shtete i përkasin Gadishullit Ballkanik, e disa të tjera tani i takojnë edhe Bashkimit Europian, vetëm **Slovenia** rezulton më një mesatare më të ulët në krahasim me shtetet të tjera. Në vitin 2012 Sllovenia kishte mesatarisht 26.8% normën e ekonomisë informale në vend, ku brenda 5 viteve ajo pësoi një ndryshim në rënie ku për 5 vite rënia ishte -2.4% për dallim nga viti 2018. Nga ku kuptojmë se Sllovenia një shembull i mirë për të marrë për sa i përket dimensioneve të tranzicionit që kalojë, duke u zhvilluar si dhe deri në integrimin e saj për në Bashkimin Europian. Çfare e favorizoi Sllovenin për integrimin në BE? Pikërisht shkalla e kontrollit të ekonomisë informale dhe zhvillimi i rritjes ekonomike të vendit. **Kroacia** është një shtet me ekonomi të mesme, ndryshe nga Sllovenia, madhësia e nivelit të ekonomisë informale në vitin 2012 me 31.4%, kursë në vitin 2018 shohim një ndryshim me ulje prej 1.4% për dallim në 5 vitet, ku në 2018 me 30.0%, po nëse shohim statistikat e Bankës ekonomike <sup>79</sup> vlen të theksohet fakti që sot Kroacia ka një nivel të ekonomisë informale me 29.5%, që përfaqëson 36 miliardë dollar të nivelit PBB-së të vendit.

Po nëse shohim tabelën e mësipërme shihet qartë se për periudhën e këtyre viteve 3 ekonomitë informale me mesatare më të mëdha janë: **Maqedonia e Veriut**, e cila ka një madhësi mesatare të ekonomisë informale me 36.3% në vitin 2012 kurse në vitin 2018 shohim edhe në këtë shtet që ka një rënie të nivelit të madhësisë së ekonomisë informale. Më një rënie prej 2.9% në krahasim me vitin 2018 ku madhësia e ekonomisë informale në këtë vend ka qënë 33.4%. Kjo statistikë e lartë tregon shkaqet që sjellin deri në këto përqindje në

<sup>78</sup> Për më shumë shprehuni me: Statistikat e Bankës Botërore:

<https://www.worldbank.org/en/country/westerneurope/overview>

<sup>79</sup> Për më shumë informohu në: "World economics.-Croatia's Informal Economy Size"

<https://www.worlddeconomics.com/Informal-Economy/Croatia.aspx>

këto vende sikurse: hapjet tregtare, papunësia, sundimi i ligjit, kontrolli jo i mir i korrupsionit, madhësia e qeveris, evazioni fiskal dhe shumë shkaqe të tjera. **Shqipëria dhe Bosnja dhe Hercegovina** janë gjithashtu vende me mesatare të ekonomisë informale të lartë. E njëjta situat shfaqet pothuajse të ngajshme janë shkaqet pak a shumë edhe tek këto vendet ngjajshëm me Maqedonin e Veriut dhe këto të dhëna të disa nga shtetet që kanë qënë dhe janë ende në tranzicion do të shofim edhe llogarit e disa studiuësve të tjerë për periudha të tjera ndër vitë.

### **II.2.1. Covid-19 në ekonomin informale**

Vlenë të theksohet se veçuritë e ekonomis informle janë të ndryshme në vende të ndryshme pavarisht zhvillimit ekonomik të një vendi, por edhe faktorëve të tjerë që shtyn në rritjen e përqindjeve të vlerave të kësaj ekonomie, e sidomos kur bëhet fjalë për vendet në zhvillim. Prandaj pyetja që mund ti bëjmë këtyre shteteve në lidhje me informalitetetin mund të ndryshojë, sepse tek këto vendet në zhvillim ekonomia informale luan një rol të rëndësishëm. Në disa vende mund të jetë më i përshtatshëm për t'u fokusuar në sistemet e përfitimeve, në të tjerat mbi bizneset që punësojnë njerëz dhe sidomos në vetë-të punësuar. Nësë do të shofim vendet e Europës Juglindore, patjetër që na bihen në sy ekonomia informale e Shqipërisë, ku prej viteve 1991 ka pas një rritje tendencie jo fort të kontrolluar.

Afro 95 milionë njerëz më shumë - shumë prej tyre punëtorë informalë - vlerësohet të kenë rënë nën pragun e varfërisë ekstreme në 2020 krahasuar me parashikimet para pandemisë<sup>80</sup>. Pabarazia gjinore po rritet gjithashtu pasi miliona gra që janë punonjëse informale, janë detyruar të ndërpresin punën që nga fillimi i pandemisë. Për shembull, gratë përbëjnë 80 përqind të punëtorëve shtëpiak globalisht dhe 72 përqind e tyre kanë humbur punën si pasojë e pandemisë. Në Afrikën Sub-Sahariane, 41 përqind e bizneseve në pronësi të grave u mbyllën, krahasuar me 34 përqind të atyre që zotëroheshin nga burrat.

Gjatë pandemis sipas një studimi të Medina dhe Lenardo et al, rritja më e fortë (3.13 pikë përqindje) është shënuar në Kroaci nga 26.43% e PBB-së zyrtare (2019) në 29.56% (2020); Rritja e radhës më e fortë (2.81%) ishte në Bullgari nga 30.12% (2019) në 32.93% (2020). Rritja më e dobët (0.77) ishte në Finlandë nga 10.59% në 11.36% (të PBB-së); te e dyta (0,92) në Danimarkë nga 8,92% në 9,84% (të PBB-së).<sup>81</sup>

Këto janë vlera paraprake të cilat mund të ndryshojnë nën zhvillime të ndryshme ekonomike varsisht nga ndryshimet strategjike të çdo vendi në veçanti. Në vitin 2021 priteshte një rënie e vogël e ekonomisë informale në 17.42% të PBB-së (vlera mesatare për BE-në vendet); pra rënia mesatare e ekonomisë informale e vendeve të BE-së do të ishte 0.47 pikë përqindje, ose 2.52%. Shkaqet e kësaj rënie janë shpenzimet masive publike në infrastrukturës dhe subvencioneve për ndërmarrjet dhe individët e që shpresojmë se do të çojë në një rritje të

<sup>80</sup> Për më shumë shprehu me: "Pandemic, prices, and poverty". Daniel Gerszon MahlerNishant YonzanRuth HillChristoph LaknerHaoyu ĘuNobuo Yoshida|April 13, 2022. <https://blogs.worldbank.org/opendata/pandemic-prices-and-poverty>

<sup>81</sup> Për më shumë shprehuni me: "Back to Basics: Ęhat Is the Informal Economy?"Ms. Corinne C Delechat and Leandro Medina. Dec.2020. <https://www.elibrary.imf.org/vieĘ/journals/022/57/004/article-A014-en.xml>

konsiderueshme të PBB-së, së kombinuar me një rënie modeste të papunësisë. Këto vlerësime ekonomike dhe parashikimet e ekonomisë informale janë bërë në janar 2021 ku është ende e hapur kur do të përfundojë pandemia dhe kur rimëkëmbja e ekonomisë mund të fillojë.<sup>82</sup>

Kontributi i informalitetit në zhvillimin ekonomik dhe social është një çështje e rëndësishme. Vëzhguesit prirën të fokusohen në aspektet mbijetuese të ekonomisë informale, kontributi i tij në zhvillim përtej elasticitetit tërheq më pak vëmendje. Shpesh argumentohet se, megjithëse ekonomia joformale kontribuon në rritjen ekonomike dhe siguron mjete jetese për miliarda njerëz në vendet në zhvillim, të cilët mund të mos jenë në gjendje ose të mos dëshirojnë të formalizohen, ajo është një sektor shumë joproduktiv, ofron kushte inferiore pune dhe çon në evazion fiskal të brendshëm dhe konkurrencë të pandershme ndërmjet formaleve dhe firmat informale. Realiteti është më kompleks dhe meriton një hetim më të afërt.<sup>83</sup>

---

<sup>82</sup> Përshtatur nga: Luz A. Flórez & Leonardo Fabio Morales & Daniel Medina & José Lobo, 2021. "Labor flows across firm size, age, and economic sector in Colombia vs. the United States," *Small Business Economics*, Springer, vol. 57(3), pages 1569-1600, October.

<sup>83</sup> Për më shumë lexo në: OECD and International Labour Organization. Tackling Vulnerability in the Informal Economy. OECD Development Centre. <https://www.oecd-ilibrary.org/docserver/939b7bcd-en.pdf?expires=1660491862&id=id&accname=guest&checksum=957EB9589C13FA77396B83DF26A910C4>



## KAPITULLI III: PËRMASAT E EKONOMISË INFORMALE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

### III.1. Ekonomia informale në R. e Shqipërisë

Sot, një temë shumë e përfolur në vendin tonë, informaliteti. Është bërë një temë e rëndësishme që në fazat e hershme të tranzicionit drejt ekonomisë së tregut. Nga vitet 50-ta dhe 60-ta në mbarë botën fillojë interesi për studimin e kësaj teme të shumë përfolur rreth ekonomistëve, si një problem për tu studiuar. Ky fenomen i studiuar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) në vitin 1972 me temë dhe emrin „sektor informal“<sup>84</sup>, kurse në Shqipëri interesi i përgjithshëm për studimin e Informaliteti filloi pas vitetve të 90-ta. Sot, është një temë e gjërë që përfshin edhe vendet e Europës. Ndoshta një përkufizim tjetër për informalitetin mund të jetë edhe ai që i drejtohet çdo aktiviteti ligjor ekonomik që zhvillohet jashtë çdo hetimi të kontrollit ekonomik. Kjo do të thotë në kuptim më të gjërë se informaliteti i referohet aktiviteteve ekonomike që normalisht janë objekt i taksave dhe tatimeve dhe duke mënjanuar llojet e aktiviteteve tjera që konsiderohen në mënyrë të qartë nga legjislati si të paligjshme. Kjo e fundit, nëse do të studioheshte në hollësi jam e sigurt që do gjindeshin shumë faktorë që nxjerrin numrin më të madh të informalitetit në vendin tonë. Pothuajse çdo ditë jemi duke lexuar artikuj të ndryshëm rreth këtyre aktiviteteve që kanë përfshirë vendin tonë. Vallë, deri kur do të vazhdojmë kështu dhe kush është fajtor për rritjen e informalitetit? Pyetje që në këtë punim nuk do ti zgjedhim, sepse angazhimi për hulumtimin e këtyre pyetjeve mund të jetë edhe i rrezikshëm në vendin tonë, pavarësisht dëshirës për ta analizuar dhe ta hulumtuar këtë fushë.

Për shumë vite me rradhë regjimi politik në Shqipëri ishte komunist, të cilin po ta krahasojmë me vendet e tjera të Europës, Shqipëria ka vuajtur një izolim total nga pjesa e zhvilluar e Europës, dhe si rrjedhojë ka patur një sistem ekonomik dhe social shumë të dobët. Por në fillim të viteve '90-ta, Shqipëria pranoi pluralizmin politik dhe kështu filloi procesin e tranzicionit drejt ekonomisë së tregut.<sup>85</sup> Një vend me ekonomi të centralizuar siç ishte Shqipëria para viteve 1990 nuk diheste shumë për ekonominë informale po thuajse fare. Mos funksionimi i mekanizmave efikase për parandalimin e një ekonomie informale nga ana e shtetit nuk ndodhi kur aktivitetet informale filluan të hapen me shpejtësi me liberalizimin e ekonomisë. Rënia poshtë e ekonomisë së centralizuar solli rritje të shpejtë të ekonomisë informale duke mos harruar të përmendim edhe krizat tjera që përballeshte vendi në atë kohë si diferencimi ekonomik dhe social gjatë gjithë periudhës së tranzicionit edhe me tej.

Por jo ndryshe nga vendet tjera ekonomia informale pothuajse njëjtë si vendet e tjera në tranzicion përballat me informalitetin për shkaqet e njëjta dhe po si ato, mundohet me e mbajt në kontroll këtë llojë ekonomie.

---

<sup>84</sup> Klarita Gërzhani –“Informal Sector in Developed and Less Developed Countries: A Literature Survey”.

<sup>85</sup> Për më shumë shprehuni me: [https://en.wikipedia.org/wiki/People%27s\\_Socialist\\_Republic\\_of\\_Albania](https://en.wikipedia.org/wiki/People%27s_Socialist_Republic_of_Albania)

Për më tej, ky punim ka për qëllim të shohë se si ekonomia informale (në hije) u referohet atyre aktiviteteve ligjore duke përfshir të gjitha prodhimet legale të të mirave dhe shërbimeve të prodhuara nga firmat, por edhe jo të regjistruara gabuara që nuk paraqesin të ardhurat e tyre me qëllim nga shteti në fjalë.

Në këtë pjesë do të diskutojmë shkurtimisht për qasjen tonë për vlersimin e ekonomisë informale në Shqipëri. Vlerësime të cilat tregojnë përdorimin e ekonomisë informale në forma të ndryshe si përdorimi i ekonomisë informale në para cash dhe at jomonetar dhe evazoni fiskal. Nga fjalja më sipër kuptojmë se për shkat të ekzistimit të parave të gatshme më së shumti qeveria nuk mund të demostroj të hyrat dhe humbjet nga të ardhurat.

Nëse shohim dallimin midis këtyre aktiviteteve nënvizojmë se në ekonominë kriminele ajo që është e ndaluar në të, siç quhet edhe vet joligjore, është vetë aktiviteti, ndërsa në ekonominë ligjore informale, aktiviteti është i ligjshëm në vetvete, por të ardhurat fshihen dhe shmangen më anë të mjeteve të paligjshme.

Studimi i Schneider (2010) ka vlerësuar ekonominë informale për periudhën 1999-2007 për Shqipërinë në mesatarisht 34.3% të PBB-së. Një studim më i fundit i Boka dhe Torluccio (2013) ka llogaritur se ekonomia informale për periudhën 1996-2012 vlerësohet mesatarisht nga 13.6% në 38% të PBB-së. Sipas Qeverisë shqiptare niveli i informalitetit në ekonomi vlerësohet të jetë mbi 50%.<sup>86</sup>Dhe me të drejtë, sepse duke parë të gjitha ato aktivitete informale të cilat funksionojnë në vendin tonë mendon këto shifra janë shumë pak pavarisht shifrave të institucioneve financiare ndërkombëtare. Kurse sipas Bankës botërore në periudhën e vitit 2018 ekonomia informale në Shqipëri vlersohet mesatarisht me 32.4%.

Në vitet 1997 dhe 1998 ekonomia pësoi rrënie, por menjëherë më pas mori një hov të madh. Në fillim të viteve 2000, niveli i rritjes së PBB-së ishte rreth 5 % në vit. Sidoqoftë, në vitin 2008 një krizë financiare u përhap në të gjithë botën, e cila preku edhe ekonominë shqiptare. Kjo për shkak se eksportet pësuan rrënie dhe emigrantët shqiptarë kishin më pak para për t'u dërguar familjeve të tyre apo për të shpenzuar në Shqipëri. Pas krizës financiare, rritja ekonomike ka qenë më e ulët se më parë, me rritjen më të ulët në vitin 2013.

Sipas një artikulli të gazetës „ Tirana Times”<sup>87</sup>, e cila shkruhen për ekonominë informale në vitin 2019 para pandemis, ku na sqaron se sipas një raporti te Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) ekonomia informale në Shqipëri, nga 158 vende të hulumtuara, rënditet e 54-ta në botë nga këto vende për madhësinë e ekonomisë informale në raport me PBB-në. Në mes tjerash në gazet përmendet edhe se madhësia mesatare ekonomisë informale në 158 vende është 31.9%, ndërsa Shqipëria ka ekonomin informale mbi mesataren botërore.

---

86 Kjo pjesë është përstatje e materialit original: sekretariati i Këshillit të Investimeve: Dokument Pune – Informaliteti, Sfidë e përbashkët Qeveri – Sipërmarrje, Dhjetor 2015. <https://www.investment.com.al/ëp-content/uploads/2015/08/Dokument-Pune-mbi-Infomalitetin.pdf>  
87 Përshtatur nga gazeta: “Tirana Times” Informal economy still at concerning levels. By Tirana Times.June 20, 2019. <https://www.tiranatimes.com/?p=142264>

Gjithashtu vlen të përmendet edhe fakti që ekonomia informale në Shqipëri sipas një studimi të Bankës Botërore ka filluar të ketë një vlersim për rregullat që Shqipëria po miraton për monitorimin e abuzimeve edhe pse zbatimi i tyre mbetet i dobët për shkak të infomalitetit të vazhdueshëm në fuqinë punëtore.<sup>88</sup>

Duke parë këto shifra dhe shumë arsye të tjera ideja për me humultu më së shumti për ekonominë informale lindi pikërisht nga përdorimi i paras cash dhe nga puna e dytë (e padeklaruar) e shumë njerëzve këtu në Shqipëri.

### **Si të mbahet në kontroll ekonomia informale?**

Lufta kundër informalitetit përben një seri ngjarjesh si nga e kaluara edhe tani. Raste të veçanta janë edhe në Shqipëri.

Në vitin 2015 Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) ra dakord për rekomandimin e „Tranzicionit nga ekonomia informale në ekonomi formale“. Në këtë rekomandim Organizata Ndërkombëtare e Punës këshillon disa elemente të ndryshme për kalimin nga informaliteti. Si pjesë e këtij rekomandimi është sigurimi i aksesit në shërbime cilësore të punësimit për të mbështetur njerëzit në gjetjen e një pune formale.

Konfederata Botërore e Punësimit është e përkushtuar për të mbështetur kalimin nga puna joformale në atë zyrtare. Shërbimet cilësore të punësimit kontribuojnë në krijimin e një rruge për të dalë nga punësimi informal pasi ato ofrojnë akses në punë formale dhe cilësore.

Një grup i madh masash kombëtare dhe ndërkombëtare janë marrë në industrinë e shërbimeve private të punësimit për të siguruar shërbime dhe punë cilësore, e në përputhje Konfederata Botërore e Punësimit ka zhvilluar gjithashtu një përmbledhje të nismave vullnetare që promovojnë praktikatat etike të rekrutimit të vendosura nga disa prej federatave të saj kombëtare.

Në nivele ndërkombëtare, kombëtare dhe korporative, industria punon me politikëbërësit dhe shërbimet publike të punësimit për të promovuar ofrimin më të mirë të shërbimeve të punësimit për punë kërkuesit në ekonominë formale dhe joformale. Konfederata Botërore e Punësimit, për shembull, kontribuon në Iniciativën e Panairit të Rekrutimit të ILO.<sup>89</sup>

---

88 Për më shumë shprehuni me gazetën: “Tirana Times” Informal economy still at concerning levels. By Tirana Times. June 20, 2019 <https://www.tiranatimes.com/?p=142264>

89 Për më shumë shprehuni: “Decent Work and Fighting Informality” <https://wecglobal.org/topics-global/decent-work-and-fighting-informality/>

### III.2. Faktorët që ndikojnë në ekonominë informale në Shqipëri

Sipas Schneider dhe Enste në punimin e tyre “Ekonomia informale në disa vende të botës: madhësia, shkaqet dhe pasojat” përshkruajnë qartë disa nga faktorët që ndikojnë në ekonominë informale në shumë vende të botës ku si tregues të shpeshtë janë si të ardhurat, papunësia, konsumi, korrupsioni, evazioni fiskal, përdorimi i parasë Cash si dhe disa faktorë të tjerë që janë të pabesueshme kur ka ekonomi të nëndheshme në një vend, gjë që i bën politikat e bazuara në këta tregues potencialisht më pak efektive.

Duke përmendur edhe më sipër se pas largimit të komunizmit në fillim të vitetve 1990, Shqipëria nga ky sistem pati ndikim negativ në ekonominë e vendit dhe pavarisht kësaj ekonomia informale pati rritje dhe kjo si pasojë e rregullave apo mungesve ligjore të shtetit. Ndryshimi i sistemit politik nga një vend me ekonomi e centralizuar në një ekonomi e tregut, patën ndryshime rrënjësore në sferën politike, ekonomike dhe sociale. Këto ndryshime të sistemeve të qeverisjes sollën ekonominë informale në një larshmëri faktorësh. Ky këndvështrim historik i Shqipëris lidhet me faktorët e ekonomisë informale edhe kësaj ditë të cilat numërohen si:

- Evazioni fiskla
- Tregu i parregulluar i punës
- Mosdeklarimi i të ardhurave
- Papunësia
- Sistemi tatimor
- Ekonomia e Cash-it
- Korrupsioni<sup>90</sup>

Një element i rëndësishëm i rritjes së ekonomisë së vendit është marrdhënia jo e mirë ndërmjet sektorit informal përmes treguesve të infrastrukturës publike, gjë që tregon qartë që ekonomia informale çon në uljen e rritjes ekonomike të Shqipërisë.

Pavarishtë përpjekjeve që nga viti 1997 në Shqipëri për regjimin e taksave dhe tatimeve të strukturuar si modele europiane, modele të TVSH për tatimin indirekt, tatimin për të ardhura personale dhe tatimin mbi fitimin si tatim direkt, implementimin e një sërë programesh për përmisimin e doganave dhe zyrat e tatim-taksave<sup>91</sup>, përsëri ky sistem ndikon ndjeshëm në rritjen e ekonomisë informale.

**Evazioni fiskal** mbetet një problem shqetsues në Shqipëri. Një temë e hapur e diskutuar nga të gjithë por pa asnjë rezultat i luftes kundër saj. Edhe pse taksat nuk janë shumë të larta në Republikën e Shqipëris, problemi qëndron tek mos barazia fiskale, taksimi i punës së lartë dhe taksimi i kapitalit të ulët. Sipas një interviste të Prof.Ass.Klodian Muco nga revista

---

<sup>90</sup> Përshtatur nga: Klarita Gërkhani –“Informal Sector in Developed and Less Developed Countries: A Literature Survey”.

<sup>91</sup> Kjo pjesë është përstatje e materialit original: sekretariati i Këshillit të

Investimeve: Dokument Pune – Informaliteti, Sfidë e përbashkët Qeveri – Sipërmarrje, Dhjetor

2015. <https://www.investment.com.al/ep-content/uploads/2015/08/Dokument-Pune-mbi->

[Informalitetin.pdf](https://www.investment.com.al/ep-content/uploads/2015/08/Dokument-Pune-mbi-Informalitetin.pdf)<https://www.investment.com.al/ep-content/uploads/2015/08/Dokument-Pune-mbi-Informalitetin.pdf>

“Monitori”<sup>92</sup>, shpjegon qartë se evazoni fiskal që nga viti 2008 ka pasë për herë të parë zbatimin e taksës së sheshtë apo proporcionale, e cila nga një anë ka ulë barrën fiskale. Në 2010 për herë të parë në Shqipëri u futën në treg kasat fiskale, të cilat kanë dhënë një rol të rëndësishëm në luftën kundër informalitetit. Në vitin 2021 qeveria Shqiptare zbatoi faturat elektronike dhe fiskalizimi në ato momente bëhet në kohë reale. Dhe me këtë rast janë lehtësuar kontrollet tatimore apo kryqëzimi i informacioneve, po gjithsesi kjo metod nuk është se ka zgjedhur problemet e evazionit. Dhe gjithsesi nëse duam të luftojmë evazionin fiskal nuk mjafton vetëm fiskalizimi, nevojitet ndërgjegjësimi i subjekteve, të presin kupon, nevojitet dënimi i evazionit fiskal dhe mbi të gjitha nevojitet një luftë e rreptë kundër korrupsionit në administratën tatimore. Shkaktare e ekonomisë informale-*evazoni fiskal*- që paraqet shqetësim për vendin tonë, pasi mos deklarimi i saktë i të dhënave statistikore si dhe raportet e sakta nga institucionet përgjegjëse për evazionin për çdo vit.

Vitet pas komunizmit kanë sjell ndryshime të madha në **tregun e punës**. Ndryshimet ekonomike në vend një transformim i tërë i ekonomisë së vendit ka sjell gjithashtu edhe ndryshime esenciale në strukturën e sektorve të prodhimit dhe të punësimit. Me rritjen e privatizimit të shumë bizneseve në vend u rrit bashkë me numrin e privatizimeve edhe numri i rritjes së ekonomisë informale e sidomos ekonomisë së zezë. Të dhënat mbi punësimin tregojnë se 10% e të punësuarve në Shqipëri në vitin 2016 punojnë jo në sektorin bujqësor, po si punëtor që kanë sipërmarrjen e tyre apo për llogari të tyre. Në Shqipëri masa e sektorit informal është më e madhe në zonat urbane 24% se sa në zonat rurale 5%.<sup>93</sup> Kurse, në kryeqytet rrethë 20% janë punësuar në punë me sipërmarrje familjare. Më shumë se 10 vjet më shumë se 90% e personave në sektorin informal kanë filluar punën me bizneset e tyre personale duke u ikur edhe tatimeve dhe për mendimin për të pasur më shumë fitime mbi to.

### **Mos deklarimi i të ardhurave**

Çfarë nënkuptojnë njëzëit me deklarimin e të ardhurave në Shqipëri nuk është vetëm deklarimi bruto nga rroga e tyre mujore, ato të ardhura që vinë nga paga, por edhe deklarimi i të ardhurave që burojnë edhe nga elemente të tjera siç janë: shitjet e pasurive, të ardhurat bruto nga interesat bankare, qiraja, shërbime që ofrohen jashtë Shqipërisë, të ardhurat nga pasuria intelektuale, liçencat, edhe bonuset që i marrin gjatë punës. Të gjitha këto të ardhura llogariten si të ardhura personale.

---

<sup>92</sup> Përshtatur nga gazeta online me titull: „Problemet e fiskalizimit në Shqipëri dhe Evazoni fiskal“. Monitor. Botuar, janar 2021. <https://www.monitor.al/problemet-e-fiskalizimit-ne-shqiperi-dhe-evazoni-fiskal/>

<sup>93</sup> Përshtatur nga studimet: „Politikat e punës, arsimi dhe tregu i punës.“ univerziteti Aleksandër Mojsiu. <https://www.uamd.edu.al/nee/ep-content/uploads/2013/01/Politikat-e-pun%C3%ABsimit-dhe-tregu-i-pun%C3%ABs-ne-Shqip%C3%ABri.pdf>

Deklarimi i të ardhurave në Shqipëri bëhet nga çdo person individ me të ardhura mbi 2 milion lekë<sup>94</sup> dhe të dypunësuarit pavarësisht nivelit të pagës janë të detyruar të paraqesin të ardhurat e tyre vjetore. Mos paraqitja e këtyre të ardhurave rrit automatikisht edhe rritjen e ekonomisë informale në vend.

Me publikimin e të dhënave private të mbi 637 mijë shqiptarëve me publikimin e pagave të tyre, vitin e kaluar u bë një skandal i madh ku tregoheshte edhe vendi i punës dhe identiteti i tyre. Nga ku u pa se, jo çdo kush ka deklaruar të ardhurat e tyre, ku me këtë rast u bë edhe hetimi i drejtorisë tatimore. Nga kjo listë kuptohet se në janar të vitit 2021 rreth 40 mijë persona kanë të ardhura nga 100 mijë lekë deri në 2 milionë lekë në muaj, 59 persona kanë pagë nga 2 milion deri në 4 milionë lekë, ndërsa 23 persona kanë pagë nga 4 milionë deri në 50 milionë në muaj.<sup>95</sup>

### **III.2.1. Papunësia**

Një ndër problematikat kryesore që mbetet pa u zgjedh sot e kësaj dite është çështja e papunësisë në vendin tonë. Ky fenomen mjaft kompleks ende i pazgjidhur në Shqipëri, luhetet me shifra të paqarta statistikore të cilat bien në kundërshtim me zhvillimin e ekonomisë informale të vendit. Sipas INSTAT bazuar në shkallën e papunësisë nga viti 2017 në vitin 2021, kjo shkallë ka pësuar rënie në masë 5% tek grupmoshat e të rinjve, tek grupmoshat e moshës mesatare 30-64 vjeç ka rënë me 1.8%. Duke krahasuar me periudhën e vështirë ekonomike të vendit që kalojnë gjatë pandemisë shohim se nuk ka rënie të madhe të shkallës së papunësisë në vitet 2019-2021.

Nëse shohim një këndvështrim tjetër, ekonomia informale lejon që një pjesë e madhe e njerëzve në Shqipëri të dalë nga një situatë siç është varfëria ekstreme dhe të mbijetojnë me ato të ardhura që janë të kënaqshme për ta. Sipas Bankës Botërore vendet e punës nuk janë në rritje në vitin 2020-2021, kjo situatë edhe për shkak të daljes së situatës nga pandemia por edhe nga kriza e tërmetit që pësoj Shqipëria në vitin 2019. Mbi 16000 njerëz kishin më pak të punësuar në vitin 2021 në krahasim me vitin 2019. Paga reale u rrit me 3.7% në vitin 2021, ndërsa paga minimale u rrit me 13.1% në terma realë. Por duke patë parasysh rritjen e PBB-së për frymë, sipas Bankës Botërore, në vitin 2021 varfëria vlerësohet të ketë rënë ndjeshëm nga 31.4% në 2020, në 22% në vitin 2021. Nga këto shifra shohim se ekonomia informale është rritur si rezultat i rritjes së varfërisë, e që kjo e fundit çon në rritjen e ekonomisë informale.<sup>96</sup>

---

<sup>94</sup> Përshtatur nga gazeta online Monitor me titull: "Deklarimi i të ardhurave dhe pagesa shtesë shtyhen deri në 30 qershor." botuar në Maj 2021. <https://www.monitor.al/deklarimi-i-te-ardhurave-dhe-pagesa-shtese-shtyhen-deri-ne-30-qershor/>

<sup>95</sup> Përshtatur nga gazeta online shqiponja.com me titull: "Skandal me të dhëna private, pagat e mbi 637 mijë shqiptarëve dalin në publik! Nisin hetimet për Drejtorinë e Tatimeve! Qeveria: Nuk ka rrjedhur nga Ministria e Financave." <https://shqiptarja.com/lajm/skandal-me-te-dhenat-private-pagat-e-mbi-637-shqiptareve-dalin-ne-publik-nisin-hetimet-ndaj-tatimeve-dhe-sigurimeve-shoqerore>

<sup>96</sup> Për më shumë shprehuni me: "World Bank of Albania." <https://www.worldbank.org/en/country/albania/overview#3>

Tabela nr.4. Shkalla e papunësisë në Shqipëri për vitet 2017-2021.<sup>97</sup>

Grupmosha	Shkalla e papunësisë/ Unemployment rate					Age group
	2017	2018	2019	2020	2021	
<b>Gjithsej</b>						<b>Total</b>
15-29	25,9	23,1	21,5	20,9	20,9	15-29
30-64	10,8	9,2	8,7	9,2	9,0	30-64
15-64	14,1	12,8	12,0	12,2	12,0	15-64
15+	13,7	12,3	11,5	11,7	11,5	15+
<b>Meshkuj</b>						<b>Male</b>
15-29	27,0	23,1	21,3	20,8	20,5	15-29
30-64	11,3	9,4	8,8	8,8	8,7	30-64
15-64	15,1	13,2	12,2	12,0	11,8	15-64
15+	14,6	12,7	11,6	11,5	11,3	15+
<b>Femra</b>						<b>Female</b>
15-29	24,0	23,1	21,7	21,1	21,4	15-29
30-64	10,1	9,0	8,5	9,6	9,4	30-64
15-64	12,8	12,3	11,8	12,4	12,4	15-64
15+	12,6	11,9	11,4	11,9	11,8	15+
<i>Burimi i informacionit: Anketa e Forcave të Punës 2017-2021</i>						

Nga këto situata të statistikave të lartpërmendura janë vertet shumë shqetësuese e problematike pasi kuptojmë që këto grup mosha e sidmos të rinjtë kanë shumë pak të ardhura, e që nënkupton edhe shumë barrë të rëndë për qeverin Shqiptare.<sup>98</sup> Këto situata nënkuptojnë gjithashtu se shumica e të rinjve sidmos janë të “detyruar” për të parë një zgjedhje të tyre siç është futja në ekonomisë informale apo veprime edhe më të shumtuara se kjo siç është ekonomia e zezë apo veprime që janë kundra ligjit.<sup>99</sup> Kjo në Shqipëri ka ndodh edhe si pasojë e ndryshimeve të sistemeve, krizave që ka kaluar vendi si dhe ndryshimet e shpejta ekonomike, politik e sociale. Pavarisht shifrave të shkallës së papunësisë në vend përseri madhësia e mesatares së ekonomisë informale tregon shifra të mëdha. E pavarisht kësaj edhe pas shumë viteve në tranzicion në Shqipëri papunësia ka qenë dhe është ende një ndër faktorët e rëndësishëm të ekonomisë informale në vend.

### III.2.2. Ekonomia e Cash-it

Ekzistenca e ekonomisë “cash” krijon një terren potencial për lëvizjen e ekonomisë informale në një ekonomi kriminele, duke e mbështetur financiarisht krimin, e veçanërisht atë ekonomi të krimit të organizuar. Bizneset ku burimet të cilave nuk janë shumë të

<sup>97</sup> Përshtatur nga: Instat-Republika e Shqipërisë Instituti i Statistikave.<http://www.instat.gov.al/>

<sup>98</sup> Për më shumë shprehuni me: Instat-Republika e Shqipërisë Instituti i Statistikave.<http://www.instat.gov.al/>

<sup>99</sup> Këtu nënkuptohen të gjitha ato veprime që njëzë me vetë dëshirë shkonë në një vrasje apo vjedhje apo edhe vetvrasje, kontrabanda marrje me trafikime etj. I cili fenomen është shumë i shpeshtë në Shqipëri sot e kësaj dite.

besueshëm, si dhe proceset e pastrimit të parave rriten në vendet me para të nivelit të lartë ekonomik.<sup>100</sup>

Lirshëm thuhet se paralelisht si ekonomia informale ashtu edhe ekonomia e Cash-it kanë marrë një hovë të madh në Shqipëri. Bizneset në Shqipëri zakonisht nuk i kalojnë veprimet e tyre financiare përmes bankave me qëllim shmangies së obligimeve shtetërore, këta biznese përdorin para në dorë, gjë e cila çon në veprimin e ekonomisë informale. Faktorët që ndikojnë në ekonominë e Cash-it<sup>101</sup> janë:

- një pjesë e madhe e njerëzve kanë nivel të ulët të ardhurash
- mungesa e infrastrukturës së nevojshme në treg dhe në shërbime

Një tjetër faktor negativ i ekonomisë “cash”, është e lidhur drejtpërdrejt me Bankën e Shqipërisë, ku i referohet faktit se sasia e madhe e parasë në qarkullim ndikon negativisht në vlerën monetare politike. Aktivitetet e parave të gatshme parandaljnë përcjelljen e një imazhi të qartë dhe të plotë të zhvillimit ekonomik brenda vendit. Në Shqipëri treguesit e parave jashtë bankave vazhdojnë të jenë të larta edhe ku krahasohen me vendet e zhvilluara apo edhe ato në tranzicion. Sipas Bankës së Shqipërisë treguesi i qarkullimit të parave jashtë bankës mendohet të jetë më shumë se 1 miliard Euro.

Pavarsisht përpjekjeve për reduktimin e ekonomisë së Cash-it, gjatë përdorimit të palëve bankare, duke përdorur teknologji të reja dhe ofrimet dhe shërbime të reja, për të bërë një diferencim të vendodhjes fizike dhe marrjës së shërbimeve bankare, përsëri në Shqipëri nuk mund të këtë një ekonomi *JO Cash*. Një numër i madh i personave fizikë qofshin edhe ato juridik përdorin me vetëdije parane në dorë. Dhe kur ekziston kjo, atëherë do të ekzistoj edhe ekonomia informale sepse këta të dyja ecin paralelisht me njëra tjetrën.<sup>102</sup>

Sipas guvernatorit të Bankës së Shqipërisë lufta mbas pandemisë ka rritur edhe më shumë ekonominë e Cash-it. Me rritjen e parasë Cash në qarkullim gjatë periudhës së pandemisë dhe mbas saj u rrit paralelisht edhe depozitat (një nivel i lartë i likuiditetit, pavarsisht këtyre ndikimeve të pandemisë). Gjendja e Cash-it është rritur me 6 miliard lekë. Komponentet pasive duke parë një studim mbi ekonominë informale të Shqipërisë në vitin 2017<sup>103</sup>, të ekonomisë informale për të cilën paraja është shkak, zë 57.1% të ekonomisë informale të Cash-it, përafërsisht 10.9% e PBB-së, ose 164.5 miliardë lekë, ndërsa komponenti i angazhuar për të cilën paraja është pasojë, është vlersuar në 42.9%, përafërsisht 8.2% e PBB-së, ose 148.1% miliardë lekë. Kjo mund të tregojë edhe se për ta reduktuar ekonominë

---

<sup>100</sup> Përshtatur nga: “ON THE DEVELOPMENT OF THE ALBANIAN INFORMAL ECONOMY.” PhD Majlinda BELLO, PhD Frederik Çucllari, PhD Mirela CINI. [https://www.mnmk.ro/documents/2011-2/14\\_Albania\\_FFF.pdf](https://www.mnmk.ro/documents/2011-2/14_Albania_FFF.pdf)

<sup>101</sup> Për më shumë shprehuni me: “Drejt një ekonomie jo cash”. Shoqata Shqiptare e Bankave. <https://aab.al/ep-content/uploads/2018/07/Bankieri-28-Shqip-vizionim.pdf>

<sup>102</sup> Për më shumë shprehuni me: “Drejt një ekonomie jo cash”. Shoqata Shqiptare e Bankave <https://aab.al/ep-content/uploads/2018/07/Bankieri-28-Shqip-vizionim.pdf>

<sup>103</sup> Për më shumë shprehuni me: “Reducing the Shadow Economy in Albania through Electronic Payments”

This study was commissioned by Mastercard and was conducted independently by EY. [https://assets.ey.com/content/dam/ey-sites/ey-com/en\\_pl/topics/eat/pdf/03/ey-albania-shadoë-economy-study-report.pdf#page=10&zoom=auto,-14,815](https://assets.ey.com/content/dam/ey-sites/ey-com/en_pl/topics/eat/pdf/03/ey-albania-shadoë-economy-study-report.pdf#page=10&zoom=auto,-14,815)



informale një mënyrë tjetër për tu shmange parasë në dorë është nëpërmjet promovimit të pagesave elektronike.<sup>104</sup>

Po gjithashtu do të numërojmë edhe disa faktor të rëndësishëm të cilët kanë ndikuar në rritjen e ekonomisë informale në Shqipëritë marra nga:” *Management&Marketing, volume IX, issue 2/2011*” me nëntitull “*On the development of the Albanian informal economy*” ku rëndësisim:

- humbjen masive të vendeve të punës pas viteve 1990-ta dhe levizja e madhe demografike e popullsisë
- mungesa e besimit në kompetencat e institucioneve zyrtare
- administrimi joefektiv dhe korruptiv
- implikimi i pamjaftueshëm i ligjit dhe rregullave
- kostot e larta financiare, për ndërmarrjet private dhe barra e rënd administrative;
- politikat qeveritare joefikase për uljen e varfëris dhe rritjen e fuqisë punëtore;
- aplikimi i gjërë i transaksioneve financiare dhe pagesat jashtë sistemeve bankare.,etj.

---

<sup>104</sup> Përshtatur nga: :” Reducing the Shadoë Economy in Albania through Electronic Payments”

This study was commissioned by Mastercard and was conducted independently by EY.[https://assets.ey.com/content/dam/ey-sites/ey-com/en\\_pl/topics/eat/pdf/03/ey-albania-shadoë-economy-study-report.pdf#page=10&zoom=auto,-14,815](https://assets.ey.com/content/dam/ey-sites/ey-com/en_pl/topics/eat/pdf/03/ey-albania-shadoë-economy-study-report.pdf#page=10&zoom=auto,-14,815)

### III.3. Lufta kundër korrupsionit

Nga ku duhet të fillosh të hulumtosh kur bëhet fjalë për korrupsionin në Shqipëri, kur dihet se pothuajse çdo gjë është korrupsion! Të gjithë flasin, mediat, qeveria, ministrinë edhe më sipër, për luftën kundër korrupsionit në Shqipëri, po në fakt sa është luftuar ky fenomen? Çfarë lidhje ka me ekonominë informale dhe ku përdoret më shumë?

Ekonomia informale dhe korrupsioni në Shqipëri janë të lidhura shumë me njëra tjetrën. Mendohet që aty ku korrupsioni është më i madh aty ka edhe preardhjen më të madhe ekonomia informale. Shumë studime janë bërë në lidhje me korrupsionin edhe në Shqipëri. Sipasi një studimi të [Transparency International](#) mbi 180 vende të hulumtuara për korrupsionin në vitin 2020, ku bënë pjesë edhe Shqipëria, e cila rënditet e 110-ta.

Në bazë të raportit nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), raporton se bizneset, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Shqipëri shqetësim kryesor por edhe pengesë të madhe e kanë korrupsionin. Sipas këtij raporti konkurrenca nga ekonomia informale mbetet një pengesë kryesore por edhe korrupsioni është emëruar si një problem i madh edhe nga ndërmarrjet e mëdha. Sipas raportit të BERZH nga një anketë e bërë tek bizneset në Shqipëri, thuhet se 40.8% të bizneseve të anketuara raportojnë se përballen me konkurrencë nga biznese informale. Këto aktivitete informale zënë një pjesë të mirë të ekonomisë në vend. Periudha e viteve 1996-2012 përafërsisht zinte mesatarisht 36.2% të PPB<sup>105</sup>. Por ajo çka më shumë pengon zhvillimin ekonomik të vendit normalisht që lidhet me korrupsionin e vendit, por gjithashtu nuk i lejonë vendit që të përparojë si në rregulloret ligjore qeveritare, njëkohësisht degradon edhe shoqërinë. Në Shqipëri korrupsioni është i përhapur në bizneset duke deklaruar aktivitetet e tyre reale, duke bërë marrveshje të fshehta me zyrtar të administratës fiskale.

Grafiku nr.10. Korrupsioni në Shqipëri 2012-2021.


## ALBANIA

**Score**  
**35/100** [What does the CPI score mean?](#)

**Rank**  
**110/180**

**Score change**  
↓ -1 since 2020

Score changes 2012 - 2021



Burimi: Transparency International<sup>106</sup>

Cpi-corruption perceptions index- indeksi i perceptimit të korrupsionit.

<sup>105</sup> Përshtatur nga gazeta online Sot me titull artikulli: „BERZH: Informaliteti dhe korrupsioni, pengesat kryesore të biznesit në Shqipëri“. Botuar 2015. <https://sot.com.al/ekonomia/berzh-informaliteti-dhe-korrupsioni-pengesat-kryesore-t%C3%AB-biznesit-n%C3%AB-shqip%C3%ABri>

<sup>106</sup> Përshtatur nga: <https://www.transparency.org/en/cpi/2020>

Nga një projekt i realizuar në vitet 2016-2017 nga German Marshall Fund me temë studimi “*Monitoring the hidden economy in Macedonia, Albania and Kosovo trends, policies options (2016-2017)*”, interpretojnë se korrupsioni në Shqipëri është një problem kaq i madh sa që 3 e katërta e bizneseve të intervistuar (72.9%) japin mendimin që korrupsioni është faktor më i madhë dhe i rëndësishëm për ekzistencën e ekonomisë informale, e ndjekur nga “gjyqësori joefikas”(38.6% dhe “barra e lartë tatimore”(35.7%). Trajtimi i korrupsionit është lidhur me miratimin e masave të rrepta ligjore nga ana e shtetit që të mbërrin në një nivel të dëshirueshme për të arrit nivelin e uljes së korrupsionit - si shkaktar i madh i ekonomisë informale.<sup>107</sup>

Prof.Dr.Anastas Angjeli në librin e tij me titull: “*Tranzicioni dhe Liria Ekonomike në Shqipëri*”, përshkruan ngjarjet e korrupsionit për periudhën e viteve 1997-2004, ku përveç tjerash shpjegon edhe luftën që qeveria bashkë me OECD-në kanë ndërmarr për realizimin e një studimi për ekonomin e pakontrolluar në vendin tonë, duke e njohur gjëndjen e ekonomisë informale dhe korrupsionit në të njëjtën kohë, situatat, kanë zbatuar një program masash për luftën kundër korrupsionit dhe informalitetit në Shqipëri, duke përfunduar me një raport dhe me një sërë rekomandimesh për tu zbatuar. Por kjo nuk do të thoshte se këto raporte ishin një formul magjike për ta rregulluar menjëher gjendjen ku ndodhej ekonomia e vendit në atë kohë. Përkundrazi më shumë u përkeqësuan situatat, sa që korrupsioni vitet e fundit ka rritje më të madhe se sa vitet në fjalë.

Gjithashtu në librin e fundit të Prof.Dr.Agim Binaj me titull: “*Shqipëria në tranzicion të zgjatur.-politikat fiskale, korrupsioni, shpenzimet e mbrojtjes, arsimiti universitar, investimet, probleme e bujqësisë, profesioni i kontabilitetit dhe etika. (Analiza dhe studime)*”, luftën kundër korrupsionit që ndikon në rritjen e ekonomisë informale e shpjegon me qartësi duke treguar statistika të cilat tregojnë se në Shqipëri, korrupsioni është i pranishëm në të gjitha nivelet e administratës, duke filluar nga ministrat e deputetët dhe duke përfunduar te zyrat e thjeshta të bashkive apo të institucioneve ndërkombëtare. Studimet sipas Binaj tregojnë se rreth 68% e ministrave, 62% e deputetëve, 87% doganierëve, 79% e zyrtarëve të taksave, 72% e prokurorëve, 80% e gjykatësve, etj., rezultojnë të jenë të korruptuar.

Por, si luftohet ky fenomen? Mendimet janë të ndryshme duke u nis nga studimet që çojnë në mendimin që korrupsioni në zhvillimin e ekonomisë informale mund të jetë vetëm një fazë e një vendi që shlyhet ngadal me masat e gjëra që mund të marr një qeveri. Në Shqipëri nuk vlen ky mendim pasi këtu në radhë të parë duhet të krijohen ato ligje të cilat duhet një herë të zbatohen nga vetë qeveritarët, si ministrat apo deputetët, e pastaj të flitet për zbatimin e këtyre ligjeve për pjesën tjetër të popullsisë.

---

107 Përshtatur nga: “*Monitoring the Hidden Economy in Macedonia, Albania and Kosovo: Trends, Policies, Options (2016-2017)*”. A Project of the German Marshall Fund. <https://d4d-ks.org/ep-content/uploads/2018/02/Studija-Monitoring-EN.pdf>

### **III.4. Masat e zbatuara kundër uljes së ekonomisë informale në Republikën e Shqipërisë**

Si duket nga hulumtimet ndër vite edhe sot e kësaj dite në Shqipëri por edhe nëpër vendet e Ballkanit, lufta kundër ekonomisë informale nuk ka të mbaruar, pavarësisht përpjekjeve apo masave që kanë marrë qeveritë apo përpjekjeve të bëra nga vetë personat fizik apo edhe ato juridik. Shqipëria është në luftë me informalitetin.

Duke i përfshirë të gjitha strukturat administrative, konsumatorët, shoqërinë civile si dhe tregtarët nëvojitet sipas FMN-së një reformë e thellë dhe afatgjate për të zhdukur këtë ekonomi informale në vendin tonë. Patjetër që këto reforma nuk duhet të jenë aq shumë të rrepta pasi popullit shqiptar i duhet një gravitet më i butë i ngadaltë i këtyre masave për ti zbatuar pasi nuk janë mësuar më faktin që duhet të zbatohen ligjet e shtetit. Por preferohet që të nis si një proces i natyrshëm ndërgjegjësues për të gjithë qytetarët. Sugjerimet përfshijnë futjen e një konkurrence më të mirë për bizneset që depozitojnë numrin më të madh të faturave tatimore, ofrimin e provizioneve për bizneset që lehtësojnë barrën fiskale të vendit duke ofruar kuponë tatimor, ndërgjegjësimin, trajnimin e punonjësve tatimor dhe doganave për mënyrën e komunikimit me palët e interesuara, mënyra e marrjes së informacionit, etj.<sup>108</sup>

Pajtohem plotësisht me mendimin e Prof.Dr. Agim Balaj ku në librin e tij thekson qartë idetë se, faktikisht për të patur një luftë kundër informalitetit njëher e mirë duhet të kemi kontabilistë në Shqipëri. Po këto kontabilistë, ekspertë kontabël, duhet të jenë të parët, sepse prej aty fillon pothuajse gjithçka, ato janë që hartojnë shifra dhe pa këto shifra nuk ka as drejtim as qeverisje.

Në Shqipëri nuk merren aq seriozisht nga organet shtetërore pasqyrat financiare po pa këto pasqyra financiare si mund të kemi një drejtim, një qeverisje të mirë apo një administrim të drejt. Ky rol i i ekspertëve kontabel, i pasqyrave financiare, kontabilitetit duhet të ketë ndikim pozitiv në raport me ekonominë informale, ajo që nevojitet është përmisimi i ligjit të legjislacionit të shoqërive tregtare dhe ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.<sup>109</sup>

Këshilli Kombëtar i Punës është një institucion ku në çdo fund vit mund ti adresohesh me qëllim të problematikave që mund të vin nga tregu i punës, ku i përfshin edhe sigurinë në punë, ende nuk shofin një zjedhje që kanë të bëjnë me problematikat lidhur me informalitetin, sigurinë në punë si dhe problematikave të tjera.

Pavarësisht shoqërimit me një sërë problemesh edhe pse ekonomia informale në shtetet e zhvilluara dhe ato në tranzicion krijonë një rritje të ekonomisë së vendit, prap së prap mundohet që të luftohet si nga ana e organeve shtetërore po ashtu edhe nga vet njerëzit.

---

<sup>108</sup> Përshtur nga:Agim Binaj:” Shqipëria në tranzicion të zgjatur.-Politikat fiskale,Korrupsioni, Spenzimet e mbrojtjes, Arsimi Univerzitar,investimet, Probleme të Bujqësis, Profesionit I kontabilitetit dhe Etika.(Analiza dhe studime)”.-Tiran,2018. Faq.102.

<sup>109</sup> Përshtur nga:Agim Binaj:” Shqipëria në tranzicion të zgjatur.-Politikat fiskale,Korrupsioni, Spenzimet e mbrojtjes, Arsimi Univerzitar,investimet, Probleme të Bujqësis, Profesionit I kontabilitetit dhe Etika.(Analiza dhe studime)”.-Tiran,2018. Faq.102.

Masat që ndikojnë në zvoglimin e ekonomisë informale të një vendi lidhen edhe me faktorët që shkaktonin ekonominë informale. Por, si ndikojnë këto masat në këto faktor? Faktikisht nëse merren masa për t'i zbutur faktorët e nxitjes së ekonomisë informale mund të konstatojmë se kemi arritur një qëllim.

Në Shqipëri zbatimi i ligjeve kundër informalitetit është i domosdoshëm. **Ndryshimi i reformave tatimore** mund të jenë një lëvizje e mirë strategjike, reformat e administratës tatimore shpesh mundën të përmisojnë ose të përkeqësojnë gjendjen ekonomike të një vendi. Numri i taksave, pagesat dhe orët e nevojshme për të paguar taksat janë përkatësisht 19%, ku 43% më të larta në krahasim me mesataren e vendeve të Ballkanit perëndimor.<sup>110</sup> Po Të ardhurat e qeveris së përgjithshme, si tatimore dhe jotatimore, janë më të ulta në Shqipëri sesa në vendet tjera fqinje të saj. Deri në vitin 2014, barra tatimore në Shqipëri ka qënë më e ulët se sa në shumicën e ekonomive të tjera të Ballkanit. Në veçanti kontributet nga taksat mbi të ardhurat, taksat mbi pronën dhe mbi të gjitha sigurimet shoqërore janë dukshëm më të ulta në krahasim me vendet Ballkanike.<sup>111</sup>

Që nga viti 2015 qeveria Shqiptare ka hartuar plane strategjike për reduktimin e ekonomisë informale, duke marrë vendime të ndryshme duke zbutur çështjet që lidheshin me informalitetin. Qëllim kishte edhe vënien e gjobave ndaj bizneseve apo edhe personave fizik të cilët nuk paraqisnin tatimin ndaj shtetit. Këto plane analizojnë të gjitha çështje e veprimtarive informale duke e lidhur me qasjen e qeveris shqiptare për zbutjen e informalitetit duke synuar të nxjerrë rekomandime të zbatueshme dhe politika për zbatimin e reformave efektive.<sup>112</sup>

Edhe pse sot në vitin 2022 kemi pas 6 mujorin e parë aksione nga ana qeveritare duke luftuar informalitetin në atë mënyrë duke bllokuar 25 biznese (sallone bukurie), të cilat kanë ushtruar veprimtari të tyre të përegjistruar në organin tatimor. Por jo vetëm, kalimi i sezonit turistik siç e ka Shqipëria, informaliteti ka mbërrir kulmin e saj në lidhje me veprimaritë që janë ushtruar gjatë sezonit. U kryen edhe këtu shumë aksione duke mbyllur plazhet private të pa paraqitura dhe shumë aktivitetet të tjera që kanë punuar në të zezë. Pavarësisht mbylljeve të disa nga këto veprimtari përsëri numri i rritjes së informalitetit gjatë kësaj periudhe ishte shumë i lartë.

Aksionet që më së shumti janë marrë nga vet qeveria e shtetit kundër informalitetit më së shumti janë: drejtorit e përgjithshme të tatimeve, doganave dhe inspektoriatit të punës.

Plani ka përshifrë 78 zona në të gjithë territorin, me 95 grupe që kanë ndjekur aksionin për verifikimin e tatimpaguesve të përegjistruar në QKB dhe në organin tatimor, lëshimin e kuptonit tatimor si dhe paisjeve fiskale po ashtu edhe verifikimin e dokumentave me faturë

---

<sup>110</sup> Përshtatur nga: Për më shumë shprehuni me: "EKONOMIA INFORMALE SI BARRIERÀ PÀR NJÀ ZHVILLIM TÀ QÀNDRUESHÀM". prof.dr.MemaPreci. Dr.Zef Preci.

<sup>111</sup> Për më shumë shprehuni me: "EKONOMIA INFORMALE SI BARRIERÀ PÀR NJÀ ZHVILLIM TÀ

QÀNDRUESHÀM". prof.dr.MemaPreci. Dr.Zef Preci. [https://www.bankofalbania.org/rc/doc/Mema\\_Preci\\_272\\_1\\_10845.pdf](https://www.bankofalbania.org/rc/doc/Mema_Preci_272_1_10845.pdf)

<sup>112</sup> Përshtatur nga: "Emerging from the Darkness: Albania's Informal Economy". Brunilda Kosta.Shkurt 2018. <https://csisprosper.com/2018/02/16/emerging-from-the-darkness-albanias-informal-economy/>

tatimore të mallrave dhe subjekteve tjera. Nga 717 subjekte të kontrolluara nga të cilat 373 kanë rezultuar me ndryshime përgjegjësie.<sup>113</sup>

Pavarsishtë ndërmarrjeve të veprimeve kundër informalitetit nga ana e shtetit për të rritur sigurinë si dhe vënien e gjobave të shkelësve dhe abuzuesve informal, mbetën akoma të hapura sfidat<sup>114</sup>. Më shumë vëmendje marrin rastet si për shembull: shitja e qumshtit në trotuar apo të peshkut, shitja e produkteve ushqimore në rrugë. Një pjesë e mirë e tregtarëve veprojnë ende në informalitet të plot, pavarësishtë gjobave që mund të marrin për shkeljen e ligjeve dhe abuzimin e informalitetit përseri shqiptarët në Shqipëri nuk ndërgjegjësohen.

Shpesh është thënë se qeveria Shqiptare është ajo e cila duhet të marrë masa për ta ndaluar informalitetin. U tha me sipër se janë bërë përpjekje dhe janë marrë aksione për zbutjen e informalitetit po ku qëndron atëher problemi? Pse edhe sot e kësaj ditë përqindja e normës së madhësisë informale në Shqipëri është ende në rritje?

Pavarësisht këtyre përpjekjeve nga ana e qeverisë Shqiptare përseri qasja për ta luftuar informalitetin ka qënë e gabuar. Ka qënë nxitja e bizneseve dhe veprimtarive që janë të ekonomisë informale të kalojnë në ekonomin formale, e megjithatë vetë firmat mbajn rreziqe të konsiderueshme për transformimin nga informale në formale.<sup>115</sup> Por si do ishte më mirë? Faktikisht një fjalë e urtë popullore thotë: shqiptarët në përgjithsi nuk duhet me u bë shumë presion sepse kalojnë në anën e kundërt pastaj. Çfarë mundemi të zgjerojmë nga këtu është se edhe pse duhet të mirren masat rigorozë, që në thelb kanë përcaktuar detyrimet nga shteti të prera, për mos shmangien e taksave dhe veprimtarive tjera joformale nga vet personat fizik është se duhet të mirren masa më të buta, gradualisht për t'i vetëdijësuar të gjithë njerëzit se në fakt paraqitja e sigurimeve shendetsore është edhe për të mirën e tyre.

Një mënyrë tjetër e reduktimit të ekonomisë informale në Shqipëri është edhe largimi i paras cash nga përdorimi, e cila mund të reduktohet me promovimin e pagesave elektronike, duke përkufizuar përdorimin e parave të gatshme dhe nga ana tjetër edhe lehtëson transaksionet e paregjistruara. Por kjo metodë e përorimit mund të jetë e kufizuar pasi jo të gjithë konsumatorët kanë mundësi të bëjnë pagësa në mënyrë elektronike. Edhe me rihapjen e E-Albania, e cila është një platformë për pagesat e shërbimeve në mënyrë online, e cila platformë u mundëson të gjithë qytetarëve shqipëtar, bizneset e regjistruara në Republikën e Shqipërisë<sup>116</sup>, punonjësit e administratës publike në active directory, të kryejnë shërbime online të administratës publike, gjithsesi paraqet kufizim edhe për ato të vilët nuk kanë

---

<sup>113</sup> Përshtatur nga: "Aksioni kundër informalitetit, të dhënat e aksionit në tre ditët e para". Ministria e Financave. <https://financa.gov.al/aksioni-kunder-informalitetit-te-dhenat-e-aksionit-ne-tre-ditet-e-para/>

<sup>114</sup> Për më shumë shprehuni me: Përshtatur nga: "Emerging from the Darkness: Albania's Informal Economy". Brunilda Kosta. Shkurt 2018.

<https://csisprosper.com/2018/02/16/emerging-from-the-darkness-albanias-informal-economy/>

<sup>115</sup> Përshtatur nga: "Emerging from the Darkness: Albania's Informal Economy". Brunilda Kosta. Shkurt 2018. <https://csisprosper.com/2018/02/16/emerging-from-the-darkness-albanias-informal-economy/>

<sup>116</sup> Për më shumë shprehuni me: <https://e-albania.al/Pages/eAlbania.aspx>

## Ekonomia informal, përmasat dhe efektet e saj në Republikën e Shqipërisë

mundësi për qasje online dhe kjo përseri i çon qytetarët që transaksionet ti bëjnë me para në dorë.

## KAPITULLI I IV: RAST STUDIMI REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### IV.1. Analizë empirike

Sipas Fridrich Schneider studimet e tij sidomos viteve të fundit kanë treguar se në vendet të zhvilluara kemi pas rënie të nivelit të mesatares së ekonomisë informale. Në kapitullin e dytë, kemi sqaruar në pjesën e parë ulje si në vendet e zhvilluara po ashtu edhe ato në zhvillim. Shqipëria sipas studimeve që janë marrë me rastin e saj, sidomos këto 10 vitet e fundit nuk ka pësuar ulje të mesatares së ekonomisë informale dhe përqindjet e saj paraqiten sipas Schneider po aty, pa ndonjë ndryshim të madh. Ai ka vlersuar të jetë në 30-35% niveli i mesatares së ekonomisë informale në Shqipëri.

Po a janë këto shifra të njëjta të ekonomisë informale me atë çka ne shofim në përditshmërinë e vendit tonë. Sipas qeveris Shqiptare (FMN)<sup>117</sup> kjo shifer tejkalon 50% e mesatares së rritjes së ekonomisë informale në vendin tonë. Studiuesit e ekonomisë informale bihen dakord për ekzistencën e shifrave marramendëse të punës së “fshehur” në Shqipëri dhe fitimet e nxjerra nga ajo. Mirëpo, vihet në pyetje edhe metodologjia e tyre. Metoda për përdorimin e kësaj ekonomie i shofim të shumta. Ajo çka ne më shumë biem dakord edhe me hulumtime të studiuesve të ndryshëm, është fakti se paraja në qarkullim vinë më së shumti nga ekonomia e “zezë”. Rasti i Shqipërisë është interesant sepse sa më shumë fillon të hulumtosh aq më shumë fillon e rikërkon edhe më shumë nxitesh nga kurshtja e parasë në qarkullim dhe punës në të “zezë”.

Ky studim kishte për qëllim të zbulojë një pjesë të mirë të qytetarve edhe në rajonin e Shkodrës, me plotë interes, të cilët punojnë me vetëdije në ekonominë informale.

Në Shqipëri numërohen rreth 162.342 ndërmarrje gjatë vitit 2019. Në vitin 2020 numërohen rreth 166.386 ndërmarrje aktive duke shënuar një rritje me 2.5% nga viti paraprak. Ndërmarrje të regjistruar në këtë vitë përfshin edhe fermerët duke shënuar një rritje me 9.3% krahasuar me vitin 2019.<sup>118</sup> Por më së shumti ekonomia Shqiptare është e përqëndruar në aktivitetet tregtare. Këto ndërmarrje zënë 22.1% të ndërmarrjeve të regjistruara në vitin 2020. Po përveç aktivitetetve tregtare, në tabelen e mëposhtme shofim edhe sektorët të tjerë të ndërmarrjeve aktive sipas aktivitetit ekonomik dhe madhësisë.

Tabela nr.5. Numri pjesmarrës i ndërmarrjeve Shqipëri

<sup>117</sup> Sipas qeveris shqiptare ,FMN në kthllapa ka nënkuptimin edhe të Fondit Monetar Ndërkombëtar, ku sëbashku për llogaritjet e mesatares së ekonomisë informale në Shqipëri.

<sup>118</sup> Përshtatur nga Instituti i Statistikave në Shqipëri: <http://www.instat.gov.al/media/8440/njoftim-per-media-regjistri-i-ndermarrjeve-2020.pdf>



## Ekonomia informal, përmasat dhe efektet e saj në Republikën e Shqipërisë

Gjendje në fund të vitit, 2020

Aktiviteti ekonomik	Gjithsej	Grupuar sipas numrit të të punësuarve			
		1-4	5-9	10-49	50+
<b>Gjithsej</b>	<b>166.386</b>	<b>149.772</b>	<b>7.583</b>	<b>7.052</b>	<b>1.979</b>
<b>Prodhuesit e të mirave</b>	<b>65.042</b>	<b>60.403</b>	<b>1.704</b>	<b>2.177</b>	<b>758</b>
Fermerë	49.053	49.053	-	-	-
Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	1.358	1.186	86	74	12
Industria	9.571	6.714	1.042	1.282	533
Ndërtimi	5.060	3.450	576	821	213
<b>Prodhuesit e shërbimeve</b>	<b>101.344</b>	<b>89.369</b>	<b>5.879</b>	<b>4.875</b>	<b>1.221</b>
Tregtia	43.668	39.367	2.330	1.748	223
Transporti dhe magazinimi	5.708	5.177	248	235	48
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	17.713	15.572	1.357	735	49
Informacioni dhe komunikacioni	3.349	2.858	216	220	55
Shërbime të tjera	30.906	26.395	1.728	1.937	846

Burimi: Bashkia Shkodër.

Nga këto të dhëna të ndërmarrjeve dhe sektorve ku prej nga shofim edhe ndikimin ekonomik të vendit, gjithashtu vërejmë se edhe nga cilët ndërmarrje, respektivisht sektor që më së shumti përfshihen në ekonominë informale.

Në rastin tonë duke analizuar një monster në rajonin e Shkodrës, ku nga 11.661 ndërmarrje të regjistruara bashkë me qarqet e saj, përfshin një pjesë të konsiderueshme të punës në rajon. Sipas Bashkisë së Shkodrës vetëm në qytet janë të regjistruar 5.675 ndërmarrje ku nga të cilat aktivitete që më së shumti ushtrojnë këto ndërmarrje janë: bujqësia e peshkimi, industria ushqimore, industria e tekstileve dhe e veshjeve, industria e lëkurave dhe e këpucëve, ndërtimi, tregtia, transporti/komunikacioni, aktivitete financiare dhe sigurimesh etj.<sup>119</sup>

Nga këto shifra do të shofim edhe se si ka ndikuar ekonomia informale nëpër këto ndërmarrje, se cilin sektor më së shumti ka prekur.

Qëllimi i këtij studimi e sidomos kësaj mostre ishte për të parë pse njerëzit në Shqipëri e sidomos në qytetin e Shkodrës veprojnë në mënyr ilegale. Kjo për shkak se këta persona fizik marrin punë informale, sepse u duhet apo sepse duhan? Për se bizneset e këtyre ndërmarrjeve punojnë punë informale? Ku qëndronte problemi me thelbësor dhe si e përmbanin këtë punë ato?

Studime të ndryshme dhe hulumtime të shumëllojshmëri lidhur me informalitetin në Shqipëri çojnë zakonisht tek hulumtimi i informalitetit në fuqinë puntore. Vlerat e ndryshme që kanë të bëjnë me informalitetin lidhen ngushtë me papunsinë dhe korrupsionin e sidomos për nivelin e informalitetit në sektorin privat, më së shumti në Shqipëri por edhe më gjërë.

<sup>119</sup> Përshtatur nga: Bashkia Shkodër: [https://www.bashkiashkoder.gov.al/ëeb/Profili\\_ekonomik\\_1115\\_1.php](https://www.bashkiashkoder.gov.al/ëeb/Profili_ekonomik_1115_1.php)

Qëllimi ishte që të mirren informacione nga bizneset jo të regjistruara por edhe ato formale. E para ishte shumë e vështirë, pothuajse e pamundur për të grumbulluar informacione për ekonominë informale në Shqipëri kështu që duke e ngushtuar hulumtimin tonë, për të bërë një mostër të vogël, për të gjetë informacione më të besueshme mbetëm në kërkime vetëm në rajonin e Shkodrës<sup>120</sup> duke u fokusuar më së shumti në këtë qytet pastaj për me pa edhe nëpër Shqipëri në përgjithsi.

Dy ishin pyetjet me rëndësi në këtë anketë drejtuar bizneseve por edhe fuqisë puntore qofshin ato persona fizik apo juridik. Duke kaluar në pyetjen dirkete pasi menduam që do kishim përgjigje më të saktë ishte :

- 🚩 Sa puntorë punojnë në firmën tuaj pa kontratë?
- 🚩 A punoni një punë të dytë dhe a i deklaroni taskat ndaj shtetit?
- 🚩 Sa është e vështirë nga ana e fuqisë puntore të raportojnë taksat në organet tatimore në firmën tuaj?
- 🚩 Pse e keni të vëshirë, apo mos dëshirë për t'i paraqit taksat në organet e tatimpaguesve?


Pse këto pyetje të lenë përshtypjen se ky hulumtim është kaq i thjeshtë?Pse ishte e vështirë të mblidhen të dhënat të cilat në vështrimin e parë duken aq të lehta duke menduar se tash duken aq shumë të qarta me sy por në fakt ishte shumë e vështirë të hulumtosh një analizë të kësaj ekonomie. Gjithsesi gjetëm shumë përgjigje që na interesonin për hulumtimin e këtij punimi dhe mbi të gjitha një numer të konsiderushëm mbledhje të të anketuarve.

E matur në përqindje mund të themi se nga përgjigjet lidhur me fuqinë puntore nga bizneset e anketuara në të gjitha firmat doli që 54% të punëtorve, mesatarisht 30% të fuqisë totale të punëtorve nuk deklarojnë taksat në shtet. Nga anketa e punëtorve duke u pytur kanë deklaruar se nuk paguajnë taksa 68% të tyre.

Grafiku nr.11. Ekonomia informale e fuqisë punëtore e personave fizik dhe juridik.

---

<sup>120</sup> Shkodra luan dhe do të luajë gjithmonë një rol kyç në ofrimin e shërbimeve të sistemit ekonomik, logjistik, arsimor, social e kulturor për të gjithë rajonin dhe komunitetin e Veriut, madje shtrirë dhe përtej kufirit.burimi I marrë nga [https://www.bashkiashkoder.gov.al/ëeb/Profili\\_ekonomik\\_1115\\_1.php](https://www.bashkiashkoder.gov.al/ëeb/Profili_ekonomik_1115_1.php)



Burimi: Nga mbledhjet e të dhënave të mostrës

Një shifër e pabesueshme ku në një vend që duket krejt normale, por nëse hulumton në thellësi zbulon gjëra të pabesueshme dhe shifra që nuk i përkasin ekonomisë së një vendi. Që do të thotë që këto puntorë nuk janë të paraqitur nga punonjësit e tyre. Kjo ndodhte për shkak se prej tyre 35% donin vet mos ti paguajnë taksa shtetit, pasi këto taksat ishin të papërbalueshme për jetesën në Shkodër, por të marrin pagën bruto ose më pak se ato punëtor që punonin me kontrat të punsuar më një rrogë më të ulët Neto për shkak të pagesave që bënin ndaj shtetit. E pjesa tjetër e të anketuarve nuk pagonin taksat, e thënë me fjalë të tjera 33% të fuqisë punëtore nuk i deklarojnë të ardhurat e tyre shtetit pasi paga që ato marrin nuk i mbulojnë shpenzimet, mos përballimi jetës së sotme nga pagat jo të kënaqshme. Nga këto persona nëpër firma nuk paraqiteshin pothuajse fare në organet shtetorore **praktikanët**. Ky fakt na shtyu që të mendojmë për analizat e mëtutjeshme moshat dhe pozicioni në punë luanin rol gjithashtu të rëndësishëm në ekonominë informale.


Nga këto pyetje përgjigjet e të cilëve ishin epike, befasuese nga statistikat që nxorrëm nga ky hulumtim. Ajo çfarë na ra në sy ishte se vërtet gjinia femërore, si në disa vende edhe në Shqipëri, ishte viktimë e ekonomisë informale.

Studime e Scheider tregonin qartë se gratë ishin më të prekur nga ekonomia informale në disa vende të botës por jo në çdo vend, po në Shqipëri ishte po e njejta situat ku ishin gratë në krahasim me burrat ishin me 25% më shumë se sa këto të dytë. Duke parë një hulumtim për punësimin e grave (femrave) në Shqipëri dhe Kosovë me temë studimi: " *Statusi i punësimit të vajzave e grave në Shqipëri e Kosovë me histori sukcesi nga rajoni*", shohim hulumtime që tregojnë se brenda vitit 2013-2019, numri i pjesëmarrjes së grave në tregun e punës është rritur nga 50% në 61%. Me këtë nënkuptojmë se edhe gjatë periudhës së pandemis, pavarisht ndërprerjes së punës, hapja e punëve online dhe shumë mënyrave të tjera, rriti punën për femrat më së shumti se sa për meshkujt në Shqipëri.

Duke parë modelin e krijuar në rajonin e Shkodës, nga shumica e pyetjeve që ju bëmë qytetarëve nga të cilët më shumë ishin gra të cilat përfshiheshin më së shumti në

ekonominë informale. Ku vërejmë që kjo ekonomi jo vetëm këtu por edhe në gjithë vendin më së shumti përfshin këtë gjini. Grat të cilat ose kishin një punë të dytë ose një punë të padeklaruar për arsye të të fitimeve që i llogarisnin të „pastra“.

Grafiku nr.12. Ekonomia informale e fuqisë punëtore.



Burimi: Nga të dhënat e anketës të kalkuluar nga vet autori

Sipas të anketuarve e sidomos bizneset 47% të tyre kanë deklaruar se punëtorët preferojnë të paguhen në para në dorë se sa nëpërmjet bankës. Nga bizneset në fjalë<sup>121</sup> duke përgjigjur pyetjes direkt më së shumti zbuluam se numri i punëtorve të paregjistruar që janë tërësisht informal punojnë gjithashtu edhe me orar të plotë. Por shumica e tyre kishin orare të shkurtuara, ose gjysëm orare. Deklarimi i punëtorëve treguan se vërtet ekonomia informale ndodh nëpër sektor të ndryshëm. Ku shumica e tyre ishin bujqë që shesin sot e kësaj dite nëpër gjithë Shqipërinë perime e pemë, produktet ushqimore të mishit, si dhe prodhimet e qumshutit, të gjitha të padeklaruar duke munduar të shesin edhe nëpër trotuare. Shitja e peshkut si dhe ndërtimi zenë një pjesë të madhe të ekonomisë informale në vend. E të gjitha firmat e vogla dhe të mesme kanë një numër të madh të fuqisë punëtore pa kontrat të padeklaruar të paregjistruar.


Në fakt nga këto shifra të hulumtuara gjithashtu mund të konkludojmë se sipas Bashkisë Shkodër ekonomia në vend e sidomos pas pandemisë, papunsia ishte në nivel të lartë. Sipas drejtoreshës së Zyrës së Punës në Shkodër ndërprerja e punës në kohën e pandemisë rriti papunësinë në vend por nga ana tjetër u rrit numri i informalitetit. Edhe pse sipas tyre (Bashkis Shkodër),<sup>122</sup>Shkodra njihet si një nga kryeqendrat e zhvillimit ekonomik, kjo për

<sup>121</sup> Këto biznese që janë intervistuar të gjitha po të gjitha mbeten anonime, asnjë nuk jepte informacion në lidhje me firmën e vet në lidhje me punëtorët dhe kontratat e tyre pa me qënë të sigurt se këto anketa mbesin plotësisht anonim. Në të kundërtën kishte kërcënime kundër anketuesit dhe abuzime totale. Këto kërcënime as që mundeshin të raportoheshin në organet institucionale dhe kështu që vendosem plotësisht vetëm për me marrë informacione të sakta ti respektojmë.

<sup>122</sup> Përshtatur nga :Bashkia Shkodër.Profili

shkak të trashëgimisë, vendodhjes gjeografike si dhe nga shpirti sipërmarrës që karakterizon popullin, shkalla e punësimit në krahasim me vitet para pandemis ishte 2.2% më e ulët.<sup>123</sup>

Procedurat e regjistrimit kanë lehtësuar edhe bizneset në Shqipëri por edhe në Shkodër. Në faqën e Bashkisë janë të sqaruara qartë lehtësimet që u janë bërë bizneseve edhe të qytetit të Shkodrës ku prej viti 2015 është krijuar një Qëndër Kombëtare e Biznesit<sup>124</sup> si rezultat i bashkimit të dy institucioneve edhe at Qendrës Kombëtare të Licensimit dhe Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Duke u mundësuar bizneseve në bazë të një sistemi elektronik të integruar të dhënash që realizon lidhjen e të gjitha sporteve të shërbimit me zyrën qendrore të QKB-së në Tiranë. Sipas QKB-së janë regjistruar gjithsej në Shkodër e rrethinë duke numëruar këtu edhe njësit administrative rreth 5676 biznese të vogla dhe të mesme.



**Grafiku nr.13. Aktivitetet që gjetën më shumë veten në mostrën e parashtruar në Shkodër**

*Burimi: Nga burimet e zgjedhjes së mostrës*

Por cilat fusha më së shumti i prekën kjo ekonomi? Spektri ndryshonë nga biznesi, nga puna që kryejnë, nga puna familjare e papaguar por që përfshin edhe vetpunësimin. Një punëtorë që nuk deklaron të ardhurat e tij mund të jetë edhe një shitës rruge, një bujkë, një fermer, një roje makinash, një kopshtarë, një pastruse, një qiradhënës, etj.

<sup>123</sup> Përshtatur nga: Bashkia Shkodër. <https://www.bashkiashkoder.gov.al/>

<sup>124</sup> Për më shumë shprehuni me: Bashkia

Shkodër. [https://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Profili\\_ekonomik\\_1115\\_1.php](https://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Profili_ekonomik_1115_1.php)

Por të gjithë këto karakteristika që përmendëm më sipër nuk do të thotë se janë të vetmet dhe nuk ka të tjera pasi një vend që nuk ka një ekonomi të fuqishme dhe një ekonomi në tranzicion, rrjedhin vazhdimisht ngjarje nga ekonomia informale.

Ky humumtim kishte për qëllim vlerësimin e ekonomisë informale nëpër sektorët e ndryshëm në Shkodër, e me testim të një mostre të veçantë në Shkodër. Studimet e shumta për të vlersuar ekonominë informale në Shqipëri na tregojnë se më shumë vlersojnë llojet e ndryshme të taksave që mendohet se ndikojnë pozitivisht në madhësinë e ekonomisë informale, por jo të gjitha. Duke analizuar më gjërë shofim se ndikim negativ në madhësinë e ekonomisë informale kanë taksat doganore. Kjo edhe për shkak se Shkodra është qytet që shtrihet me kufirin e Malitë të zi dhe me Kosovën, ku hyrjet dhe daljet doganore kontrollohen edhe aty. Duke parë shifrat nga Bashkia Shkodër dhe nga INSTAT për bizneset e kryer në Shkodër dhe në tërë Shqipërinë, duke analizuar me monstren tonë konstatohet se gjetja e numrit të papunisë që paraqitet në shifrat e INSTAT për vitet krahasuar 2017-2021 papunësia kishte rënie në 1.8% por përsëri nuk tregonin shifra që sipas burimeve tona ishin të përshtatme sepse nga 87% të të anketuarve (1 në 3 persona) ishin të punsuar.

Nga studimet që janë bërë për të parë përafërisht përllogaritjen e ekonomisë informale në Shqipëri, nga studiues të ndryshëm si Scheider(2002) apo Christie,E.,& Holzner,(2003) si dhe nga të dhënat e INSTAT apo Instituti Kombëtar i Statistikave të Shqipërisë, qëndronte po edhe sot, përafërisht mesatarisht 30-40% e PBB-së. Por, për një informacion po aq i saktë për llogaritjen e ekonomisë informale në Shqipëri në të ardhmen nuk ka ende një model tërësisht për Shqipërinë, pasi duke parë faktorët që ndikojnë si korrupsioni, që ndikonte ndjeshëm në mesataren e ekonomisë informale, paraqet penges kryesore për matjen e saj.

Nuk ka dallime domethënëse në mes të të dhënave nga këto studime të tjera dhe nga hulumtimet tona . Përveç rastit të papunësisë ku dyshimet tona ishin mos paraqitja e punës së personave fizik në institucionet përkatëse, bën që të rrisin numrin e papunësisë, në fakt hulumtimet tona tregojnë që numri i papunësisë është më i vogël krahasim me shifrat nga studimet të tjera. Gjë e cila çon edhe rritjen e normës së ekonomisë informale më shumë.

Në Shqipëri duke patur parasysh gjendjen ekonomike në vend, ekonomia informale në ditët e sotme konsiderohet si një peshë e rëndë, përplasje për konkurrencën e tregut, e cila po ashtu konsiderohet shumë e rëndësishme për ekonominë e Shqipërisë. Po në të vertet a do gjejmë një përgjigje të pyetjes se: kur dhe deri ku do ekzistoj ky fenomen në vendin tonë? Në fakt ka ekzistuar prej viteve 1991 e këtej dhe deri kur do vazhdojë?, faktikisht është një fenomen që nuk i dihet mbarimi, respektivisht i pashmangshëm në Shqipëri por edhe për vende të tjera sidomos të cilët nuk janë në gjendje që të arrijnë të shpërndajnë siç duhet (në një mënyrë sa më efikase) kapitalet dhe të ardhurat në vend.

Sipas të dhënave që kemi zbuluar në këtë punim një ndër to është edhe se, përdorimi i parave të gatshme ndikon në rritjen e mundësisë së ekonomisë informale në Shqipëri. Kjo e dhënë është e pranushme pasi nga hulumti jonë dhe nga vërtetimet e statistikave nga Banka e Shqipërisë ku përveç qarkullimit të parasë jashtë bankave ku përfshinte një shifër marramendse mbi 2 milion euro, vërtetojmë se qarkullimi i parasë në dorë është e lartë gjë që rrit normën e ekonomisë informale në Shqipëri.

Pavarshisht programeve strategjik që ka ndjek dhe është duke formuluar qeveria e Shqipërisë për ti administruar sa më shumë ngarkesën tatimore, regjistrimet apo kontrollin tatimor, dyshimet janë të qarta, pasi mendohet që qeverisja është jo aq e duhur për uljen e tatimeve në vend. Edhe pse në forma të ndryshme qeverisja e Shqipërisë nuk ka funksionuar si duhet në arritjen e qëllimeve të duhura për të arrit uljen e ekonomisë informale në vend.

Në kapitullin 1 sqarohen shumë me detaje edhe sektorët që ndikojnë më së shumti në ekonomin informale. Duke parë që bujqësia është një ndër sektorët që luan një rol të madh në rritjen ekonomike të vendit, mund të konfirmojmë se vertët ky sektor bashkë me peshkimin dhe pylltarinë janë sektorët që ngre më shumë nivelin e mesatares së ekonomisë informale në vend.

## KAPITULLI V: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Jo fortë e lehtë hulumtimi i aktiviteteve të ekonomisë informale, sfidat e një shteti ku përballë ekonomia informale nuk janë me një rrugë me dallga, e cila shoqërohet me produktivitet të ulët, të ardhura të reduktuara nga taksat, papunësi dhe varfëri e lartë, pabarazi e lartë, jo qeverisje e mirë e një shteti sidomos në vendet në tranzicion, e një sërë rregulla të tepërta të papërballueshme nga të shumica e personave qofshin fizik apo juridik.<sup>125</sup> Një ekonomi e cila sipas hulumtimit tonë duke e përmendur në kapitujt më sipër, zë një vend të rëndësishëm në ekonominë e një vendi. Një rol që përfaqëson të gjithë punën e aktiviteteve të individëve apo qofshin edhe biznese, ku nuk ka një kujdes nga marrëveshjet e aktiviteteve formale apo marrëveshjeve qeveritare. Ku në vendin në fjalë prekte një pjesë të mirë të aktiviteteve të sektorëve kryesor që përfaqësojnë më së shumti këtë ekonomi (sektorin bujqësor, tregjet e ushqimeve, shitësin e peshkut në trotuar e të ngjajshme.) duke përfshirë një pjesë të madhe sidomos të zonave rurale.

Ajo çka ne e vlersojmë është fakti që masat që duhet të mirren për të reduktuar ekonominë informale në vend, për ta përmisuar këtë llojë ekonomie, duhet nisur nga vetë përmisimi i qeverisë. Korrupsionin që kemi një faktorët kryesor si shumë edhe faktor të tjerë dukë i përmisuar në radhë të parë rrënjën prej ku mendohet se fillon gjithçka, sistemin arsimor duke e klasifikuar në një nivel më të lartë arsimin, duke përmisuar gjëndjen e aftësive punuese, një formim profesional, duke i nënvetësuar edhe njërzit e kësaj ekonomie, mendohet që mund të këtë një ulje edhe të ekonomisë informale. Një treg i kualifikuar gjithashtu do të përmisonte ndjeshëm sektorin informal.

Vështirsia e matjes së ekonomisë informale rezulton me pyetjet e drejtpërdrejta të bëra nga anketat në lidhje me këtë ekonomi. Mospërputhja dhe sidomos duke përdor parametra të njëjta në vende të ndryshme është e vështirë të krahasosh matjen e ekonomisë informale. Studiuat të ndryshme me përdimin e metodave të tjera arrijnë që të bëjnë një statistik të afrueshme me shifrat reale që mund të paraqes ekonomia informale në vend. Sipas ILO dhe Schneider ekonomia informale në Shqipëri e matur me MIMIC metodën del mesatarisht 30-35% të PBB-së së vendit. Po realisht dhe nga vetë qeveria Shqiptare mendohet që kjo mesatare është shumë më e madhe se sa këto shifra. Anketa jonë e hedhur rezultojnë në shifra marramendse të ekonomisë informale duke u përshtatur me realitetin e vendit që ndodhet vendi. Dhe analizuar vetëm ekonominë informale të një qyteti dhe shifrat treguan se në të gjithë vendin janë po thuajse të ngjajshme.

---

<sup>125</sup> Përshtatur nga: Anketa të bërë në lidhje me matjen e ekonomisë informale në faqen online: <https://www.worc.org/sq/how-to-measure-informality>



Punësimi i ekonomisë informale përqëndrohet tek punësimi familjar, të punuarit në shtëpi, në Shqipëri i njohur shitja në rrugë si dhe mbledhësit e mbeturinave.<sup>126</sup>

Nga hulumtimi i këtij punimi mund të konstatojmë gjithashtu se “fajtor” i ekonomisë informale është edhe vetë njeriu. Ky konstatim për shkakë nga ajo cfarë pamë dhe dëgjua, ndërgjegjësimi i qytetarëve për mos pagimin e tarifave të vogla është e papranushme. Shembull të thjeshtë kemi mos pagesën e tarifave të pastrimit të rrugëve dhe mbeturinave. Nëse krahasojmë me një shtet të zhvilluar ekonomikisht si Austria nga ekserienat personale, çdo qytetar pagonë tarifën e shtetit, siç morëm shembullin më sipër të pastrimit të rrugëve apo të mbeturinave, nga një shifër e caktuar nga qeveria Austriake. Mos pagimi i këtyre tarifave shtonë automatikisht në ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe masave të ndërmarra po ashtu nga shteti dhe funksionon në mënyrën më të mirë të mundshme, çdo detyrim ndaj shtetit si nga ana e personave fizik apo atyre juridik. Kurse këtu në Shqipëri ndodh krejt e kundërta e asaj që folëm më sipër. Personalisht jetoj ka 12 vite në Shqipëri dhe nuk më ka ardh ende një faturë për pagesën e mbeturinave. Në fakt ekziston një tarifë që është 5000 lekë të reja<sup>127</sup> në vitë dhe askush nuk paguan, flasim për qytetin e Shkodrës por edhe më gjërë, kjo tarifë dhe e gjitha hynë në zhvillimin e mëtutjeshme të ekonomisë informale në vend.

Në Ballkan si dhe në Shqipëri sfidat për të kaluar në një ekonomi formale si dhe hartimi i politikave është mjaftë e vështirë si një sfidë e rëndësishme e zbatimit të tyre. ***Aplikimi i teknologjive të reja së bashku me përsosjen e teknologjisë për pagesat janë thelbësore për përmirësimin e formalitetit.***<sup>128</sup>

Duke marrë parasysh të gjithë këto të dhëna për të pasur një mesatare të nivelit të ulët të ekonomisë informale në vend jemi të mendimit ***se përmisimi i arsimimit do të ishte një hap i rëndësishëm në luftë kundër informalitetit.*** Baza ku çdo gjë fillon nga një vetëdije e qytetarëve si përmisim i dukshëm për përparësi në zhvillimin e mëtutjeshëm të ekonomisë së vendit dhe bazave jetësore në Shqipëri.

***Përmisimi i korrupsionit i përmendur tash disa herë si dhe përmisimi i ngarkesave tatimore duke ndjekur strategji më të përshtatshme dhe të pranushme për qytetarët e vendit si dhe mos përdorimi i paras së gatshme në treg duke futur mënyrën elektrike do të ishin zgjedhje më e duhur për mbajtjen pak a shumë në kontroll të ekonomisë informale në Shqipëri.***

---

<sup>126</sup> Përshtatur nga: Anketa të bërë në lidhje me matjen e ekonomisë informale në faqen online: <https://lwworc.org/sq/how-to-measure-informality>

<sup>127</sup> Përshtatur nga: <https://dptv.gov.al/taksat-qe-paguajne-bizneset/#>

<sup>128</sup> Përshtatur nga: “Matja e ekonomisë informale dhe dixhitalizimi-një nëvojë e menjëhershme kundër evazionit në Shqipëri.” Altax-Policy Analyse and Consultancy. Shkurt 2020. <https://www.linkedin.com/pulse/matja-e-ekonomis%C3%AB-informale-dhe-dixhitalizimi-nj%C3%AB-nevoj%C3%AB-gjokutaj>

## Bibliografia

### Libra:

1. “Shqipëria në Tranzicion të zgjatur”,(politikat fiskale, korrupsioni, shpenzimet e mbrojtjes,arsimi univerzitar,investimet, problemet të bujqesis,profesioni i kontabilitetit dhe Etika), prof.dr. Agim Binaj, Tiranë,2018. Shtëpia botuese Ilar.
2. „Tranzicioni dhe Liria Ekonomike në Shqipëri”, Prof.dr. Anastas Angjeli. Tiranë ,2007 shtëpia botuese Geer.
3. „Financa Publike“, Prof.dr. Sabri Kadriu, Prishtinë, 2012.
4. “Makroekonomia” –botim ndërkombetare. Rudiger Dornbusch & Stanley Fischer, përkthyer nga Prof.dr. Marta Muco,Prof.dr. Sulo Haderi Botimi Dituria Tiranë 2000.
5. “Biznesi taksat manipulimet “ Av. Fatjon Kosta , shtëpia botuese Uegen, Tiran, 2021
6. “Sistemi i korrupsionit” Piercamillo Davigo, botime përkthime nga italishta Zamir Poda,Tiranë 2011
7. “Kriza financiare apo globale”, Adrian Civici ,Tiranë 2010

### Punime shkencore:

1. EY Economic Analysis Team:”Reducing the Shadow Economy in Albania through Electronic Payments”,
2. “*Shadow Economies: Size, Causes, and Consequences*“, F. Schneider & D. Enste, the Journal of Economic Literature, Vo. 38, pp. 77-114
3. Hetemi,Alban. Konxheli,Drita. Gulhan,Ozan. Balaj,Driton.: „EuroEconomica”-Factors of the Shadow Economy in the Republic of Albania.2018
4. Muharremi,Oltiana:”Tax Evazion and Set Backs of the Shadow Economy in Albania”,Rome-Italy,2014.
5. “*Size and Development of the Shadow Economies of 157 Countries Worldwide: Updated and New Measures from 1999 to 2013*“, M. Hassan and F. Schneider, [IZA Discussion Paper No. 10281](#), 2016
6. Trebiçka,Brunela:” the Size of Underground Economy in Albania”, Rome-Italy,2014
7. Hidden economy in the Western Balkans 2020:Trends and Policy Options, Policy Brief No. 11, November 2020
8. Schneider, Friedrich G. and Buehn, Andreas, Estimating the Size of the Shadow Economy: Methods, Problems and Open Questions (October 31, 2013). CESifo Working Paper Series No. 4448, Available at SSRN

9. *World Underneath: The Origins, Dynamics, and Effects of the Informal Economy*", Castells, M. and A. Portes. In A. Portes, M. Castells & Lauren A. Benton, eds. *The Informal Economy: Studies in Advanced and Less Advanced Developed Countries*. Baltimore, MD, USA: John Hopkins University Press, 1989
10. *Informal Economy Opportunities and Urban Employment in Ghana*", Keith Hart, *The Journal of Modern African Studies*, Vol. 11, No. 1, 1973, pp. 61-89, published by Cambridge University
11. *The Informal Economy: Definitions, Theories and Policies*", Martha Alter Chen, WIEGO Working Paper No. 1, 2002
12. *The Mystery of Capital: Why Capitalism Triumphs in the West and Fails Everywhere Else* ", de Soto, H., New York: Basic Books, 2000
13. *Shadow Economies Around the World: What Did We Learn Over the Last 20 Years? Prepared by Leandro Medina and Friedrich Schneider*<sup>1</sup>
14. Luz A. Flórez & Leonardo Fabio Morales & Daniel Medina & José Lobo, 2021. "Labor flows across firm size, age, and economic sector in Colombia vs. the United States," *Small Business Economics*, Springer, vol. 57(3), pages 1569-1600, October.
15. :*"Monitoring the Hidden Economy in Macedonia, Albania and Kosovo: Trends, Policies, Options (2016-2017)"*. A Project of the German Marshall Fund

#### **Gazeta:**

1. Shqipëria sot."Skandal me të dhënat private, pagat e mbi 637 mijë shqiptarëve dalin në publik! Nisin hetimet për Drejtorinë e Tatimeve! Qeveria: Nuk ka rrjedhur nga Ministria e Financave".
2. Monitori. Me titull gazete:"Korrupsioni dhe ndikimi politik, shkaqet kryesore që nxisin informalitetin në Shqipëri."
3. "Tirana Times" Informal economy still at concerning levels. By Tirana Times.June 20, 2019.
4. Shqiponja.com me titull:" Skandal me të dhënat private, pagat e mbi 637 mijë shqiptarëve dalin në publik! Nisin hetimet për Drejtorinë e Tatimeve! Qeveria: Nuk ka rrjedhur nga Ministria e Financave

**Ueb faqe:**

1. <https://financa.gov.al/ministria-ibrahimaj-ekonomia-ka-shenuar-rritje-presim-te-jete-8-6-ne-vitin-2021/>
2. <https://www.uamd.edu.al/new/wp-content/uploads/2013/01/EKONOMIA-INFORMALE-NE-SHQIPERI>
3. <https://www.investment.com.al/wp-content/uploads/2015/08/Dokument-Pune-mbi-Informalitetin.pdf>
4. [https://www.bankofalbania.org/rc/doc/Mema\\_Preci\\_272\\_1\\_10845.pdf](https://www.bankofalbania.org/rc/doc/Mema_Preci_272_1_10845.pdf)
5. [https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---dgreports/---integration/documents/publication/wcms\\_079142.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---dgreports/---integration/documents/publication/wcms_079142.pdf)
6. <https://dosja.al/informaliteti-shkak-korrupsioni-ne-shqiperi-35-e-ekonomise-eshte-informale/>
7. <https://portalb.mk/705009-ekonomia-informale-terren-pjellor-per-krimin-e-organizuar-ne-rmv-shqiperi-dhe-kosove/>
8. [https://www.academia.edu/19702924/Mikroteze\\_Eralda](https://www.academia.edu/19702924/Mikroteze_Eralda)
9. <https://www.worldeconomics.com/Informal-Economy/Croatia.aspx>
10. <https://www.wienerzeitung.at/nachrichten/wirtschaft/oesterreich/2089817-Wirtschaft-im-Dunkeln.html>